


Shkurt 2013
Numri: 59
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den

ETIKA



LAKMIA, SMIRA DHE
MJAFTUESHMËRIA
OSMAN NURI TOPBASH

MËKATI DHE
PASOJAT E TIJ
NEXHAT IBRAHIMI



NJË DËSHIRË
AHMET TASHGETIREN

MA. MUHIDIN AHMETI
FENOMENOLOGJIA
E FESTAVE



RREZIKU I
NDRYSHIMEVE DYTËSORE
MUHAMED EL-GAZALI

PROF. DR. HASAN K. JËLLMAZ
SEKRETI I LUTJES



Lutem PRA EKZISTOJ

Shkurt 2013

VITI: VII
NUMRI: 59

BOTUESI
Shtëpia botuese Progresi

DREJTOR
Alban Kali

KRYERADAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
ëëë.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

U bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese Progresi ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Allahu ne Kuran thotë: *“(O i Dërguar!) Thuaj: ‘Zoti im nuk do t’ju përfillte sikur të mos ishte lutja juaj...’* (el-Furkan, 77.)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në një hadith ka thënë: *“Sikur ju të mos bënit mëkate, Allahu do të krijonte një popull tjetër. Ata do të bënin mëkate, do t’i luteshin Allahut për t’ua falur dhe Allahu do t’ua falte.”*

Thelbësore në lutje janë sinqeriteti, mirësia dhe strehimi tek mirësitë dhe begatitë e Allahut me një zemër të brishtë. Sepse begatia dhe mirësia e Allahut është pranë zemrave të brishta dhe të buta. Për një lutje frytdhënëse, duhen pastruar të gjitha organet nga papastërtitë materiale dhe shpirtërore. Përndryshe, fjalët e lutjes nuk shprehin ndonjë rëndësi në vetvete pa pastrimin trupor dhe shpirtëror së bashku. Në lidhje me këtë, tregimi i Mevlanës, që flet për mënyrën e lutjes së një çobani në kohën e Musait (a.s.), është shumë domethënëse.

Kur Musai (a.s.), po kalonte një ditë në shkretëtirë, pa një çoban i cili i lutej Zotit. Në lutjet e tij ky çoban përdorte një fjalor shumë të thjeshtë dhe popullor dhe Zotit i qe drejtuar me këto fjalë: *“O Zot, ma trego vendin ku ndodhesh, sepse dua të të shoh. O Zot, dua të të ndihmoj në çastet e vështira dhe të jem ngushëlluesi Yt. O Zot, gjithë pasurinë time e flijoj për Ty dhe të gjitha këngët që ua këndoj dhenve do t’i kushtoj Ty”*. Kur Musai (a.s.), i dëgjoi këto fjalë, iu afërua dhe e pyeti se me kë po bisedonte në këtë mënyrë.

Çobani iu përgjigj se ishte duke folur me Krijuesin e tij. Me Krijuesin e çdo gjëje në këtë botë. Hz. Musai e qortoi çobanin në lidhje me këtë lutje dhe i tha se lutja e tij ishte blasfemi. E urdhëroi të mbyllte gojën dhe të mos lutej ashtu, sepse ato që thoshte ishin nevoja të njeriut, si ngrënia, pija, fjetja dhe Zoti

ishte larg këtyre gjërave.


“Nëse ti nuk i ndalon këto lutje blasfemike, - iu drejtua ai çobanit, - atëherë Zoti do të zemërohet dhe do ta shkatërronjë këtë botë. Dhe mos harro se ti cilësitë e njeriut po ia atribuon Zotit të Madhërishëm, në kohën kur Zoti është shumë më i lartë dhe më i mirë”

Hz. Musai foli shumë fjalë të këtitlla me çobanin dhe e poshtëroi shumë atë. Çobanin iu thye zemra dhe u pikëllua shumë, kurse po në atë moment kërkoi falje nga Hz. Musai dhe nga pikëllimi i madh shqeu këmishën e tij. Nga brendësia nxori një rënkim të madh dhe mori rrugën. Si i çmendur dhe i dashuruar u sul në drejtim të shkretëtirës dhe, duke dënesur, humbi thellë në horizontin e saj. Në këtë moment, nga ana e Zotit të Madhërishëm, Musait (a.s.), i zbriti shpallja:

“O Musa, pse e largove robin Tim nga adhurimi dhe e bëre atë të pushpresë nga mirësia dhe mëshira lme. Unë nuk i marr parasysht gjërat e jashtme të robit, sepse për Mua, brendësia e tij e bazuar në sinqeritet dhe dashuri është shumë më e rëndësishme, sesa pamja e tij e jashtme. O Musa, njerëzit që më kërkojnë dhe më duan Mua janë të ndjeshëm dhe zemërbutë. Sikur brenda Qabes humb kuptimi i drejtimit nga Qabja, në cilindo drejtim, ata janë të kthyer nga Unë. Për robin e dashur dhe të devotshëm nuk ekzistojnë rregulla të caktuara. Adhurimi dhe përkujtimi i tij, në çfarëdo gjuhe dhe mënyre të bëhet, është i pranueshëm tek Unë”.

Kur Musai (a.s.), i dëgjoi këto fjalë të Zotit, filloi ta kërkonte çobanin e humbur dhe pasi e gjeti, ia tregoi çdo gjë që kishte ndodhur: *“Zoti i ka dëgjuar lutjet dhe fjalët e tua dhe është i kënaqur nga dashuria dhe sinqeriteti yt. Prandaj falu dhe lutu si të dëshirosh. Zemra jote është e pastër dhe ka arritur të vërtetën”*.

Përmbajtja



8

M. Ashër Karabaxhak
Lutem! Pra, ekzistoj!




Osman Nuri Topbash
Lakmia, smira dhe mjaftueshmëria

34




42



14

Dr. Kerim Bulladë
Behu Kuran i gjallë

- 5 Ahmet Tashgetiren
Një dëshirë
- 10 Nexhat Ibrahim
Mekati dhe pasojat e tij
- 13 Ardian Muhaj
Mëso të mendosh!
- 17 Sabahadin Tyzyn
Thelbi i adhurimit
- 18 Ali Riza Temel
Jeta me lutje
- 21 Muhamed El-Gazali
Rreziku i ndryshimeve dytësore
- 22 Ma. Muhidin Ahmeti
Fenomenologjia e festave
- 28 Ma. Luan Afmataj
Dy bazat e një shoqërie të ëndërruar
- 30 Mustafa Erish
Cila është brenga e zemrës?



30

Një Ajet - Një Hadith 32

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz 39
Sekreti i lutjes

Imam Muhamed Sytari 42
"Unë jam lutja e babait tim Ibrahimit dhe sihariqi i Isait"

Ma. Orhan Bislimaj 45
Duaja në kontekstin besimor

Gjovalin Çuni | Gëzim Puka 48
Lexim i një monografie

Ibrahim Koç 50
Çfarë e pengon pranimin e lutjes?

Prof. dr. M. Jashar Kandemir 52
Mëshira e Tij kaplon gjithçka

Zani i s'kaluemes 56
Spjegime mbi tregimin e qiellës e të tokës

Shëndet 60
Në cilat ushqime fshihet kripa?

Teknologji 61
MSN do të shkrihet në Skype

25

Oguz Bakar
Si pranohen Lutjet?



Semih Jollaçan
Puna më e mirë: Të mësosh Kuranin
dhe tua mësosh atë të tjerëve

54





Një Dëshirë

Ahmet Tashgetiren

O Zot!

Falënderimet janë veç për Ty, o Zot. Ti je Drita e tokës, e qiellit dhe e çdo gjëje që ndodhet në to...

Falënderimet janë veç për Ty! Ti je Ai që i jep jetë tokës, qiellit dhe çdo gjëje që ndodhet në to.

Falënderimet janë veç për Ty, o Allah! Ti je Sunduesi i tokës, i qiellit dhe çdo gjëje që ndodhet në to.

Falënderimet janë veç për Ty, o Zot. Ti je e Vërteta... Premtimi Yt është i vërtetë. Takimi me Ty është i vërtetë. Fjala Jote është e vërtetë. Xheneti Yt është i vërtetë. Xhehenemi Yt është i vërtetë. Të dërguarit e Tu janë të vërtetë... Muhamedi (a.s.), është i vërtetë. U dorëzova tek Ty, o Zot! Të besova Ty. U mbështeta tek Ti. U drejtova nga Ti. Luftova dhe u përpoqa për Ty. Në çdo çështje zgjodha gjykimin Tënd. Më fal, o Zot. M'i fal të gjitha gjynahet e së shkuarës dhe të së ardhmes, të hapurat dhe të fshehtat... Ti je fillimi i fillimit dhe fundi i fundit... Përveç Teje nuk ka Zot tjetër, o Allah.

Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë, o Zot...

Prej Teje dëshiroj të më falësh... Dëshiroj falje, dëshiroj falje, o Zoti im i Madhëruar, o Bujari, o Mëshiruesi, o i Pashoqi, o i Gjalli, o Mbajtësi dhe Drejtuesi i çdo gjëje! Pendohem, o Zoti im... Prej Teje dëshiroj të më japësh forcën për t'u penduar, dëshiroj falje, rrugën e drejtë dhe ndriçimin e saj... Ti je Ai që e pastron njeriun në ujëvarën e pendimit. Ti je Ai që e mbulon atë në mëshirën Tënde... Ti je Ai që i mbulon me mëshirë të pashpresët si ne, që i kanë bërë padrejtësi vetvetes...

Jam në derën Tënde, o Zot. Të përgjerohem dhe strehohem tek Ti... T'u drejtova me përgjërime në vetminë që kaplon nata. Erdha në derën tënde...

Ti je Zoti im, o Allah... Nuk ka Zot tjetër përveç Teje. Ti më ke krijuar. Unë jam robi Yt. Unë po e mbaj premtimin që të kam dhënë. Me aq sa kam fuqi po qëndroj aty ku të kam premtuar, o Zot. Strehohem tek Ti prej



pu-
nëve të këqija që kam bërë.
I pranoj edhe mirësitë që më
ke dhuruar, edhe gabimet e
mia. Fali gjynahet e mia o
Zot, sepse përveç Teje nuk
ka askush tjetër t'i falë.

Mbase lotët tona nuk janë edhe aq të pastra sa lo-
tët e Resulit Tënd, Muhamedit (a.s.), i cili ra në sexhde
dhe t'u përgjërta në Bedër...

Por Ti Je Zoti im që ke thënë: "Nëse nuk do të ishte
lutja juaj, çfarë t'ju bëjë Zoti"...

Ti na e mësove lutjen... Ti i shkrove në zemrat tona
cilësitë e Tua Rrahman dhe Rrahim... Ti i shkrove
shpresat tona. Ti na mësove si të ruhemi prej hum-
bjes së shpresës. Ti ke thënë: "Lutmëni që t'ju përg-
jigjem"... Ti je Ai që "nuk e braktis premtimin"... Ti ke
thesare të pashtershme...

Zoti im, ne po lutemi në derën Tënde dhe të be-
sojmë Ty...

Na mbulo me mëshirën Tënde, në tokën tonë tek
njerëzit tanë...

Hapi dyert e mëshirës, o Zoti im!

Na jep zemra të shëndosha!

Na jep zemra që do të të duan Ty... Na jep zemra që
do t'i duan ata që do Ti...

Na jep ato që robi yt Muhamedi (a.s.), të ka kërkuar
në lutjet e veta...

Na e bëj të dashur malin e Uhudit, gurët, zogjtë dhe
lulet e tij ashtu siç i bëre të dashura për atë...

*O Zot! Na mëso të qëndrojmë
me durim për një kohë të gjatë
në prag të derës Tënde. Na ruaj
prej harresës. Na bëj prej atyre
që, kur bie muzgu i mbrëmjes,
në zemrat e tyre ndizen
kandila, që u ndriçojnë zemrat
nga qëndrimi me Ty...*

Na i bëj të dashur fëmijët, gratë dhe nevojtarët...

Na e bëj të dashur bukurinë... Na e bëj të mundur
të kuptojmë bukurinë.

Na i bëj të dashur besimtarët e së shkuarës dhe
të së ardhmes... Mos lër në zemrat tona as ndjenjën
më të vogël të zemërimit e të hidhërimit ndaj be-
simtarëve...

Ne jemi qenie të dobëta. Në kohë të vështira, lutjet
dhe përgjërimit tona bëhen lumë
e përrua. Gjatë kohëve me furtuna
mblidhemi tek dera Jote. I gjithë
njerëzimi mblidhet aty dhe qielli je-
hon me thirrjet "Zoti im, Zoti im"...

Pastaj, harresa është një prej do-
bësive të natyrës sonë...

O Zot! Na mëso të qëndrojmë
me durim për një kohë të gjatë në
prag të derës Tënde. Na ruaj prej ha-
rresës. Na bëj prej atyre që, kur bie
muzgu i mbrëmjes, në zemrat e tyre
ndizen kandila, që u ndriçojnë zemrat nga
qëndrimi me Ty...

O Allah! Mos na sprovo me tiraninë dhe tiranët...

Mos na e sill mbi krye atë që nuk do të ketë më-
shirë për ne.

Mos u jep fuqi të pamëshirshmëve, o Allah!

O Allah! Shuaja etjen buzëve tona të djegura nga
malli. Jetojmë në një botë ku përditë shtohen të
shtypurit. Na jep durim dhe forcë për të rezistuar.
O Allah! Mos na sprovo me atë ndaj së cilës nuk mund
të rezistojmë.

O Allah! Na ruaj prej gjërave nga të cilat do të tur-
përohemi kur të dalim para Teje, para Profetit tonë,
Muhamedit (a.s.) dhe para besimtarëve të tjerë.

O Allah! Na ruaj prej gjendjeve që do të na dety-
rojnë të ikim prej njëri-tjetrit në atë ditë të vështirë.
Mos lejo të biem në atë gjendje që këmbët dhe duart
tona të ikin prej të njohurve tanë atë ditë...

O Allah! Jemi gjithmonë të varfër dhe nevojtarë
për Ty...

Pasuria është e Jotja, fuqia është e Jotja... Jeta dhe
vdekja jonë është në dorën Tënde... Kemi nevojë për
Mëshirën, për Faljen, për Ndhimën dhe për Mbrojtjen
Tënde! O Allah mbroji dhe ndihmoji ata që janë në
rrugën Tënde...

O Zot! Na jep diell, na jep hënë, na jep shi, na jep borë, na jep lule, na jep ngjyra, na jep aromë e bukuri...

O Zot! Ruaji pemët, ruaji udhëtarët, jepu shërim të sëmurëve që të drejtohen Ty për shërim, ruaji fëmijët, të moshuarit dhe të rinjtë tanë...

Na jep dritën e syve... Zgjerohet dhe rehatohet zemrat e shpirtrat tanë...

Na jep buzëqeshje prej asaj që ka ngelur prej Muhamedit (a.s.)...

Na jep ndjenjën e dhurimit dhe altruizmit...

Na ruaj prej koprarisë, o Zot! Na ruaj prej zemërimit dhe prej smirës... Na ruaj prej lakmisë, dyfytërisë dhe mendjemadhësisë...

Na ruaj prej shkujdesjes... Na ruaj nga ato momente, kur ne nuk të ndjehet më afër se damari i qafës...

Ti Je Sunduesi i zemrave... Madje dhe njeriu që krijove si mëshirë për botët të lutet: "O Zoti im, që i kthen dhe i rrotullon zemrat! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde." Pra, o Zot jepi jetë zemrës sonë me fenë Tënde!..

Bëji namazet tona çaste takimi me Ty...

Bëj që t'i kuptojmë me shpirt e me zemër lavdet, falënderimet dhe përkujtimet që të bëjmë Ty...

Fëmijët tanë janë amaneti Yt... Ti na sprovove me ta... Mos na turpëro në këtë sprovë, O Zot! Bëji ata udhëtarët e rrugës Tënde, të dashurit e dashurisë Tënde. Mos i privo dhe mos i dëno ata për fajin tonë, as në këtë botë dhe as në botën tjetër dhe jepu atyre lumturi në të dyja botët...

Rretho familjet tona me mëshirën Tënde, o Zot! Na bëj njerëz që bartin lumturinë nga kjo botë në tjetrën... Bëji bashkëshortet tona dritën e syve tanë dhe dashurinë tonë atmosferë ku qetësohen dhe pastrohen shpirtrat tanë...

Thuaj: "Kërkoni rrugë për tek Unë...!"

Thuaj: "Lutmëni Mua...!"

Ja lutjet tona, ja kërkimi i rrugëve për tek Ti... "Ihdi-na / na udhëzo...! Na trego rrugën, o Allah...!" Na udhëzo

në rrugën e drejtë... Nëse nuk na e tregon Ti rrugën, nëse nuk na mban Ti në rrugën Tënde, ne nuk mund ta gjejmë dhe nuk mund të qëndrojmë në atë rrugë.

Librin Tënd bëje udhërrëfyes për ne, o Allah...! Le të jetë Libri Yt kriteri i zemrës sonë... Ndërsa i Dërguari Yt, udhëzuesi ynë i përrjetshëm... Le të përfundojë rrugëtimi ynë vetëm nën flamurin Tënd, o Allah...

Jepu dritë syve dhe shpirtave tanë prej dashurisë së Muhamedit (a.s.)... Dashuritë tona të mbrohen në dashurinë e tij...

O Zot! Mësoju lutje të bukura gjuhëve tona... Lutje që do të arrijnë tek Ti...

Kërkojmë kënaqësinë tënde, o Allah. E çfarë kuptimi ka ardhja jonë në këtë botë, nëse nuk mundemi të të kënaqim Ty?

Na krijoje si njerëz... Na e mundëso të dalim para Teje si njerëz dhe të jemi të kënaqur që jemi njerëz... Mos lejo që të detyrohemi të themi: "Ah sikur të isha dhe!"...

O Allah! Na e mundëso që Meleku Yt të na e marrë shpirtin vetëm si myslimanë... Na bëj prej atyre që do ta konsiderojnë dasmë e festë takimin me Ty...

Fytyrën tonë e kthijem nga Ty, o Allah. U dorëzuam tek Ti... Mos i lër pa lutje zemrat tona... Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë...

Amin!..

*Ti Je Sunduesi i zemrave...
Madje dhe njeriu që krijove
si mëshirë për botët të lutet:
"O Zoti im, që i kthen
dhe i rrotullon zemrat!
Bëje zemrën time
të qëndrueshme
në fenë Tënde."*



Lutem!

Pra, ekzistoj!

M. Ashër Karabaxhak

Një i dehur e humbi vetëdijen prej alkoolit, hyri në një xhami dhe filloi të lutej:

“O Zot! Më fut në xhenet, më jep prej shtëpive të xhenetit, më jep keutherin, më jep hyritë...”

Muezini e dëgjoi të dehurin duke iu përgjësuar Allahut Teala, e kapi për rrobash dhe i tha:

“O njeri gafil nga mendja dhe feja! Çfarë pune ke ti në xhami? Çfarë po kërkon nga Allahu duke qenë i dehur? A lejohet një gjë e tillë?”

Pasi i dehuri i dëgjoi këto fjalë, filloi të qajë dhe tha:

“Muezin i nderuar! Muezin i nderuar... Unë jam i

dehur. M'i lësho rrobat! Mos u përziej në punën time! Mos më prek! Mos më lëndo dhe mos ma thyej zemrën! Mos harro e nëse nuk e di, atëherë mësoje: Edhe robërit mëkatarë kanë shpresë te mirësia dhe mëshira e Allahut (xh.xh.). Unë nuk kam punë me ty. A po të kërkoj gjë? A nuk është e hapur gjithmonë dera e pendimit?”

Allahu i Madhëruar në Kuranin Kerim thotë:
“Lutmuni Mua që t'ju përgjigjem!”

Lum ai i dehur që akoma nuk e ka harruar kuptimin e ekzistencës së tij dhe që nuk ka dalë nga vetja për shkak të mëkateve. Sa keq për atë muezin që nuk e kuptonte se ç'po bënte, sa keq po sillej, edhe pse ishte në shtëpinë e Allahut Teala.

Jeta rrjedh aq shpejt dhe në një mënyrë kaq të ngjeshur, saqë nganjëherë, jetojmë pa ia bërë vetes pyetjet përse dhe si ndodhemi brenda kësaj rrjedhe të ngjeshur e të stresuar. Kur të mbarojë kjo rrjedhë, do të jetë shumë vonë për këto pyetje dhe nuk do të kemi përgjigje.

Për këtë arsye, lutja është e barazvlefshme me ekzistencën. Përderisa njeriu bën dua, ai ekziston dhe kupton ekzistencën e tij. Krijuesi që e ka lidhur çdo gjë me një shkak, na urdhëron t'i lutemi, në mënyrë që të mos humbim në hallkën e shkaqeve. Madje, lutjen e vendos në qendër të jetës duke thënë:

“(O i Dërguar!) Thuaj: ‘Zoti im nuk do t’ju përfillte sikur të mos ishte lutja juaj...’” (el-Furkan, 77.)

Në këtë këndvështrim, lutja është një lloj pasimi i fesë së Allahut Teala.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në një hadith thotë:

“Sikur ju të mos bënit mëkate, Allahu do të krijonte një popull tjetër. Ata do të bënin mëkate, do t’i luteshin Allahut për t’ua falur dhe Allahu do t’ua falte.” Domethënë, Krijuesi kërkon nga ne dhe na urdhëron që t’i lutemi me shpirt dhe t’i afrohemi duke i bërë dua Atij.

Të lutesh është shumë e rëndësishme, por edhe të dish të lutesh është po aq e rëndësishme.

Hazreti Mevlana thotë në Mesnevinë e tij: *“Kur të lutesh, hapi duart drejt Allahut Teala me një zemër të përkorë. Mirësia e Allahut zbrer drejt e te një zemër e tillë.”* Qëllimi i kësaj shprehjeje është ky: *“Kur të lutesh, lutu me një vetëdije të tillë, që të gjitha qelizat e tua ta ndjejnë se Ai të Cilit i je drejtuar, është e vetmja fuqi që mund t’i përgjigjet përgjërimit tënd, sepse, nëse lutesh, nëse përgjërrohesh dhe nëse kërkon diçka, dije se Ai të Cilit po i lutesh është më afër se damari i qafës.*

Allahu na premton se lutjet do të pranohen. Atëherë, kur të lutemi, duhet ta dimë se lutja jonë

do të pranohet. Ne nuk duhet t’ua vëmë veshin mashtrimeve të shejtanit. Ai na pëshpërin në vesh e ne mendojmë: U luta, por lutja nuk m’u pranua apo, lutja ime nuk pranohet”. Ne duhet ta dimë se Allahu Teala i përgjigjet çdo lutjeje.

Nisur nga kjo, lutjen nuk duhet ta konsiderojmë thjesht një lëvizje të buzëve, por siç e shtjelluam më lart, në lutje duhet të ketë rol edhe zemra. Ne duhet t’i lutemi Allahut Teala duke iu përgjëruar me një zemër të përkorë. Përgjërimi ynë nuk duhet të jetë lutje e thatë dhe vetëm fjalë, por duhet të burojë nga zemra.

Atëherë, o njeri fatlum! Lëre lutjen e thatë..! Nëse do një pemë, duhet të mbjellësh farën e saj.

Çfarë mund të bësh, nëse fara që ke mbjellë nuk mbin dhe nuk jep prodhim? Çfarë mund të bësh tjetër, përveçse të hapësh duart dhe t’i përgjërrohesh Allahut të Madhëruar?

Të punosh, të kesh një zemër të brengosur, të lutesh dhe përsëri të lutesh.

Allahu Teala nuk dëshiron prej nesh që t’i drejtohemi vetëm me fjalë, por në të njëjtën kohë dëshiron që zemra dhe veprat tona të kenë rolin e tyre në lutje.

Atëherë lutjen mund ta ndajmë në tri forma:

Lutje verbale

Lutje shpirtërore

Lutje me vepra

Kur t’i bashkojmë këto tri lloje lutjesh, atëherë duhet të jemi të sigurt se lutjet tona do të pranohen.

Lutja është një dhuratë e madhe për ne, e cila nuk ka asnjë çmim.

Lus Allahun Teala që të kemi një jetë të mbushur plot me lutje e përgjërime ndaj Tij!

Amin!

MĒKATI

DHE PASOJAT E TËJ

“Mëkati është ai që të djeg në shpirtin tënd e të cilin ti do të dëshiroje të mos e kuptojnë njerëzit.” (Muslimi)

Nexhat Ibrahimli

SI TA KUPTOJMË MĒKATIN?

Mëkati është i vjetër sa edhe njeriu. Ai ka qenë ndër dukuritë që ka preokupuar mendjet më të mëdha të njerëzimit. Edhe interpretimet e mëkatisë janë nga më të ndryshmet. Besimtarët e kuptojnë si thyerje, shkelje të urdhrave të Allahut (xh.sh.). Kundërshtarët e besimit e kuptojnë si fiksion të besimtarëve, sepse mëkat nuk ka, por ai është pjellë e klerit fetar.

Sipas mësimave fetare, mëkatet ndërmjet veti dallojnë sipas dëmit të tyre, përkatësisht sipas pasojave që shkaktojnë dhe janë kryesisht dy llojesh: *Moskryerja e të urdhëruarës* dhe *veprimi i të ndaluarës*.

Kjo ilustron qartë me rastin e krijimit të njeriut dhe urdhrin e Allahut ndaj krijesave të tjera që t'i përulen krijesës së re. Të gjithë e zbatuan urdhrin e Krijuesit, pos Iblisit, i cili e refuzoi përluljen dhe manifestoi mendjemadhësi kundrejt Krijuesit. Ky veprim i tij shkaktoi që Iblisi të përjashtohej përfundimisht nga mëshira e Krijuesit.

Nga ana tjetër, krijimi i Ademit solli situatë të re, mënyrë të re jetese. Ai, njeriu, ishte qenie racionale, me aftësi kreative, njëkohësisht me liri relative dhe mundësi të të bërit mirë dhe keq. Kjo mundësi do të merrte kuptim kur njeriu u sprovua me urdhrin për mosngrënie e 'pëmës së ndaluar'. Ademi dhe Havaja (qenia njerëzore) e thyen urdhrin dhe e hëngrën

pemën, që i solli në situatë tjetërfare, me përjashtim nga xheneti. Por, për dallim nga Iblisi, i cili e refuzoi pranimin e gabimit të tij, njeriu e pranoi fajin, kërkoi falje nga Krijuesi dhe e mori faljen.

Mëkatet gjithashtu ndahen në të *dukshme* (mëkate transparente, ato që bëhen nëpërmjet organeve) dhe në ato të *padukshme*, që bëhen *me zemër*. Disa i ndajnë në mëkate të *rënda* (mosbesimi, rivaliteti i Zotit, sihiri, vrasja, shfrytëzimi i tjetrit (riba `), ikja nga fushëbeteja dhe shpifja, që ka bazë në hadithet e Muhamedit (a.s.)), kurse disa në *mëkate të mëdha* (dëshmia e rrejshme, alkooli, prostitucioni, vjedhja etj.) dhe në *mëkate të vogla*, në pajtim me ajetin kuranor:

“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.” (En-Nisa, 31)

Mëkati mund të ndahet edhe ndryshe, duke marrë parasysh se njeriu është i përbërë nga një varg i tërë cilësish, disa nga të cilat janë të natyrës engjëlllore, të natyrës shtazarake, shejtaneske etj. Në gërshetim të rrethanave të ndryshme, këto cilësi manifestohen herë-herë të pavarura e herë-herë të ndërvarura me faktorët e tjerë. Cilësitë shtazarake janë ato që shpien në epush, pasion, neps e paturpësi e si pasojë e

1. Kemi një varg hadithesh me tematikë të tillë, sikurse te Buhariu, Ebu Davudi etj., të cilët këto vepra i quajnë “mëkate shkatërruese” (el-mübikât).

tyre manifestohet prostitucioni, vjedhja, ngrënia e pasurisë së jetimëve, koprancia, egoizmi. Cilësitë e vrazhdësisë janë: agresiviteti, derdhja e gjakut të tjetrit, armiqësia, dëmtimi i të dobëtve, dhuna. Cilësitë shejtaneske janë: mendjemadhësia, mashtrimi, premtimi i rrejshëm, ngatërimi etj.

Të gjitha këto mund dhe duhet t'i kontrollojë arsyeja, e përcjellë dhe e fisnikëruar me Shpalljen hyjnore. Por, nuk ndodh gjithnjë të ecë puna si duhet. Disa cilësi dëshirojnë që në mënyrë të fuqishme të imponohen. Disa cilësi të tjera në mënyrë të heshtur dominojnë mbi njeriun, e që njeriu vetëm pas një kohe bëhet i vetëdijshëm se vepron i dirigjuar, duke bërë disa gjëra që nuk do të duhej dhe duke mos i bërë disa që do të duhej. Çdo njeri në vete ka disa cilësi negative, siç janë lakmia, mendjemadhësia, pasioni, smira, urretjtja, xhelozia, ashpërsia etj., dhe zhvillimi i ndonjëres prej këtyre cilësive, do ta shpjerë njeriun në veprime të këqija.²

PASOJAT E MËKATEVE EDHE NË KËTË BOTË

Është bindje e rrënjosur te njerëzit se me kryerjen e urdrave të Allahut, me përkushtimin ndaj Tij, arrihet vetëm lumturia e botës përtej. Gjithashtu, shkëlja e dispozitave islame çon në fatkeqësi dhe dënim në botën përtej. Të tillët humbin edhe atë botë por edhe këtë botë, sepse nuk e kanë harmonizuar këtë botë dhe atë botë.

Kurani thotë:

"Allahu e ka bërë shembull qytetin (e Mekës), i cili ishte i sigurt dhe i qetë. Atij i arrinin ushqime të bollshme nga të gjitha anët, por pastaj banorët e tij i mohuan dhuntitë e Allahut dhe Ai i bëri të shijojnë urinë dhe frikën, si ndëshkim për atë që bënë." (En-Nahl, 112)

Është evidente se raportet e çrregulluara në familje, fqinjësi, mashtrimet në shitblerje, padrejtësitë e ndryshme, çoroditja, pijet dehëse, dhuna ndaj njerëzve e të tjera pas vetes lënë pasojat të rënda, kurse jetën e bëjnë të ngushtë, duke sjellë nostalgjinë për atë "që ka qenë më herët".

Për këtë arsye, feja islame shkon në drejtim të harmonizimit të sjelljeve dhe aktiviteteve tona me ato të natyrës dhe ligjeve në të.³ Çdo abstenim nga jeta e harmonishme e njerëzimit, çon në përbalje me rendin kozmik në natyrë. Në këtë jep shenjë edhe Kurani në shumë raste, sikurse:

"Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën (për çdo gjë), që ju të mos e shkëlpi atë." (Er-Rahmān, 7-8)

"Shkatërimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim)." (Er-Rūm, 41)

Mësimet kuranore tregojnë se rrëmuja e theksuar dhe çrregullimet, sipas ajetit, kanë ndodhur vetëm pas shfaqjes së njeriut në Tokë. Deri atëherë, çdo gjë shkonte sipas një rendi natyror, të pandikuar, sepse vetëm njeriu e ka mundësinë e mirësisë dhe ligësisë, vlerave dhe veseve.

2. El-Hixhr, 43 dhe 44.

3. Shih gjerësisht: Sejjid Kutb, *Mealim fi't-tarik*.

"Ruajuni ngatërresave, të cilat nuk i godasin vetëm ata që bëjnë keq; dhe ta dini se Allahu dënon ashpër!"

(El-Enfāl, 25)

Për këtë arsye, mëkati duhet dëbuar, luftuar, që mos të vijë deri tek ai. Për ata që gabojnë, Allahu ka përcaktuar sanksione:

"... Të mos ju pengojë kurrfarë mëshire për të kryer detyrën e fesë së Allahut, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Fundit. Le ta shikojnë dënimin e tyre një grup besimtarësh!" (En-Nūr, 2)

Sanksionet në parim nuk kanë natyrë ndëshkuese, edhe pse në shikim të parë duken të tilla. Me sanksione tentohet të parandalohet bërja e mëkatis në mënyrë masive dhe të izolohet si i tillë në individë. E kundërta, mosrezistimi ndaj mëkatis, trimëron bërjen e mëkateve botërisht dhe masivisht, siç ngjan me epidemitë apo pandemitë në mjekësi.

Mëkati e verbon vetëdijen shpirtërore. Prandaj, mëkatari nuk e sheh të vërtetën në natyrën e mirëfilltë. Kjo ndodh edhe me lakminë e njeriut, kur shejtani ia paraqet gjërat në mënyrë mashtruese, kurse ai i pranon si të tilla, duke mos menduar më thellë për pasojat e shumta. Njerëzit mëkatarë fillojnë të jepen pas vetes, të vijnë në kundërshtim me ligjet natyrore dhe të krijojnë rrëmujë në natyrë, por edhe në jetët njerëzore: ndotja e ajrit, ujit dhe tokës, infektimet dhe sëmundjet, vrasjet, frika nga tjetri, shkëputja e lidhjeve familjare, farefisnore dhe fqinjësore. Këtë Allahu i madhërishtë e ka theksuar:

"Ruajuni ngatërresave, të cilat nuk i godasin vetëm ata që bëjnë keq; dhe ta dini se Allahu dënon ashpër!" (El-Enfāl, 25)

Edhe Muhamedi (a.s.), ka paralajmëruar për këtë gjendje:

"Kur te një popull të shfaqet e keqja, në atë mënyrë që të fillojë ta veprojë të keqen publikisht, ky popull do të përballet me infektim dhe sëmundje që nuk kanë ekzistuar te të parët e tyre. Kur një popull të fillojë të vjedhë në peshore, ai do të përballet me thatësi, mospasje dhe sundim tiranik, kurse kur të pushojnë ta ndajnë zekatin nga pasuria e tyre, u pakësohet uji nga qielli dhe sikur të mos kishte kafshë, nuk do t'u binte kurrë shi..." (Hadithi nga Ibn Māxhe).

Pasojë tjetër është ajo që pohon Muhamedi (a.s.):

"Pa dyshim, njeriut do t'i zvogëlohet edhe furnizimi, për shkak të mëkatis që bën." (Hadithi nga Ahmedi në Musned)

Disa mëkate, Allahu mund t'i vonojë e disa mund t'i realizojë qysh gjatë kësaj bote. Muhamedi (a.s.), thotë: "Sanksionin për të gjitha mëkatet Allahu, nëse do, mund ta vonojë deri Ditën e Gjykimit, përveç mosbindjes ndaj prindërve. Mëkatarët e tillë Allahu i ndëshkon qysh gjatë jetës në këtë botë." (Hadithi

nga El-Hakimi në El-Mustedrek me sened sahih).

Ibn Kethiri shpjegon: *“Kur njerëzit të fillojnë masivisht të bëjnë mëkate, si pasojë do të jetë humbja e bereqetit edhe nga qielli, edhe nga toka. ...”*⁴

Për këtë arsye, njeriu nuk duhet ta kërkojë fajtorin gjatë, siç është bërë zakon kohëve të fundit, por në vetvete. Fajësimi i tjetrit është mëkat në vete dhe nuk e riparoi të ligën.

Muhamedi (a.s.), kur kishte ndonjë problem, ndonjë vështirësi, nuk klithte e bërtiste, por e shtonte ibadetin, pendohej më shpesh dhe e luste Allahun për falje. Në këtë mënyrë pak a shumë sillleshin edhe sahabët. Ata e dinin ndikimin e mëkatit në jetën reale. Mirëpo, me kalimin e kohës, brezat e mëvonshëm dhe ky yni janë mishëruar disi me mëkatet, janë familjarizuar me të keqen dhe si pasojë, janë dëmet e paimagjinueshme në rrafshin fetar, moral, politik, ekonomik, kulturor etj.

Ekzistojnë tri rrugë të kundërvënies ndaj së keqes. Muhamedi (a.s.), e ka përkufizuar në mënyrë të shkëlqyeshme këtë metodë:

*“Kush nga ju sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij e nëse nuk mundet ta bëjë, atëherë me gjuhën e tij, e nëse nuk mundet ta bëjë këtë, atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët.”*⁵

NDIKIMI I MËKATIT NË ZEMËR

Pasojat e mëkatit nuk janë vetëm në këtë botë apo vetëm në botën përtej, por pasojat janë edhe për zemrën shpirtërore të njeriut. Siç e helmon helmi trupin, ashtu e helmon mëkati zemrën, përkatësisht shpirtin njerëzor. Muhamedi (a.s.), e përshkruan në mënyrë metaforike këtë çështje:

“Kur njeriu gabon, në zemrën e tij shfaqet një njollë e zezë dhe nëse pendohet, e braktis dhe i drejtohet Allahut për falje, ai fshihet, e nëse rritet bërja e mëkatit, rritet edhe njolla e zezë. Kështu ndodh, deri sa nuk e mbulon zemrën e tij.”

NJERIU, ROB I MËKATIT

Islami e ngre njeriun në nivel të mëkëmbësit të Zotit në Tokë. Kjo pozitë i mundëson atij të menaxhojë tërë atë që gjendet në Tokë, qiej dhe atë që gjendet mes tyre. Njeriu nuk mund t'i robërohet dikujt tjetër pos Tij dhe të bëhet i varur ndaj dikujt tjetër pos Allahut. Nëse do ta ndjekë rrugën e Allahut, njeriu do ta ruajë pavarësinë dhe sovranitetin e tij njerëzor. Si i lirë, njeriu duhet të lexojë librin e Allahut, të lexojë natyrën përreth tij dhe mësimet e nxjerra nga meditimimi i shëndoshë, t'i implementojë për të mirën vetjake dhe atë të përgjithshme. Allahu premtonte shpërblime për një jetë të

plotë islame:

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.” (En-Nahl, 97), ndërsa për të tjerët ka premtuar jetë të keqe:

Allahu tha: “Zbritni prej Xhenetit që të dy (Ademin dhe djallin)! Do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Kur t’ju vijë udhëzimi nga ana lme, kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim.” (Tā Hā, 123)

Lidhja e hershme ndërmjet njeriut dhe Krijuesit duhet të mbahet dhe ruhet me kujdes. Arsyeja dhe pasionet duhet të jenë në shërbim të ruajtjes së lidhjeve ndërmjet njeriut dhe Krijuesit, dhe jo në prishjen e harmonisë së kësaj lidhjeje të shenjtë. Sepse, po të prishej kjo lidhje, njeriu nuk do të mund ta zbatonte detyrën e tij prej mëkëmbësi (halifi) në Tokë dhe më gjerë.

MËKATET E ZVOGËLOJNË JETËN

Edhe pse në aspektin filozofik e teologjik çështja meriton kujdes të veçantë dhe të stërholluar, në rrafshin etik, tema kuptohet ashtu si e thotë këtë Muhamedi (a.s.):

“Kush dëshiron që t’i jepet furnizim i bollshëm e (dhe) t’i zgjatet jeta, le t’i ruajë marrëdhëniet ndërfishnore.” (Hadithin e transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Nga dijetarët hadithi interpretohet llojllojshëm dhe të gjitha ato interpretime kanë arsyen e vet të fuqishme, por shpjegimi se mëkati shkakton që njeriu të mos e kuptojë jetën shpirtërore dhe t’i kapërcejë gjërat pa i vërejtur, më duket më i arsyeshmi. Kjo ka mbështetje në ajetin kuranor, ku jobesimtarët i krahason me të vdekurit:

“Me të vërtetë, ti (Muhamed) nuk mund të bësh që “i vdekuri” apo “i shurdhri” të dëgjojnë thirrjen, kur ata ta kthejnë shpinën duke u larguar! Ti nuk mund ta udhëzosh të verbrin të dalë nga humbja e tij! Ti mund të bësh që të dëgjojnë vetëm ata që besojnë në shpalljet Tona. Ata janë myslimanë të vërtetë.” (Er-Rûm, 52-53)

“Ne nuk ia kemi mësuar atij (Muhamedit) poezinë e ajo as që është për të. Ky (libër që ka sjellë) është vetëm këshillë dhe një Kuran i qartë, për të paralajmëruar këdo që është gjallë dhe për t’u përbushur fjala e Tij ndaj mohuesve.” (Jā Sīn, 69-70)

Njeriu nga jeta e tij ka interes vetëm nga ajo pjesë që ia ka përkushtuar Krijuesit. Nga ibadetet e tij vetëm aq sa ka qenë i pranishëm shpirtërisht në to. E kundërta, nëse ibadetin nuk e ka përcjellë qëllimi që ta arrijë kënaqësinë e Zotit, atëherë çdo gjë do të jetë e padobishme, e vdekur dhe nga aspekti fetar e pavlefshme.

4. Tefsiri i Ibn Kethirit, ajeti 43 i sures Er-Rrûm.

5. Muslimi; Rijadus-Salihin përkthimi shqip, nr. i hadithit 189.

Mëso të mendosh!

I nderuar mik, student, i ri, plak apo i vjetër, burrë apo grua, a e di se ajo që e dallon dhe lartëson njeriun duke e shquar nga qeniet dhe ekzistencat e tjera është pikërisht aftësia për të menduar!

Por a e dini që, megjithëse të gjithë njerëzit mendojnë, jo të gjithë dinë të mendojnë. Ka me mijëra doktorë shkencash, magjistra, të diplomuar, nga ata që e quajnë veten intelektualë, që kanë harxhuar dhe harxhojnë me dhjetëra mijëra orë ose të gjithë jetën e tyre, duke studiuar dhe duke menduar mbi çështje të ndërlikuara, që kanë të bëjnë me fusha nga më të ndryshmet, duke filluar që nga teoritë e mësimit e të edukimit, nga studimet e komplikuara mbi gjuhën, mbi letërsinë, mbi filozofinë, mbi dokumentet dhe metodat historike e deri në çështje që kanë të bëjnë me fusha, si matematika, mikrobiologjia, informatika e deri tek nanoteknologjia e shumë të tjera.

Dija njerëzore ka arritur sot në maja të tilla, sa që përditë kjo trashëgimi e përbashkët e qytetërimit njerëzor shtohet me ritme të jashtëzakonshme, duke e bërë të nevojshme lindjen e shkencave të reja, si edhe ndarjen e shkencave ekzistuese në degë të reja, me qëllimin për ta bërë sa më të përvetësueshëm e sa më të dobishëm për njeriun këtë thesar të vyer, që është dija dhe shkenca njerëzore.

Sot është më se e zakonshme të takosh në rrugë apo të kesh një fqinj, që e blen bukën në të njëjtin dyqan me ty dhe që është i specializuar në një degë të dijes së cilës pak vite më parë as emri nuk i dihej dhe që ne, edhe pse mund t'ia kemi dëgjuar emrin, nuk ia kemi idenë se për çfarë konkretisht shërben dhe studion. Emra të tillë shkencash e degësh të dijes si: kibernetikë, nanoteknologji, inxhinieri gjenetike, etj., na stepin dhe na bëjnë të mendojmë për domethënien e tyre, por shpesh as fjalorët gjuhësorë nuk ia dalin të përfshijnë edhe termat më të fundit të shkencës e dijes njerëzore. Pra, është e qartë se njerëzit atë aftësi të veçantë që i shquan prej qenieve dhe ekzistencave të tjera e përdorin, domethënë mendojnë. Por, a dinë të mendojnë?

“Më jepni një pikë mbështetëse dhe me një levë mund të lëviz gjithë tokën”, thoshte gjeniu i lashtësisë, Arkimedi. Natyrisht, Arkimedi si gjeni e kishte të qartë se një levë sado e mirë dhe e fortë pa një pikë të fortë mbështetëse nuk mund të bënte shumë. Madje, pa një pikë të tillë të fortë mbështetëse, asnjë levë nuk është në gjendje, jo vetëm të lëvizë gjithë tokën, por madje as vetveten.

Dija apo shkenca njerëzore, kjo levë e artë në duart e njeriut, nuk mund ta lëvizë botën, pa një pikë të fortë mbështetëse. E shumta, mund të krijojë iluzionin se po e bën një gjë të tillë, por në fakt, në vend që ta lëvizë botën dhe qytetërimin njerëzor drejt lartësive të merituar, nuk do të bëjë tjetër veçse do ta rrokullisë në një greminë, fundi i së cilës nuk dihet, por gjithsesi është i padenjë për

këtë qenie të mrekullueshme, siç është njeriu.

Thelbi i dijes qëndron në aftësinë për të dalluar atë që është e rëndësishme nga ajo që është më pak e rëndësishme, do të thotë të dish vlerën dhe rendin e gjërave. Nëse një shkencëtar i diplomuar në inxhinieri gjenetike, në vend që të merrej me këtë fushë të shkencës, duke e kërkuar kënaqësinë aty ku ka studiuar aq vite, do të shpenzonte kohën e tij duke thurur barcaleta e skeçe për estradë, natyrisht që kjo do të ishte shpërdorim i asaj dhuntie të çmuar që është mendja. Edhe pse fusha e humorit, që përbën një dije më vete dhe me vlerë, do t'i dukej më kënaqësidhënëse, për të mund të thuhet se nuk di të mendojë, mbasi nuk di të shquajë atë që është e rëndësishme nga ajo që është më pak e rëndësishme.

Por gjërat e rëndësishme nuk janë medoemos më të komplikuara. Duhet të fillojmë të mësojmë alfabetin nga gërma *a*, domethënë nga e para dhe jo nga e mesit apo e fundit. Fakti që e shohim botën përditë e më shumë përmes dritares së vogël të televizionit, nuk na bën më të mençur sesa po ta shikonim përmes fushëpamjes së gjerë e të gjallë të realitetit. Është një hap shumë pozitiv fakti që sot shumica e njerëzve dinë të lexojnë, se analfabetizmi po bëhet përditë e më tepër një kujtim i hidhur i së kaluarës, por fakti që dimë të lexojmë nuk na garanton aspak se dimë gjithashtu edhe të mendojmë. Gjakatari Beshir el Asad, edhe pse (ç)njëri i shkolluar, edhe pse e ka të qartë fundin e vet në koshin e fundërrinave të historisë, prapëseprapë nuk i dorëzohet arsyes. Me të tillë mendjembrapshtë kjo botë ka qenë e mbushur përherë plot e përplot. Përndryshe, nuk mund të shpjegohen gjithë ato luftëra, masakra e shfarosje masive, që njerëzimi ka provuar kohë mbas kohe.

Filozofi i madh i lashtësisë Sokrati, nuk i ka ditur as çerekun e emrave të shkencave të cilat ne sot i dimë, nuk ka ditur të përdorë kompjuterin, as të drejtojë makinën, as të flasë në telefon. Për më tepër, nuk ka pasur fatin të njohë mësimet e të dërguarve të Zotit dhe veçanërisht, të Dërguarit të fundit dhe më të përsosurit, Muhamedit (a.s.), por ka ditur shumë më tepër se sa pjesa më e madhe e njerëzve të sotëm, që janë të aftë të përdorin kompjuterin, t'i ngasin makinën apo të flasin në telefon. Ai ka ditur të dallojë atë që është më e rëndësishme, prandaj edhe ka thënë një frazë të thjeshtë, por gjurmëlënëse: “Njih vetveten!”

Kështu edhe në rastin e të menduarit, gjëja më e rëndësishme që njeriu duhet të dijë, është se ka vetëm një Zot, të vetëm, dhe gjithçka tjetër që ekziston është krijesë. Ai, as nuk ka lindur kënd, as nuk ka lindur prej kujt dhe nuk ka të barabartë me Të.

Bëhu Kuran i gjallë

Dr. Kerim Bulladë

Edukimi i fëmijëve dhe i të rinjve dhe përgatitja e tyre për jetën, është ideali më i rëndësishëm i çdo populli. Fëmijët dhe të rinjtë janë faktorët më kryesorë të së ardhmes dhe lirisë. Ata janë burimi më i rëndësishëm i fuqisë së një familjeje, shoqërie dhe shteti. Për këtë arsye, popujt që edukojnë rininë e tyre me cilësi të lartë, duke marrë parasysh kushtet e kohës, kanë korrur shumë sukses.

Nga aspekti islam, çështja më jetike në përgatitjen e fëmijëve dhe të rinjve, është edukimi i tyre me besnikërinë ndaj fesë, atdheut, traditës dhe zakoneve të tyre. Nëse nuk do të kenë edukim fetar, ata do ta kenë shumë të vështirë të ruajnë identitetin dhe të mësojnë të kaluarën e tyre historike. Edukimi fetar është ai që mund t'i bëjë ata të formojnë lidhje me këto vlera.

Në lidhje me këtë çështje, psikiatri i njohur Ord. Prof. Dr. Maz'har Osman Uzmani ka bërë këtë vlerësim:

"...Në të gjithë botën feja është edukimi më themelor për shoqërinë. Edhe nëse janë të forta, frymëzimet që u bëhen shoqërive, të cilat nuk mbështeten në përrshpirtshmëri dhe në edukimin fetar, nuk janë ndikuese. Çdo individ është i lidhur natyrshëm me traditën fetare ose përmes trashëgimisë. Edukimi familjar, që ka baza në fe është shumë më serioz.

Sigurisht, edukimi shkollor është një edukim i fuqishëm, që meriton të respektohet, por nëse bazën e tij e formojmë që në fillim, ka më shumë rezultat.

Edukimi fetar e mbron njeriun nga të këqijat dhe ligësitë që mund t'i bëjë vetes, familjes, atdheut, popullit dhe të gjithë botës. Në kohët tona është kuptuar tashmë se faktori i vështirësive që konsiderohen më materiale, ka burim shpirtëror dhe psikologjik. Sëmundjet dhe hidhërimet më të rënda, qetësohen dhe shuhen me ngushëllime fetare dhe me lartësimin e shpirtit. Të rinjtë që janë të lidhur me fenë, moralin, traditën dhe janë të edukuar në këtë mënyrë, bëhen njerëz fatlumë, sidomos nëse u jepet edhe edukimi kulturor e civil. Kudo që të shkoni nëpër botë, do të shihni se edhe njerëzit me kulturën më të lartë, janë të lidhur me fenë, popullin, familjen, nderin dhe traditën. Një njeri që nuk di të respektojë fenë dhe moralin, e ka shumë të vështirë të respektojë ligjin!"

Çështjen bazë të edukimit fetar e formon mësimi i Kuranit. Kurani Fisnik e mbron, e zhvillon dhe e forcon natyrshmërinë e pastër e të dëlirë të fëmijëve dhe të të rinjve. Myslimanët e dinë këtë të vërtetë dhe për këtë arsye, e kanë pranuar si detyrë themelore mësimin e Kuranit fëmijëve të tyre që në moshë të

1. *Uyşurucu Kültürü ve Tedbirler Raporu*, Stamboll, 1992, fq. 181 (Revista e botuar nga Yeşilay Cemiyeti Genel Merkezi).



vogël dhe janë përqendruar në këtë aspekt.

Kurani është një libër jete. Ky është parimi i parë që duhet t'ua bëjmë të qartë dhe t'ua theksojmë fëmijëve dhe të rinjve. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe shokët e tij të zgjedhur, u kapën fort pas Kuranit, duke e pranuar atë si një libër jete dhe zbatimin e urdhrave të tij e kishin parim themelor.

Hazreti Aisheja, radijallahu anha, e pyeti kështu një sahab, i cili dëshironte të mësonte prej saj moralin e Pejgamberit, alejhis-selam: "Ti e lexon Kurantin, apo jo?" Sahabiu iu përgjigj: "Po, e lexoj." Pastaj Hazreti Aisheja, radijallahu anha, i tha: "Ja, morali i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), ishte Kurani."²

Siç shprehet qartë edhe në hadithin fisnik, morali i të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ishte vetë Kurani Fisnik. Ai ishte dëshmitari i gjallë i Kuranit. Te Ai gjendeshin të gjitha atributet etike, për të cilat bëhet fjalë në Kuran. Ai, sallallahu alejhi ve sellem, ka zbatuar çdo gjë që ka urdhëruar Kurani dhe është larguar nga të gjitha të këqijat e mëkatet që i ka ndaluar ai. I Dërguari i Allahut, alejhis-salatu ves-selam, nuk është ndarë kurrë nga rruga e drejtë e përkufizuar nga urdhri hyjnor:

"Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë,

2. Muslim, Musafirun, 139; Tirmidhi, Birr, 69; Ibn Maxhe, Ahkam, 14; Ahmed bin Hanbel, IV, 54, 91.

ashtu siç je i urdhëruar"³

Madje, Hazreti Pejgamberi u ndikua aq shumë nga ky ajet, saqë tha: "Mua më ka mplakur surja Hud."⁴ Në këtë mënyrë, tregoi thellësinë dhe madhështinë e mesazhit që përfshin ajeti.⁵ Hazreti Pejgamberi ishte një Kuran i gjallë. Edhe sahabët e nderuar u bënë shembull për të gjithë umetin, duke ndjekur të njëjtën rrugë.

Ibn Mes'udi dhe Ubeji, radijallahu anhuma, transmetojnë se i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u mësonte atyre nga dhjetë ajete. Ata nuk kalonin te dhjetë ajetet e tjera pa i zbatuar dispozitat që gjendeshin në dhjetë ajetet e para. Hazreti Pejgamberi ua mësonte atyre Kurantin dhe të punuarit me Kurantin. Abdurrahman es-Sulemi tregon: "Kur mësonim dhjetë ajete nga Kurani, nuk mësonim ajete të tjera pa i mësuar mirë urdhrat, ndalesat, hallallin dhe haramin që përfshinin ato dhjetë ajete."

Imam Maliku transmeton se Ibn Amri e ka mësuar suren el-Bekare për dymbëdhjetë vjet. Kur e kishte përfunduar, kishte prerë një deve. Ndërsa Abdullah bin Mes'udi, radijallahu anhu, ka thënë: "Ne e kishim të vështirë të mësonim përmendsh Kurantin. Por e kishim të lehtë të punonim me të. Ndërsa, ata që vijnë pas nesh, do ta kenë të lehtë për ta mësuar Kurantin përmendsh, por do ta kenë të vështirë për të punuar me të." Thuhet se edhe Umer bin Hattabi, radijallahu anhu, e ka mësuar suren el-Bekare për dhjetë vjet dhe kur e ka përfunduar, ka prerë një deve për të falënderuar Allahun Teala.⁶

Ne duhet ta gdhendim në vetëdijen e fëmijëve se Kurani është një libër jete dhe se nuk është dërguar vetëm për ta lexuar e mësuar përmendsh. Po ashtu, duhet të theksojmë seriozisht se parimet e dispozitave të tij, duhet të zbatohen në jetë. Kurani i urdhëron kështu të gjithë besimtarët në lidhje me këtë çështje:

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mbledheni të gjithë!" (El-Enfal, 24)

Gjërat që u japin jetë besimtarëve janë urdhrat dhe ndalesat e Allahut Teala dhe të të Dërguarit të

3. Surja Hud, 11/112.

4. Tirmidhi, Tefsir, Surja 57/6.

5. Kerim Bulladë, *Pejgamber Gibi Yaşamak*, Stamboll, 2007, fq. 10.

6. Kurtubi, Ebu Abdillahi Muhammed b. Ahmed, *el-Xhamiu li Ahkami'l-Kur'an*, Bejrut, 1993, I, 44-45.

Tij, sallallahu alejhi ve sellem. Pa dyshim se në çdo urdhër të Allahut Teala, ka urtësi dhe jetë. Çdo urdhër që vjen nga Allahu (xh.xh.), duhet të pranohet dhe të zbatohet. Kur t'u mësojmë Kuranin fëmijëve dhe të rinjve, vetëdijen e nënshtrimit ndaj Allahut Teala që shprehet në ajetin e mëposhtëm, duhet t'ua japim me përkujdesjen më të madhe. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë:

“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, Engjëjt e Tij, Librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij (duke thënë): ‘Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të Dërguarve të Tij’. Ata thonë: ‘Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti ynë dhe te Ti do të kthehemi!’” (El-Bekare,285)

Leximi, thellimi dhe mësimi përmendsh i Kuranit Fisnik, medoemos duhet të formohet mbi bazën e ajetit të mësipërm dhe kjo duhet të shpjgohet me insistim.

I ndjeri Alija Izetbegoviçi, që myslimanët e Bosnjës e quajnë “Mbreti i ditur”, thotë se myslimanët e sotëm i kanë dhënë më shumë rëndësi zburimit të Kuranit se sa përmajtjes së tij, duke u shprehur se edhe fëmijët edukohen brenda kësaj kornize. Në lidhje me këtë çështje ai bën këtë koment të rëndësishëm:

“Gjendja e Kuranit në botë po shfaq një situatë shumë tragjike. Në çdo shtëpi, do ta gjeni atë në një vend të veçantë dhe të lartë. Ai pranohet si dhurata më e bukur, për këtë arsye, përdoret letra më cilësore në botimin e tij. Madje, njerëzit sot po garojnë për të përdorur kaligrafinë më të mirë dhe për të zburuar kopertinën e faqet e tij në mënyrën më fantastike. Gjëja e parë që lexon dhe mëson fëmija është Kurani, por krahas kësaj, pjesa dërrmuese e këtyre fëmijëve, do të rriten dhe plaken pa e mësuar përmajtjen dhe rëndësinë e vërtetë të Kuranit Fisnik. Kurani është një simbol i padiskutueshëm, por e ka humbur të qenët ligj. Ndërkohë që duhet të ndodhte e kundërta.

Vini re, në vend që njerëzit të lexojnë Kuran, ata e zburuojnë me zë të bukur dhe e komentojnë. As

arabët dhe as joarabët, tashmë nuk mund ta kuptojnë Kuranin, për shkak të melodisë së tij të pashoqe. Askush nuk po i njeh më ligjet e tij në formë urdhri të prerë dhe absolut, nganjëherë paralajmërues, të ëmbël e ftues e nganjëherë kërcënues që kërkojnë ndryshimin e plotës të jetës së njeriut.”⁷

Çështja më kryesore, të cilën duhet ta shtjellojmë kur t'i prezantojmë fëmijët dhe të rinjtë me Kuranin, është kjo: “Përse është dërguar Kurani? Duhet shpjguar fakti se ai është një libër që e orienton jetën dhe ndërhyr në të. Synimi bazë që duhet t'u mësojmë fëmijëve, është se Kurani është zbritur për t'i udhëzuar njerëzit dhe për t'ua përmirësuar atyre jetën.

Ta respektosh Kuranin, të mos e krahasosh me librat e tjerë, ta mbash lart mbi kraharor, të mos e ulësh në tokë dhe të mos vendosësh mbi të libra apo ndonjë gjë tjetër, sigurisht janë gjëra të rëndësishme, por të mos u bëhet e qartë fëmijëve përmajtja dhe qëllimi i dërgimit të Kuranit dhe t'ua paraqitet Kurani vetëm si një simbol i padiskutueshëm, kur u mësohen parimet që thamë më lart, nuk përputhet me synimin e dërgimit të Librit të Lartë, i cili është zbritur nga Zoti i botëve.

Gjëja më e domosdoshme që duhet të bëjmë sot, është kapërcimi i mentalitetit që fëmijët ta lexojnë Kuranin vetëm si fjalë, të bëhen hafi-

zë, të bëjnë hatme dhe ta lexojnë atë për shpirtin e prindërve apo të njerëzve në të kaluarën. Krahas leximit dhe mësimi përmendsh të Kuranit, vazhdimi i aktivitetit të kuptimit, shpjgimit dhe përjetimit serioz të tij, do t'ua hapë horizontin fëmijëve e të rinjve tanë, do t'ua forcojë besimin dhe do t'ua mbrojë e zhvillojë natyrshmërinë e tyre.

Gjallërimi i brezave, lumturia e tyre në këtë botë e në botën tjetër, janë të lidhura me kuptimin dhe zbatimin e parimeve që u jep jetë Kurani. Ata do ta njohin Zotin, veten e tyre dhe njerëzit me parimet universale të Kuranit fisnik. Krenarinë e njerëzimit, do ta përjetojnë me parimet gjallëruese të Kuranit.

7. Alija Izetbegovic, *Islâmi Yeniden Doğuşun Sorunları ve İslam Deklarasyonu*, Përkth, Rahman Ademi, Stamboll, 2007, fq. 71.



THELBI I ADHURIMIT

Sabahadin Tyzyn

Arsyeja e vetme e krijimit, urtësia dhe qëllimi i ekzistencës, streha e paqes, shpresa e shpëtimit, rruga më e shkurtër dhe më e sigurt mes krijesës dhe Krijuesit, ashtu siç shprehet edhe Profeti ynë i nderuar me gjuhën e tij të pastër, esenca dhe thelbi i adhurimit, është lutja.

Në një ajet, Allahu Teala urdhëron: **Thuaj: "Zoti im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj..."** (El-Furkan, vv.) Ja pra, ky urdhër hyjnor mjafton për të treguar rëndësinë e vërtetë të devotshmërisë dhe përlësisë ndaj Allahut. Ndërsa Profeti ynë, namazin, thelbi i të cilit është duaja (lutja), e ka përkufizuar si: *"Shtylla e fesë dhe drita e syve të mi"*.

Liria e vërtetë e njeriut është në përpjesëtim të drejtë me devotshmërinë, dorëzimin dhe përkushtimin e tij ndaj Allahut. Ja pra, duaja (lutja), është pranimi i dobësisë dhe nevojës përballë Absolutit. Dua do të thotë besim, siguri, përlulje dhe dorëzim.

Mendja zë vend në krye të të gjitha mirësive të mëdha, që i janë dhënë njeriut, sepse falë mendjes arrihet tek Allahu dhe falë saj gjenden rrugët për të arritur tek Ai. Mirëpo, sado që njeriut i është dhënë aftësia e mendimit, vullnetit dhe gjykitimit, ai përsëri ka nevojë për lejen e Tij që të arrijë në një përfundim të suksesshëm. Pa lejen e Tij, asnjë punë dhe asnjë përpjekje nuk ka rëndësi. Prandaj, duaja (lutja) është emri tjetër, i cili shpreh se njeriu njih kufijtë dhe dobësitë e tij. Njeriu që njih kufijtë e tij, përveç se përfiton prej mirësive të cilat i janë falur, kërkon edhe ndihmën e Allahut për të arritur suksesin e dëshiruar.

Habibi i Allahut, Muhamedi (a.s.), pasi kaloi shpatin e vështirë të Seurit, u strehua në një shpellë. Gjatë qëndrimit në shpellë, ai e ngushëllonte shokun e tij besnik me këto fjalë: "Mos ki frikë! E kush mund t'u bëjë gjë dy personave që kanë Allahun për të tretë". Kjo, për shkak se atyre u kishin shteruar të gjitha mundësitë e tjera, përveç mundësisë më të madhe që kishin, duasë.

Padyshim që duaja nuk përbëhet vetëm nga fjalët. Puna dhe përpjekja e njeriut kanë vlerë të njëjtë me duanë. Kur Allahu Teala thotë: **"...Vërtet, Ti nuk mund të gjesh ndryshim ose shndërrim në ligjet e Allahut."** (El-Fatir, 17.), kërkon të na tërheqë vëmendjen në ligjet që ka vendosur për krijesat e Tij. Nëse nuk do të ishte kështu, habibi i Allahut, ai njeri i zgjedhur nuk do të përjetonte asnjë vështirësi në jetën e tij. Nëse do të ishte e kundërta, ai njeri i pashoq, që kaloi një jetë plot vuajtje e vështirësi, do t'i zgjidhte çështjet shumë lehtë pa pasur nevojë të punonte duke vuajtur aq shumë.

Duaja është edukata që tregon njeriu ndaj Allahut, kur atij i kanë mbaruar të gjitha mundësitë duke pranuar dobësinë, nevojën dhe paaftësinë e vet. Ashtu siç shprehet edhe vetë Profeti i profetëve, *"duaja, është fortesa më e sigurt dhe arma më e fortë e besimtarit"*. Madje, është një armë e tillë, e cila as nuk mbarohet dhe as nuk të kthehet pas. Themi nuk të kthehet pas, sepse Allahu Teala na ka siguruar duke thënë: **"...Lutmëni Mua, se do t'ju përgjigjem!..."** (El-Gafir, 10.)

Allahu Teala, Mëshira e të Cilit e kalon Zemërimin e Tij, Dhembshurinë dhe Mëshirën e ka bërë detyrë ndaj Vetes. Në fakt, Mëshira dhe Dashuria e Tij nuk njih kategori dhe kufij, por përsëri ai na thërret në dua, sepse Ai nuk do që njeriu të bëhet rob i dikujt tjetër. Allahu nuk përfiton asgjë prej kësaj, sepse Ai është i pastër prej çdo të mete, është mbi çdo gjë dhe Madhështia e Tij është prej Vetes së Tij. Prej kësaj përfiton vetëm njeriu, sepse duaja e mban njeriun të gjallë, e bën të qëndrueshëm dhe rezistent. Ajo i jep njeriut siguri në vetvete dhe nuk e lejon që t'i përulet dikujt tjetër përveç Allahut. I jep fisnikëri dhe personalitet.

Kjo botë është një anije, njeriu është udhëtari i saj, kurse jeta është e mbushur me lëkundje e trazira. Për të mos u përmbysur në këto periudha të turbullta e të trazuara, njeriu kërkon limane për t'u strehuar. Por, mjerë ata që kërkojnë limane të tjerë, duke pasur limanin më të sigurt, që është më afër njeriut se damari i qafës së vet..!

Jeta ME LUTJE

All Riza Temel



Lutja është begatia dhe bereqeti i çdo gjëje. Jeta me lutje arrin një begati nga fillimi në fund dhe shndërron në adhurim ndaj Zotit (xh.xh.). Faktikisht, lutja është thelbi i të gjithë adhurimeve. Është strehim te Allahu Teala dhe thirrje ndaj Tij për ndihmë. Ajo është shprehje e paaftësisë së robit të pafuqishëm, është shprehje e modestisë, e dëshirës dhe e përgjërimit të tij kundrejt Krijuesit të Lartë.

Vlera e robit është aq sa i lutet Allahut Teala. **Thuaj: “Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj.”** (El-Furkan, 77.) Ndërsa i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e shpreh kështu rëndësinë e lutjes: *“Te Allahu nuk ka asgjë më të vlefshme se lutja.”* (Ahmed b. Hanbel, II, 362)

Të lutesh është një mirësi. Nga një aspekt tjetër, është pranim në audiencën hyjnore. Allahu Teala nuk e lejon robin të bëjë një dua, të cilën nuk ia pranon, ndërsa pranimin e lutjes, e di vetëm Allahu se kur dhe ku do ta bëjë. Mbi të gjitha, çdo kërkesë e robit, mund të mos jetë e mirë për të. Është një mirësi që Allahu i Madhëruar nuk i pranon kërkesat e robit, të cilat mund të jenë të këqija për të. Njeriu mund ta shikojë të keqen si të mirë dhe të mirën si të keqe. Lutja më e qëlluar është kërkimi i më të mirës në çdo gjë.

Lutja është një urë ndërmjet *ubudijetit* dhe *rububijetit*. Ajo është mosshkëputja e lidhjes me Allahun dhe qëndrimi i lidhur gjithmonë me Të. Allahu i Madhëruar, që është më afër nesh se vetja jonë dhe se damarët e qafës, na urdhëron t’i lutemi Atij: **“Lutmuni**

Mua, në mënyrë që t’ju pranoj lutjen.” (el-Gafir, 60)

Lutja e sinqertë është dëshmi për lënien e së keqes dhe vullnet për kryerjen e së mirës që kërkohet nga Zoti, xhelle xhelaluhu. Robi thërret Allahun e Madhëruar për ndihmë, kur nis një udhëtim apo kur fillon një punë dhe thotë:

“O Zot! Unë jam i paaftë. Nuk kam mundësi ta ndihmoj as veten time. Unë kam nevojë për mbrojtjen dhe mbështetjen Tënde.” Lutja e atij që nuk ka vullnet për të ecur dhe për të punuar, është e pavlerë. Nëse robi e nxjerr veten jashtë funksionit, ndërkohë që ka mundësi të veprojë si njeri, së pari kjo është mosrespektim i vetes së tij. Njeriu shpëton nga përgjegjësia vetëm kur është në një pozitë që nuk mund të bëjë gjë.

Para së gjithash, njeriu duhet të përdorë të gjithë fuqinë dhe mundësitë e tij për të bërë apo për të lënë një punë, pastaj duhet t’i lutet Allahut Teala që t’i japë sukses. Njeriu nuk mund të thotë: “Çfarë nevojë ka për Allahun, pasi t’i kem bërë të gjitha?” Sepse, nëse nuk dëshiron Allahu i Lartësuar, njeriu nuk mund të marrë frymë qoftë edhe një herë. Faktikisht, njeriu nxjerr në pah vullnetin për të bërë diçka, ndërsa Allahu i Lartmadhëruar, i jep sukses në atë gjë. Në Kuran thuhet:

“Kur gjuaje, nuk ishe ti (Muhamed) që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante.” (El-Enfal, 17)

Gjuajtja e robit është figurative, ndërsa gjuajtja e Allahut Teala është e vërtetë. Kjo e vërtetë tregon



se Allahu i Madhëruar është i pranishëm në çdo moment. Nëse njeriu i afrohet Allahut (xh.xh.), Allahu i Lartësuar bëhet dora e tij që mban, syri i tij që shikon dhe veshi i tij që dëgjon. Pastaj njeriu gjuan me Atë, shikon me Atë dhe dëgjon me Atë. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Ki frikë nga mendjemprehtësia e besimtarit, sepse ai shikon me dritën e Allahut Teala.”

Ai që shikon nga këndvështrimi, që urdhëron Allahu Teala, shikon të vërtetën. Lutja është kthim te Allahu duke kërkuar fuqi nga Ai dhe duke i kërkuar mbrojtje nga rreziqet. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“Prandaj ikni (prej dënimit) drejt (shpërblimit të) Allahut.” (Edh-Dharijat, 50.) Ne gjithmonë i kërkojmë ndihmë Allahut (xh.xh.), prej djallit që është armiku ynë më i madh. *Istiadheja* është kërkim i mbrojtjes nga Allahu. Në suren El-Felek dhe En-Nas, tregohet qartë se nga çfarë gjërash duhet t'i kërkojmë mbrojtje Zotit.

Jeta është një aventurë që rrjedh ndërmjet shpresës dhe frikës. Esenca e lutjeve është arritja e atyre që shpresojmë dhe siguria prej asaj që frikësohemi. Adresa e lutjes është Allahu Teala. Vetëm te mëshira dhe falja e Zotit (xh.xh.), mund të mbrohemi prej ndëshkimit dhe zemërimit të Tij. Lutja është një britmë shprese, një përqendrim i fuqisë dhe një përpjekje për mbledhjen e vetes.

Jeta e peygamberëve është e gjitha lutje. Të gjithë profetët, nga Hazreti Ademi (a.s.) e deri te Hazreti

Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem, fytyrat dhe zemrat e tyre i kanë drejtuar nga kënaqësia e Zotit dhe gjithmonë nga Ai (xh.sh.), kanë marrë fuqi.

Hz. Ademi, alejhis-selam dhe Hz. Havaja, iu lutën Zotit kështu:

Ata thanë: “O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet do të jemi prej të humburve!” (El-Araf, 23)

Nuhu, alejhis-selam, iu lut Zotit:

“Unë u munda, prandaj më ndihmo!” (El-Kamer, 10)

Ibrahimi, alejhis-selam, iu lut:

“O Zoti im, bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!” (Ibrahim, 35)

Musai, alejhis-selam, iu lut:

“O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time dhe zgjidhma nyjën e gjuhës sime, që ata të kuptojnë fjalën time!” (Ta Ha, 25-28) Ndërsa në disa ajete të tjera, Allahu Teala thotë:

(Kujtoje) **Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: “Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve!”** (El-Enbija, 83)

(Kujtoje) **Zekerijan, kur iu lut Zotit të vet: “O Zoti im, mos më lër vetëm (pa fëmijë), e Ti je Trashëgimtari më i mirë.”** (El-Enbija, 89)

Ai (Luti) tha: "O Zoti im, më ndihmo kundër popullit zullumqar!" (El-Ankebut, 30.)

(Sulejmani tha:) "O Zoti im, më frymëzo të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me Mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!" (En-Neml, 19.)

(Kujtoje) Dhun-Nunin (Junusin) kur iku i zemëruar e mendoj se Ne nuk do ta dënojmë, prandaj thirri nga errësira: "S'ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!" (El-Enbija, 87.)

Edhe Hazreti Isai, alejhis-selam, i është lutur gjithmonë Zotit dhe në lidhje me lutjen, ka thënë:

"Mos u bëni si hipokritët kur luteni, sepse atyre u pëlqen të luten nëpër sinagogë dhe në krye të vendeve, në mënyrë që t'i shikojnë njerëzit." (Mateu, 6/5.) Kërkoni dhe do t'ju jepet. Kërkoni, se do të gjeni. Trokitni derën dhe ajo do t'ju hapet, sepse çdo kërkues, merr. Ai që kërkon, gjen dhe dera i hapet atij që troket. Cili prej jush i jep gurë birit të tij, kur ai kërkon bukë dhe gjarpër kur kërkon peshk? Edhe pse ju jeni të këqinj, dini t'u jepni fëmijëve tuaj dhurata të mira. Ndërsa Zoti që është në qiell, jep gjëra pa masë dhe shumë të bukura." (Mateu, 7/7-11.)

Fjalën baba në Ungjill, e kam përkthyer Zot. Faktikisht kjo është e vërteta. Sepse fjalët baba dhe bir, këtu janë në kuptim metaforik dhe janë përdorur për të shprehur afrimitet. Gabimi më i madh i të krishterëve është ngatërimi i metaforës me të vërtetën.

Këtu është e pamundur t'i shkruajmë të gjitha lutjet e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, sepse jeta e Tij është lutje nga fillimi deri në fund. Kur shtrihej në shtrat, kur hynte në shtëpi, kur dilte nga shtëpia, kur vishte rrobat, kur hipte në kafshë, kur shkante në treg, kur hante, kur pinte, kur hynte e dilte nga tualeti etj. Në jetën e Tij, Alejhis-selami, nuk kishte moment pa lutje.

Për pranimin e lutjes ka disa kushte. Një lutje në lidhje me faljen e mëkateve, së pari duhet të mbësh-

tetet te një ndjenjë pendimi e thellë dhe duhet nxjerrë në pah vendosmëria e vullneti për të mos e bërë edhe një herë. Së pari, ne kryejmë adhurimet dhe pastaj e parashtrijmë kërkesën tonë me modesti, në mënyrë që të kemi të drejtë për të kërkuar diçka nga Allahu i Madhëruar. Pra, së pari adhurimi, pastaj ndihma dhe udhëzimi, ashtu siç themi kur lexojmë suren El-Fatiha në çdo namaz:

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë." (El-Fatiha, 5) Dhe Dhe kuptimi është ky: Së pari, ne duhet të kryejmë detyrën e adhurimit ndaj Allahut Teala, pastaj të kërkojmë ndihmë nga Ai. Kjo nuk është tregti. Adhurimet tona nuk janë kurrë kundërvlera e atyre që na ka dhënë Allahu. Ne, me ibadetet tona, nxjerrim në pah vetëm respektin dhe vullnetin për ta adhuruar Atë.

Fjalët dhe sjelljet, që tërheqin kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), janë shkak për pranimin e lutjeve. Në lidhje me këtë aspekt, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë: **"Ai që dëshiron t'i pranohet lutja dhe t'i hiqet vesh-tirësia, le të ndihmojë dikë që është në vesh-tirësi!"** (Ahmed b. Hanbel, II, 23)

Goja duhet të jetë e pastër, zemra e pastër, ushqimi dhe veshmbathja duhet të jenë hallall dhe të pastra, në mënyrë që të pranohet lutja. Në audiencën e Zotit, xhelle xhelaluhu, nuk dilet duke dhunuar të drejtat e njerëzve, sepse ai që nuk ua jep hakun të tjerëve, nuk ka të drejtë të kërkojë nga Allahu i Madhëruar. Lutja duhet të bëhet me sinqeritet dhe me modesti. Allahu, xhelle xhelaluhu, thotë:

"Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë! Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin." (El-A'raf, 55.)

Lutja është burim fuqie. Ai që i kërkon mbrojtje Allahut Teala dhe që e thërret për ndihmë, ka trokitur derën më të mirë dhe i është drejtuar Atij që të mund ta ndihmojë. Allahu i Madhëruar thotë:

"Nëse ju ndihmon Allahu, s'ka kush t'ju mposhtë e, nëse ju lë pa ndihmën e Tij, kush është ai që do t'ju ndihmojë, përveç Tij? Pra, vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët." (Al' Imran, 160.)



RREZIKU

i ndryshimeve dytësore

Muhamed El-Gazall

Isha dëshmitar i një grindjeje të zjarrtë mes dy grupeve njerëzish, njëri mendonte se duhet të thuhet pa zë "Amin" pas imamit, ndërsa grupi tjetër kishte mendimin se duhet të thuhet me zë të lartë "Amin!"

Dikush kishte propozuar që të vinin tek unë për gjykimin e çështjes dhe të vendosja kufirin e kësaj grindjeje...

Thashë: "Të thuash *Amin* është dua. E rëndësishme në të është të përgjërohesh dhe të lutesh. Në qoftë se prekesh gjatë lutjes dhe e ngre zërin apo, nëse përgjërohesh dhe nuk flet, është e njëjta gjë!..."

Njëri prej dëgjuesve, ndërkohë që sytë po i nxirnin flakë, tha: "Nuk kuptuam asgjë!"

I thashë: "Po, se të tillë jeni. Ju prisni një përgjigje që do të kënaqë shejtanin e kryeneçësisë, i cili fryhet shumë në kësi lloj debatesh të nxehta dhe ju bën armiq të urryer të njëri-tjetrit. Dhe, në qoftë se nuk ekziston mundësi tjetër veçse një përgjigje juridike, atëherë ta dini se ngritja e zërit në *Amin* është medhheb, por edhe heshtja në *Amin* është medhheb dhe që të dyja janë të transmetuara e inshallah kanë shpërblimin e tyre."

Të dy grupet u larguan prej meje të ngushtuar dhe ndjeva një si rehati, sepse ata ikën nga unë. Madje, kuptova varfërinë e këtyre njerëzve për një edukator me largëpamës, për t'i ngritur në një nivel më të lartë se sa kjo mendjelehtësi, e cila i ka bllokuar prej shpirtit të adhurimit dhe edukatës së namazit.

Ky ndryshim i fikhut juridik është një shembull i dhjetëra e dhjetëra rasteve të tilla, që zënë kohën dhe kokën e njerëzve bosh, ndezin fitne, zhvlerësojnë moralin dhe

këpusin çfarë Allahu ka urdhëruar të mbajnë lidhur...

Më përfytyrohet sikur këto ndryshime dytësore përngjasojnë me format e bakterieve, të cilat na tregohen nëpër librat e mjekësisë, ku poshtë tyre shënohet "mikrob", filan sëmundje e zmadhuar 1000 herë!!

Zmadhimi i këtyre formave për t'i njohur, është i kuptueshëm, por çfarë kuptimi ka zmadhimi i këtyre ndryshimeve në mesin e mendimeve dhe opinionëve të disa dijetarëve, deri sa ato të duken sikur janë të vërtetat e popujve të zhdukur? Rezultatet e tyre kanë qenë bela për shoqërinë tonë fetare, sepse ky hiperbolizim i fabrikuar mbuloi fusha të gjera, të cilat duhej të lëvizeshin prej moralit se asnjë popull nuk ngrihej, përveçse prej tyre. Kështu që, në vend që t'i zëmë njerëzit me formimin e virtyteve të larta, sinqeritetin, besnikërinë, mbajtjen e premtimit, turpin etj., i kemi zënë me diçka që mendojmë se ka më shumë shpërblim dhe dobi.

Ky është një iluzion i madh, sepse mungesa e moralit do të thotë përhapje e hipokrizisë, fesadit dhe humbje e popujve...

Unë kam mendimin se ndezja e fanatizmit të medhhebeve ka qenë plan dredharak për largimin e vëmendjes së opinionit prej kritikave politike dhe ndjekjes së gabimeve, të cilat e varrosën që moti, për së gjalli shtetin islam! Siç duket, plani akoma është aktiv dhe vazhdon ende të zbatohet ...!!

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja

FENOMENOLOGJIA E FESTAVE

Ma. Muhidin Ahmeti

HYRJE

Nuk ekziston pothuajse as edhe një bashkësi e vetme njerëzore në botë, që nuk është e lidhur me disa ideale të larta, qëllime dhe aspirata. Në rrugën e realizimit të atyre qëllimeve, ajo kalon nëpër faza të ndryshme, disa prej të cilave lënë gjurmë të thella në qenien emocionale të anëtarëve të saj. Ato janë momente gëzimi dhe trishtimi, shpëtimi të lumtur nga disa situata të pakëndshme e të vështira dhe pësimesh të mbizotëruara. Ato mund të jenë suksese të arritura pas krizave shpirtërore, intelektuale dhe materiale vështirë të kapërcyeshme. Çdo gjë është në lidhje me data, vende dhe njerëz. Disa prej këtyre festave, me kohën, bëhen universale dhe i pranojnë edhe gjeneratat dhe bashkësitë e tjera, larg nga vendi dhe koha e paraqitjes së tyre. Ato janë festa që përmbajnë në vete një substancë të përgjithshme njerëzore dhe elemente universale. A do ta ketë një ngjarje apo datë një karakteristikë të tillë, kjo varet më shumë nga ideat mbi të cilat bazohet dhe për të cilat ajo thërret.

Festat janë ndër karakteristikat e identitetit të njeriut fetar, nacional, familjar, personal. Por njëkohësisht ato janë edhe karakteristika të identitetit të njerëzve të tjerë. Kështu që duke respektuar identitetin tënd, respekton identitetin e atij tjetrit. Duke respektuar festat e tua, presupozon edhe respektimin e festave të të tjerëve.

Njeriu sipas natyrës së tij, përveç të tjerash, është edhe *homo adorans*, qenie që gëzohet dhe feston. Në të gjitha epokat dhe kulturat njeriu ka rënkuar dhe rënkon për pavdekshmërinë dhe kohën e përjetshme. Gjatë festave çdo gjë *përmbysset* dhe vendosen rregulla të reja të jetës, të cilat nuk vlejné në përditshmërinë e mundimshme. Deri në kohët moderne, festat kanë qenë festime me plot kuptimin e fjalës. Dikur festat kanë qenë të rralla dhe të shenjta ose të paktën burimin e kanë pasur tek gjërat e shenjta. Dikur gëzimi dhe kënaqësia e festave ndjehej dhe përjetohej ndryshe. Kur vinte koha e ndonjë feste, njerëzit e përjetonin atë në

të gjithë komponentët e saj. Kur vinte koha e festave, sidomos Bajrameve, e mbajmë mend të gjithë edhe si fëmijë, na dukej se me fillimin e festës së Bajramit po fillonte një kohë tjetër, ndryshe nga kjo e Dynjasë. E përjetonim festën sikur po jetonim në një botë tjetër, në një kohë tjetër. Dukej sikur po fillonte një kohë e përjetshme, e mbushur me gëzim, entuziazëm, ngazëllim e gjallërim. Dikur festat në vete kishin, ashtu si njeriu, shpirt. Sot, si janë ato...?

Sot ato kanë mbetur të zbrazëta, kanë mbetur pa shpirt...

Qytetërimi bashkëkohor ka krijuar *industrinë e festave*. I ka shndërruar ato në *ditë të zbrazëta*, *ditë pushimi e mospune*, në *ditë ngeje e ahengu*, *ditë zbavitjesh*, *relaksimesh*, *sorollatjesh*, *dëfrimesh*, *stërngopjeje*, *prostitucion komercial*, *kënaqësi të programuara* dhe konsume të pakufishme. Shumë njerëz përdorin tableta për ta vrarë atë kohë të zbrazët festive. Shumica e njerëzve nuk dinë çfarë të bëjnë me veten e tyre në *ditët e pushimit*, prandaj përpiqen të ikin diku larg.

Në kulturat e lashta koha ndahej në *shenjtë* dhe *profane*. Festat atëbotë ishin burim i kohës së *shenjtë*. Koha *profane* është historike, shoqërore, e mundimshme dhe e zakonshme. Koha e *shenjtë* është meta-historike, e përjetshme, e gëzueshme, e pavdekshme, e ngazëllyer. Përmes festave koha *profane* përjetonte katarsin e vet dhe shndërrohej në atë sakrale. Deri në kohët moderne ndihej harmonia midis festave dhe ritmit të gjithëmbarshëm kozmik. Shekullarizimi i përgjithshëm sot ka shekullarizuar edhe festat.

Festa është pjesë e jetës, ashtu si edhe dhimbja. Festë dhe gëzim është ajo që të largon stresin dhe hallin, qoftë edhe për pak kohë.

Festat janë një rast i mirë për t'u gëzuar, por ai gëzim nuk mund të jetë i plotë po nuk buroi nga shpirti. Sa herë kemi thënë se në festat islame gëzohet edhe trupi edhe shpirti, por nuk ka gëzim për trupin, nëse shpirti është i shqetësuar. Nuk mund të jetë trupi i qetë, nëse shpirti i njeriut është i kapur nga mëkati. Por ta dini se

edhe shpirti nuk është i qetë kur trupi ka probleme, sepse ata janë të lidhur ngushtë me njëri tjetrin dhe të pandashëm. Më së miri këtë e vërteton ky ajet kuranor në të cilin Allahu (xh. sh.), thotë:

“Përpiku me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë.” (El-Kasas: 77)

Me këtë ajet, dijetarët nënkuptojnë se përveç se duhet të kënaqemi me mekanizmat që na i ka dhënë Allahu për ta fituar Ahiretin, po ashtu nuk duhet t'i harrujmë as mjetet dhe të mirat e Dynjasë. Gëzimi dhe festimi, pra, është një e mirë e kësaj dynjaje. Prandaj edhe Pejgamberi (a.s.), i tha Ebu Bekrit (r.a.), lidhur me vajzat që këndonin në shtëpinë e Pejgamberit (a.s.), në ditën e Bajramit: “Lëri, o Ebu Bekr, le të gëzohen se sot e kanë festë.”

Festat, sidomos ato fetare, duhet të jenë, para së gjithash, ditë të ripërtëritjes së frymës së bashkimit, bashkësisë dhe ditë gëzimi. Festat dhe shënimi i tyre janë mënyra e dhënies kuptim dhe rëndësi ekzistencës vetjake. Ato duhet të transformojnë punën e përditshme të mundimshme në ndjenja gëzimi të jetës. Vështruar nga aspekti sociologjik, gjatë festave ndodh takimi i miqve dhe të afërmeve, solidariteti dhe ndihma e shtuar, këmbimi i urimeve, thirrjet telefonike, mesazhe SMS dhe e-maile. Njerëzit atëherë përsëri e gjejnë njëri tjetrin, bisedojnë, afrohen. Mërgimtarët kthehen në vendlindje etj.

Gjatë festave reduktohen tensionet sociale, madje pezullohen edhe veprimet luftarake. Por festat kanë edhe një bazë më të thellë. Ato janë shprehje e nevojës së njeriut për tjetrin – për Zotin, lëvizje në drejtim të Tij, takim me Të. Ato janë ditët kur njeriu bën një hap përpara dhe çlirohet nga rregulli i përditshëm i gjërave, nga rutina, ditë kur e pret një jetë dhe botë të re (jo vetëm më të mirë).

Devocioni (takvaja në kuptimin më të gjerë të fjalës) është qëllimi dhe esenca e çdo feste dhe kremtimi.

Përmes festimit të këtillë shfaqet gëzimi qiellor, shenjtërohet koha, njerëzit dhe të gjitha krijesat, i tërë kozmosi, hiqen kufijtë mes njerëzve, kufijtë mes kohës dhe përjetësisë. Në këtë kontekst, festat nuk janë vetëm *përkujtime* të personaliteteve dhe ngjarjeve nga e kaluara, por eksperiencë e asaj që duhet të ndodhë. Ky është vizioni i *qiellit të ri dhe tokës së re*. Atëherë festat bëhen ditë e jetës dhe gëzimit të pastër, ngjarje, të cilat riorientojnë drejtimin e lëvizjes jetësore, duke vendosur vizionin e gëzimit dhe perspektivën e jetës.

MËNYRA E TË FESTUARIT NË ISLAM

Çdo popull ka ngjarjet e veta historike, të cilat i mban mend, i feston dhe i transmeton nga brezi në brez. Ato janë ditët e tubimeve masive përkushtuar manifestimit të ndjenjave të tij kombëtare, shoqërore - politike apo fetare, me të cilat ngre dhe përforcon ndërgjegjen e shoqërisë së vet.

Të kremtuarit e festave tek shumë popuj të botës është shndërruar në formalitet, duke mospërfillur qëllimin e tyre moral dhe ngjalljen e ndjenjave humanitare. Në traditat e tyre edukative të festës u infiltruan edhe shumë tradita të këqija, të cilat spostuan të mirat dhe kështu festave u humbi qëllimi fisnik i kremtimit. Tekat e pakufishme në ushqim dhe në veshje luksoze u sollën njerëzve më shumë dëm se dobi.

Edhe bashkësitë fetare kanë festat e tyre javore apo vjetore, të cilat i ringjallin besimtarët, u japin vulltë e forcë të re për një jetë fetare më të fortë.

Ne myslimanët, si një ndër bashkësitë më të mëdha në botë, kemi festat tona, të cilat na përkujtojnë ngjarjet më të rëndësishme nga historia islame. Mirëpo, tek ne festat nuk janë ditë rrëmuje apo dehjeje, nuk janë momente harrese. Ato nuk janë çaste shfrenimi të shoqëruara me muzikë degjeneruese, as nuk janë shfaqje televizive me humor e skena të zhveshura nga morali. Qëllimi dhe domethënia e festave islame nuk është kjo. Ditët e festave islame nuk janë çaste në të cilat këndellen instinktet dhe emocionet e festuesve, por çaste të ushtrimeve maksimale

shpirtërore për një përpjekje më të vendosur kundër të metave dhe problemeve të shoqërisë. Domethënia e festave islame është logjike, kurse qëllimi i shumëfishtë. Me programe edukativo-morale, ato zgjojnë forcat pozitive të myslimanëve në ndërtimin e ardhmërisë më të mirë e më të lumtur të kësaj dhe asaj bote. Islami është fe e shpirtit dhe e trupit e të gjitha veprat tona duhen harmonizuar sipas nevojave të tyre.

Jeta festive islame i aktivizon besimtarët në meditime më të thella mbi Zotin, i cili, me gjithë përpjekjet e tyre, u dha të mira materiale dhe shumë begati, përmes të cilave u mundësoi një jetë më të mirë e më të këndshme në botë. Njeriu i mençur e kupton këtë dhe çdo ditë, duke falënderuar në namaz, i lutet dhe i falet duke e vënë ballin në tokë (duke bërë sexhde).

Komponenti dhe ngjyrosja shpirtërore është karakteristika e parë e festave islame. Mirëpo, shpirti i festës islame nuk është memec e i padëgjueshëm; ai thërret e



është plot muzikalitet. Dëgjoje këtë himn, i cili përhapet nëpër rrugë nga goja e atyre që shkojnë të falin namazin e Bajramit, dëgjoje në xhami në gojën e musal-live, dëgjoje në shtëpi në ditët e "tekbiri - teshrikut", dëgjoje në Mine nga goja e haxhinjve gjatë kohës së hedhjes së guralecëve në xhemre. Ky është zë që del nga shpirti, për të shprehur kënaqësinë dhe gëzimin e përfundimit të rrugës së suksesshme, të rrugës së agjërimit, a të haxhillëkut. Ky është simbol i fitores për sprovat e ardhshme: "All-llahu ekber ve lil-lahil hamd!"

Kështu pra, në festat islame takohet komponenti shpirtëror i vullshëm, i lartë dhe ai material i bukur, i pastër dhe i padjallëzuar. Mirëpo, Islami nuk kënaqet vetëm me këto dy elemente të festës, ai e forcon atë edhe me elementin e tretë, më të fuqishmin dhe më të dashurin për Islamin. Kjo është ana sociale-humanitare, e cila nëpërmjet inkuadrimit të institucionit të zekatit në Bajramin e Ramazanit dhe sakrificës së Kurbanit në Bajramin e Kurbanit nga populli formon një unitet: **"Ndaj ti falu dhe preje kurbanin..."** (El-Kevther, 2)

Festat, përbëjnë mjetin më kryesor të krijimit të vlerave të reja sociale dhe kulturore për një shoqëri. Festat në vetvete ngërthejnë çaste dhe momente hareje, gëzimi, lumturie, kënaqësie, afrimi mes njerëzve e kështu me radhë. Si parim, Islami nuk është kundër festave dhe manifestimeve, të cilat nuk i tejkalojnë apo shkelin normat e ligjshmërisë islame dhe janë në përputhje me moralin islam.

Ngase ndër misionet më kryesore të festave janë edhe perceptimi i tyre si mundësi që njeriu të kuptojë identitetin që ka si dhe kthimin në vetvete d.m.th. në kulturën dhe civilizimin ku bën pjesë.

Prandaj Islami nuk duhet marrë si një koncept shumë i mbyllur dhe konservativ, që disa përpiqen t'ia veshin atij pa të drejtë. Feja islame në përgjithësi, merret dhe rreh problematika të ndryshme, pa marrë parasysh fushën së cilës i përkasin ato. Dhe në këtë drejtim, Islami përkrah manifestimet dhe festat, të cilat ngjallin kureshtjen dhe kërshtërinë mes njerëzve për vepra bamirësie ndaj të varfërve, skamnorëve, bonjakëve dhe farefisit në përgjithësi.

Festat në Islam gjithmonë vijnë pas kryerjes së ndonjë obligimi të rëndësishëm dhe si kurorëzim dhe shpërblim i suksesit të arritur.

Përveç aspektit fetar, gëzimit dhe haresë, festat islame përmbajnë, siç thamë, edhe anën sociale duke

ua shtrirë dorën e ndihmës atyre që kanë nevojë, me qëllim që ta ndajnë bashkarisht gëzimin e festës. Nuk ka lumturi personale pa lumturinë kolektive. Lidhur me këtë, Pejgamberi (a.s.), thotë: **"Bëni që ata të mos e ndejnë skamjen në këtë ditë!"**

Kjo nuk është vetëm teori, por edhe praktikë e gjallë që funksionon edhe sot e kësaj dite. Islami ka ndërtuar një sistem të tërë obligimesh, që kanë të bëjnë me ndihmën dhe financimin për njerëzit në nevojë. E tillë është festa e Fitër Bajramit, festa e Kurban Bajramit, zekati, sadakaja, bamirësia, humaniteti, solidariteti, etj.

Në festat islame në çdo aspekt mbizotëron arsyeshmëria dhe maturia, modestia dhe reflektimi. Aty nuk shfaqen shenja të teprimit, dalldisë, shkapërderdhjes së ushqimit. Gëzimi në festat islame mbetet gjithmonë në kufijtë e normales dhe nuk i tejkalon ata asnjëherë. Gëzimi në festat islame nuk është një rast për t'i hidhëruar dhe shqetësuar të tjerët. Gëzimi në festat islame

nuk shpërftyrohet, nuk deformohet, mbetet gëzim jo pasion, mbetet në natyrshmërinë e tij dhe nuk del prej saj. Edhe në gëzimet më të mëdha myslimani mbetet mysliman – rob i Allahut dhe nuk i dorëzohet askujt tjetër, madje as epshit të vet. Kështu thotë Allahu i madhërisëm.

"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë". (Er-Rum, 30)

Gjatë festave islame kultivohen dhe forcohen lidhjet familjare, duke filluar me dashurinë ndaj prindërve, forcimin e lidhjeve me të afërmit, farefisin e gjerë, fqinjët, miqtë dhe shokët. Nëse do të realizohej kjo filozofi, atëherë nuk do të kishte vend as për smirë, urrejtje e as armiqësi të ndërsjellë.

Në festat islame ripërtërihen lidhjet ndërnjerëzore, ngjallet entuziazmi dhe rigjallërohen virtytet morale, sjellja e mirë dhe filantropia.

Festat janë një rast i mirë për reflektim. Janë një mundësi për ta analizuar jetën e kaluar. Sidomos festat e fundvitit janë edhe një shans për ta analizuar, vlerësuar jetën dhe punën tonë gjatë një viti e jo për ta shkatërruar brenda një nate çdo gjë të mirë që kemi arritur brenda një viti, sikurse shpesh ndodh me festën e vitit të ri gregorian.

Vazhdon...





Si pranohen Lutjet

Oguz Bakar

Allahu Teala thotë: **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, u përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”** (El-Bekare, 186.)

Ne i lutemi Zotit të Madhëruar të na shpjerë në rrugë të drejtë.

Allahu njofton se ka dërguar një Libër dhe se i ka shpjeguar të dy rrugët, si mirësinë ashtu edhe ligësinë.

Lutja e njerëzve:

“Udhëzona në rrugën e drejtë!” (El-Fatiha, 6.)

Përgjigja e Allahut Teala është kjo:

“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.” (El-Bekare, 2.)

“Neia kemi bërë të qarta të dyjarrugët.” (El-Beled, 10.)

Allahu kërkon nga ne që të punojmë për fenë e Tij, na

këshillon t’i kërkojmë ndihmë me durim e namaz dhe ta adhurojmë Atë.

Lutja e besimtarëve:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” (El-Fatiha, 5.)

Përgjigja e Allahut:

“Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që ndihmon fenë e Allahut. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm.” (el-Haxh, 40.)

“O ju që keni besuar! Kërkoni ndihmë me durim dhe namaz!” (El-Bakara, 153.)

“Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje), që Unë t’ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke M’u bindur) e mos i mohoni dhuntitë e Mia (me mosbindje!)” (El-Bakara, 152.)

Ne kërkojmë nga Allahu Teala që të na forcojë në rrugën e Tij.

Edhe Allahu (xh.xh.), na njofton se, nëse e ndihmojmë fenë e Tij, do të na forcojë në të.

Lutja e njerëzve:

“O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na forco (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!” (Al’Imran, 147.)

Përgjigja e Allahut:

“O ju që keni besuar! Nëse e ndihmoni fenë e Allahut edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni të fortë në këmbët tuaja.” (Muhamed, 7.)

Ne i lutemi Allahut Teala të na e marrë shpirtin duke qenë në atmosferën e njerëzve të mirë.

Edhe Allahu i Madhëruar na njofton se do të na e japë këtë, nëse qëndrojmë me të mirët e të sinqertët.

Lutja e njerëzve:

“O Zoti ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonë në besim: ‘Besoni Zotin tuaj!’ Dhe kështu besuam. O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët!” (Al’Imran, 193.)

Përgjigja e Allahut Teala:

“O ju që keni besuar! Kini frikë nga Allahu dhe qëndroni me të sinqertët!” (Et-Teube, 119.)

Ne kërkojmë nga Allahu Teala që të na i mbulojë gabimet tona.

Edhe Allahu (xh.xh.), kërkon nga ne që t’i besojmë Atij dhe të bëjmë vepra të mira. Allahu na njofton se do t’u mbulohe gabimet atyre që shpërngulen për hir të Tij, atyre që janë nxjerrë nga vendet e tyre për shkak të fesë, atyre që janë torturuar për shkak të fesë, atyre që luftojnë për hir të Tij dhe atyre që bien dëshmorë për hir të Tij. Edhe largimi nga mëkatet e mëdha, është shkak për mbulimin e gabimeve. Allahu Teala na njofton se duhet ta falim namazin rregullisht, në mënyrë që të largohemi prej mëkateve të mëdha. Edhe kthimi te Allahu Teala me pendim të sinqertë dhe moskundërshtimi i dispozitave të Tij, është shkak për mbulimin e gabimeve.

Lutja e njerëzve:

“Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet!” (Al’Imran, 193.)

Përgjigja e Allahut Teala:

“Atij që beson në Allahun dhe bën vepra të mira, Allahu do t’ia falë gjynahet dhe do ta shpjerë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojë përgjithmonë. Kjo është fitorja e madhe.” (Et-Tegabun, 9.)

“Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrat e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu.” (Al’Imran, 195.)

“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.” (En-Nisa, 31.)

“Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.” (El-Ankebut, 45.)

“O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t’ju shlyejë gabimet e t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, Ditën, kur Allahu nuk do ta turpërojë Profetin dhe ata që besuan bashkë me të. Drita e tyre do të shkëlqejë para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: ‘O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë.” (Et-Tahrim, 8.)

“O ju që keni besuar! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t’ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe.” (el-Enfal, 29.)

Ne kërkojmë nga Allahu Teala që të na mbrojë nga ndëshkimi i xhehenemit.

Allahu i Madhëruar kërkon nga ne që t’i besojmë Atij, të Dërguarit të Tij (s.a.s.) dhe të luftojmë në rrugën e tij me pasurinë e veten tonë. Po ashtu, na njofton se krahas besimit, duhet edhe ta falënderojmë. Ai (xh.xh.), na e përkufizon se si duhet ta falënderojmë dhe se si të mos e kundërshtojmë. Allahu Teala na njofton se të besosh, nuk është vetëm të thëniet me gjuhë “besuam”.

Lutja e besimtarëve:

“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit (të Xhehenemit)!” (El-Bekare, 201.)

Përgjigja e Allahut Teala:

“O ju që keni besuar! A doni t’ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm? Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe veten tuaj. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju.” (Es-Saff, 10-11.)

“Përse t’ju ndëshkojë Allahu, nëse ju e falënderoni dhe e besoni? Allahu është Mirënjohës dhe i Gjithëdijshëm.” (En-Nisa, 147.)

“Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur qetë të pafuqishëm, ndaj frikësojuni Allahut, për të qenë falënderues.” (Al’Imran, 123.)

“Vërtet mendojnë njerëzit se do të lihen të thonë ‘Ne besojmë’, pa u vënë në provë?” (El-Ankebut, 2.)



Ne kërkojmë nga Allahu Teala që të na ndihmojë kundrejt popullit mohues.

Kur Allahu i Madhëruar na urdhëron të luftojmë me jobesimtarët, na njofton se ata do t'i ndëshkojë me duart tona. Në këtë mënyrë, Zoti (xh.xh.), kërkon nga ne që të marrim çdo lloj mase dhe të përgatisim çdo lloj fuqie, aq sa të kemi mundësi.

Lutja e besimtarëve:

“Ti je Zoti Ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!” (El-Bekare, 286.)

Përgjigja e Allahut:

“Luftoni kundër tyre, që Allahu t'i dënojë ata me duart tuaja, t'i poshtërojë, t'ju ndihmojë juve kundër tyre, t'i shërojë shpirtrat e besimtarëve dhe ta largojë hidhërimin nga zemrat e tyre! Allahu ia pranon pendimin kujt të dojë. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.” (Et-Teube, 14-15.)

“Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t'ju shpërblehet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi.” (El-Enfal, 60.)

Ne kërkojmë nga Allahu Teala që të na mëshirojë.

Allahu i Madhëruar kërkon nga ne që t'i besojmë Atij, të bëjmë hixhret kur të jetë e nevojshme, të luftojmë në rrugën e Tij, të mos e kundërshtojmë Atë, të falim namazin, të japim zekatin, t'u besojmë ajeteve, të zbatojmë Kuranin Fisnik dhe t'i bindemi të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem.

Lutja e besimtarëve:

“O Zoti ynë, ne kemi besuar, ndaj na fal dhe na mëshiro! Ti je më i Miri i mëshiruesve!” (El-Mu'minin, 109.)

Përgjigja e Allahut Teala:

“Vërtet, ata që besuan dhe ata që mërguan e luftuan në rrugë të Allahut, pikërisht ata shpresojnë në mëshirën e Allahut. Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.” (El-Bekare, 218.)

“Unë godas me dënimin Tim kë të dua, ndërsa mëshira lme përfshin çdo gjë. Atë do t'ua jap atyre që ruhen nga gjynahet e japin zekatin, atyre që u besojnë shpalljeve Tona dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë.” (El-Araf, 156.)

“Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni.” (El-En'am, 155.)

“Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni të Dër-

guarit, për të fituar mëshirën e Allahut!” (En-Nur, 56.)

Ne i lutemi Allahut Teala që të mos na poshtërojë Ditën e Kiametit.

Allahu i Madhëruar na urdhëron që ta pasojmë Hazreti Pejgamberin (a.s.) dhe të mos e kundërshtojmë Atë e të Dërguarin e Tij.

Lutja e besimtarëve:

“O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkëlqen premtimin e dhënë!” (Al'Imran, 194.)

Përgjigja e Allahut Teala:

“O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t'ju shlyejë gabimet e t'ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, Ditën, kur Allahu nuk do ta turpërojë Profetin dhe ata që besuan bashkë me atë. Drita e tyre do të shkëlqejë para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: ‘O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë.’” (Et-Tahrim, 8.)

“Vallë, a nuk e dinë ata, se për atë që e kundërshton Allahun dhe të Dërguarit e Tij, është përgatitur zjarri i xhehenemit, në të cilin do të qëndrojnë përherë? Ky është poshtërimi më i madh!” (Et-Teube, 63.)

Ne i kërkojmë mbrojtje Allahut të Madhëruar nga e keqja e shejtanëve.

Allahu Teala na urdhëron që të mos i ndjekim gjurmët e shejtanit, që ta pranojmë si armik atë dhe të jemi të sinqertë.

Lutja e besimtarëve:

Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve, nga shërrit i djallit cytës që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!” (En-Nas, 1-6.)

Përgjigja e Allahut Teala:

“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është njëmend armiku juaj i hapur.” (El-Bekare, 168.)

Iblisi tha: “Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t'ua zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë.” (El-Hixhr, 39-40.)



DY BAZAT E NJË SHOQ

Koha dhe historia kanë vërtetuar se një familje, një klan, popull apo shtet, që të ketë themele të forta dhe një jetë të gjatë, ka nevojë për individë të ushqyer mirë me elementin bazë të domosdoshmërisë së vetë krijimit njerëzor, atë të dijes, kufijtë e së cilës nuk mund të pranojnë kufizime ideologjike, politike, interesash apo diçkaje tjetër. Libri me prejardhje hyjnore, Kurani, i vetmi, i cili ruan originalitetin e tij më të lashtë dhe unik, do ta niste me fjalën "ikre" lexo (mëso)¹ mesazhin e tij drejtuar njerëzimit të zhytur në injorancën e harresës së vetë këtij mesazhi, duke u rikujtuar njerëzve se është dija ajo që i dallon nga qeniet e tjera dhe se për këtë arsye mbartin mbi vlerat e të menduarit dhe të të logjikuarit.

Gjithsesi, nuk mjafton vetëm me kaq, sepse kjo dije e gjerë në kufijtë e saj dhe e prirur nga presioni egoist i qenies njerëzore për të realizur atë ç'ka është negative apo e dëmshme për të tjerët, ka nevojë për një edukim të fortë moral, i cili e orienton në të mirën dhe pozitive, e kontrollon dhe e stabilizon në mostejkalimin në negative dhe e plotëson formimin e individit perfekt, bërthamën apo esencën e shoqërisë së ëndërruar. Me fjalë të tjera, dituria e shëndoshë, e gërshetuar me moral të lartë, është sekreti i lumturisë së individit, familjes dhe shoqërisë në përgjithësi.

Po të shikojmë sot, shumë vende moderne kanë arritur majat e piramidave në shkencë dhe teknologji, në sajë të një procesi të hapur dhe mjaft të lodhshëm të një farë "robotizim" të qenies njerëzore, duke e ushqyer atë me njohuri dhe aftësi të thëna, pse jo, superdobjiprurëse për shoqërinë. Ky kompleksitet, dashje apo padashje, ka marrë vrullshëm maratonën e perfeksionimit të të krijuarit "njeri" të kohës si veglën më fitimprurëse në riprodhimin e modeleve komerciale, por duke anashkaluar, neglizhuar ose harruar për fatin e keq, aspektin tjetër bazë të lumturisë dhe misionit njerëzor, aspektin moralo-etik. Jo pa të keq, sot si domosdoshmëri e kohës – mbase e vonuar – është parë trajtimi në universitete të temave "etika e prodhimit" ose "etika e konsumimit".

Dikush zotëron njohuri të gjera në shkencën e anatomisë, biologjisë, mjekësisë, por për të provuar aftësitë e tij, është i gatshëm të eksperimentojë çdo lloj gjallese

në format më ekstreme, madje edhe vetë qenien njerëzore. Këtu mund të përmendim rastin e tentativës për të futur në barkun e femrës njeri, spermatozoide të një mashkulli majmun², duke u ofruar pacienteve një shumë të hollash – mbase thjesht për të parë nëse krijesa që do të dalë, do t'i ngajë sadopak programuesit të saj! Dikush tjetër vazhdon të prodhojë e riprodhojë armë të shkatërrimit në masë, vetëm e vetëm për përfitime ekonomike, pa menduar se ku do të përdoren këto armë! E të tjerë sfidojnë matematikën, fizikën, astronominë, shpikën kompjutera e makineri, ndërtojnë në ujë e lundrojnë në tokë, por shprehen se e kanë prejardhjen nga majmuni, janë gnostikë, ateistë ose duke përfituar nga "ligji modern" i të drejtave të njeriut shprehen me "krenarinë" më të madhe - madje mundohen edhe ta imponojnë tek të tjerët - se janë homoseksualë, travestitë, lesbike...!! Mundësi të shumta, të ofruara nga aftësitë e zhvillimit shkencor, kurrë të para më parë nga njerëzimi, por të shoqëruara me një degradim marramendës të karakterit hyjnor, të cilin e zotëron njeriu! Duket se diçka mungon. Mungon mekanizmi që e kontrollon dhe perfeksionon "makinen njeri", morali.

Për të dhënë një shembull tjetër më praktik, mjafton t'i hedhim një shikim botës së politikës. Të gjithë ndjejnë pasojat negative të mungesës së etikës (moralit) në fushën politike. Në fakt, politika është arti i promovimit të së mirës së përbashkët e i lumturisë për të gjithë. Por duke e zhveshur vetveten nga konceptet dhe parimet e etikës, nga të qenët politikë transformohet në "politikërinë" e interesave dhe privilegjeve. Nga ana tjetër, në mungesë të etikës porta mbetet e hapur ndaj çdo lloj forme të korrupsionit.

Edhe eksperiencia mbi ekologjinë ka zbuluar se raporti i qenies njerëzore me natyrën - pra me qeniet e tjera - nuk mund të bazohet vetëm mbi përdorimin apo shfrytëzimin e kësaj të fundit, por duhet të bazohet në normat etike universale, përderisa shfrytëzimi i natyrës të mos jetë transformuar në abuzim, duke shkatërruar kështu mundësinë e jetesës, veçanërisht për gjeneratat e ardhshme. I zhveshur nga etika, vetë aktiviteti shkencor fillon t'i krijojë frikë qenies njerëzore.

Lind pyetja: çfarë është morali – ky efekt kaq i fortë

2. Rikujtojmë se e kundërta është provuar, pra është vendosur në barkun e një majmuni femër sperma e njeriut, por për fatin e mirë nuk ka dhënë rezultat.

1. Sure: Alak 96/1

PËRRIE TË ËNDËRRUAR

në formimin e karakterit njerëzor – dhe ku mund të gjendet ai? Morali është ajo vepër, e cila, para së gjithash është objektivist e mirë dhe për më tepër, duhet realizuar nga personi në fjalë në pavarësi të plotë nga avantazhet apo disavantazhet që mund t'i sjellë realizimi i kësaj vepre. Sokrati e ka shprehur shumë bukur këtë karakter të moralit, kur ka thënë se preferonte të ishte viktimë e të padrejtës, sesa ta kryente atë.

Gjithashtu, morali përcakton atë ç'ka është në meritën e të qenit njeri dhe ç'ka nuk është. Të jesh i besueshëm ndaj një miku, është meritë e të qenit njeri. Të mos jesh i besueshëm, nuk është meritë, por tradhti. Ta mbrosh jetën e një individi të pafajshëm, është meritë e njeriut – është sikur të shpëtosh të gjithë njerëzimin, thotë Kurani - dhe t'ia marrësh jetën atij nuk është meritë, por krim – dhe kondisderohet sikur të kesh vvarë të gjithë njerëzimin³.

Morali përcakton gjithashtu – sipas Kantit – ato akte të cilat kryhen për të respektuar atë ç'ka duhet bërë, pa marrë parasysh pajtueshmërinë me detyrën. Nëse një tregtar shet gjithmonë me çmim të ulët, për të mos humbur klientelën e tij, ai nuk kryen një akt moral. Por, nëse ai shet me çmim të drejtë për të respektuar detyrën (është ndërgjegjja e tij që ia kërkon), atëherë akti i tij është moral.

Kurse sipas Kurtubiut, morali është një mori cilësish të njeriut, të cilat përcaktojnë sjelljen dhe veprimtarinë e tij ndaj të tjerëve. Ato mund të jenë cilësi të mira ose të këqija. Cilësi e mirë, sipas kuptimit të përgjithshëm, është: të ndjesh obligim në vetvete për të tjerët, kurse kuptimi i shtjelluar: falja e gabimit, butësia, bujaria, durimi, mëshira, ndihmesa, dashuria e ndërsjelltë, zemërbutësia etj. Cilësitë e këqija janë e kundërta e asaj që u përmend më lart⁴.

Koncepti i vërtetë i moralit nuk duhet të jetë, as thjesht ai i krahasuar me ligjin natyror të të bërit mirë, por është diçka e thellë në shpirtin e njeriut, e mbjellë shumë kohë më parë se sa egoja e tij dhe e kultivuar me anë të një Fryme, nga e cila e ka zanafillën e gjithë ekzistenca. Për këtë arsye, mosprezenca e tij (moralit) tek njeriu krijon një destabilizim të madh human dhe kjo mungesë vjen e shprehur në fjalorin gjuhësor me

fjalën “imoralitet” ose në atë fetar me fjalën “mëkat, gjynah”.

Nga parimi i moralit fetar, njeriu jofetar nuk bën mirë, por bën vepra kalimtare momentalisht të dobishme. Sikurse edhe njeriu besimtar nuk mund të bëjë mirë – vepra e tij e mirë nuk ka asnjë vlerë - nëse nuk zotëron moral të lartë. Kjo vërtetohet edhe nga hadithi: **“Nuk ka besim pa moral dhe nuk ka moral pa fe”⁵**. Mendimtari dhe shkrintari frëng Jean Jacques Rousseau pati shkruar: **“Në fillim kam menduar se është e mundur të jesh i moralshëm e të mos besosh në Zotin. Tani e kam të qartë se kjo është e pamundur dhe se bindjet e mia të dikurshme ishin thjesht iluzione”**.

Atëherë, përdërisa burimi kryesor i moralit është Krijuesi i gjithçkaje, edhe njeriu me moral të lartë zotëron dhuratën më të shtrenjtë të kësaj bote. Ndërsa çelësi që hap portën e moralit të lartë, nuk mund të jetë tjetër veçse afrimiteti i krijesës me Krijuesin me anë të së vetmes linjë komunikimi, atë të Islamit fe. Ibn Kajimi, duke komentuar fjalën e të Dërguarit të Zotit, Muhamedit (s.a.s.): **“Puna e mirë është morali i mirë, ndërsa puna e keqe është ajo që fsheh në gjoksin tënd dhe nuk dëshiron që ta dinë njerëzit”⁶**, shpjegonte faktin se “feja (Islami) është e gjitha moral dhe ai që ngrihet në moral, ngrihet edhe në fe, gjithashtu.”⁷

Pra, ka ardhur koha të kuptojmë se nuk është e mirë (morale) që të krenohemi me pasuri, pushtet, bukuri, gra e fëmijë. Sa e artë është fjala e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), në të cilën na tregon pozicionin ose gradën që kemi përballë njëri-tjetrit, kur thotë: **“Më të mirët prej jush janë ata që kanë moral më të lartë”⁸**. Dituria na ndriçon mendjen për të gjetur Zotin, për të zbuluar universin dhe atë ç'ka na rrethon, pse jo edhe vetveten, kurse morali na ndriçon zemrën për t'u dhënë kuptim këtyre të gjithave. Atëherë, le të garojmë në kërkimin e dijes dhe në perfeksionimin e moralit, si dy nga bazat kryesore për të arritur gradën e më të mirit dhe për të ndërtuar shoqërinë e ëndërruar, atë shoqëri të cilën Zoti na e urdhëron, Pejgamberi (s.a.s.), na e këshillon dhe njerëzimi në përgjithësi e dëshiron.

5. Nuk jam i sigurtë për vërtetësinë e këtij hadithi!

6. Transmeton Muslimi në Sahihun e tij në librin: “El-birru ees-sileh”, Hadithi nr. 14, 4/1980.

7. Medarixhu- salikijn: 2/320.

8. Muttefekun alejhi.

3. Sure: Maide, 5/32

4. Fet` hul Bari, 1/456

Cila është BRENGA E ZEMRËS?

Një ditë, njëri prej miqve të Allahut Teala, Ahmed bin Ebu'l-Havari, kishte dalë për të ecur në shkretëtirë.

Ai pa një grup arabësh që po bënë gara me deve në shkretëtirë. Ndërkohë që ata i ngisnin devetë e tyre në një anë, në anën tjetër pa një fshatar të ulur në një qoshe. Në zemër i erdhi dëshira për të biseduar me të dhe u drejtua nga ai.

Burri kishte një gjendje të çuditshme.

Ai dukeja q i qetë dhe i strukur në vetvete, sa që mund t'i bënte përshtypje njeriut nga larg.

Ndërsa një grup beduinësh arabë po përjetonte çaste shumë emocionuese. Ata bërtisnin dhe brohorisnin të entuziazmuar.

Si mund të rrinte një njeri pa lëvizur nga vendi përballë një atmosfere të tillë?

Ahmed bin Ebu'l-Havari, rahmetullahi alejh, u bë shumë kureshtar, shkoi te ai dhe i dha selam:

"Esselamu alejkum!"

Ai iu përgjigj me një zë të lehtë:

"Ue alejkum selam!"

Nuk tha asnjë fjalë tjetër. Vijimin e ngjarjes e tregon vetë Ahmed bin Ebu'l-Havari:

Qëndrova i ulur pa thënë asnjë fjalë. Zemra m'u mbush me prehje shpirtërore.

Njeriu që dukej i çuditshëm nga larg, vazhdimisht bënte dhikër dhe përkujtonte Allahun Teala. Dukej qartë se preokupohej me dhikrin.

Nuk desha t'ia prishja qetësinë. Qëndrova pranë tij i heshtur dhe u mundova të përfitoja. Pasi kaloi shumë kohë, e ngriti kokën dhe më vështroi me shikimin e tij. Pastaj filloi të fliste:

"Sa i bukur është përkujtimi i Allahut Teala!.. Zemrave u jep prehje dhe shërim..."

Habitem për këta njerëz!..

Përse nuk e ulin kokën dhe t'i përgjeronen Allahut të Madhëruar?

Përse nuk e përkujtojnë Allahun?

Përse e harrojnë Allahun (xh.xh.), duke u zhytur në argëtim e dëfrim?

Ndërkohë vdekja është pas tyre dhe i ndjek ata në çdo çast.

Njeriu kurrë nuk mund të shpëtojë prej saj.

Përse njerëzit preokupohen me gjëra të kota, edhe pse janë përballë me një rrezik dhe fatkeqësi të tillë?"

Unë e pyeta:

"Mëshira e Allahut qoftë mbi ju! Për çfarë rreziku dhe fatkeqësie e keni fjalën?"

Ai m'u përgjigj:

"Fatkeqësia e mëkateve dhe rreziku i vdekjes. Jeta para dhe pas vdekjes!"

Pastaj filloi të qante. Edhe unë qava bashkë me të.

Pas pak e pyeta përsëri:

"Përse qëndron i vetëm?"

Ai m'u përgjigj:

"Unë nuk jam vetëm! Unë jam me Zotin!"

Mendova se është i varfër dhe kishte nevojë për diçka.

"A ke nevojë për diçka?"

"Po! Dua një mjek që të më mjekojë brengën e zemrës sime."

"E cili është ky?"

"Zoti. I qofshim falë!"

"Cila është brenga e zemrës tënde?"

"Mëkatet..."

"Kush ka shpëtuar prej mëkateve?"

"Ata me të cilët është i kënaqur Allahu Teala."

"A je udhëtar?"

"Jam udhëtar që kur kam lindur nga nëna."

"Për ku po udhëton?"

"Për në varr."

"Ku po shkon?"

"Po shkoj në Ahiret."

"Pa ushqim nuk udhëtohet. Ku e ke ushqimin?"

"Kam shumë pak ushqim."

"Çfarë ke për të ngrënë?"

"Subhanallah! Riskun që më ka dhënë Zoti."

"A nuk ke frikë vetëm?"

"Si të kem frikë? Përse të kem frikë? Unë jam

në tokën e Zotit.

Pastaj e pyeta:

"Cila është rruga?"

Ai hapi duart dhe filloi t'i lutej e t'i përgjerohej Zotit:

"O Zot..!"

Shumica e njerëzve të kanë harruar dhe po preokupohen me gjëra të kota!..

Ndërkohë që Ti do t'ua japësh shpërblimin e çdo pune!..

O Ndihmuesi i të varfërve!..

O Strehuesi i të paaftëve!..

O Ti që e bën të paktën të shumtë!..

O Ti që udhëzon të devjuarit!..

O Zot që çdo njeri kërkon mbrojtje nga Ti!..

Unë dua mirësinë dhe kënaqësinë Tënde.

Dynjaja dhe ahireti nuk janë të bukura pa kënaqësinë Tënde."

Në njërën anë lutej nga thellësia e shpirtit dhe në anën tjetër ecte. Unë e ndiqja nga pas. Pasi ecëm pak, u kthye nga unë dhe më tha:

"Mëshira e Allahut qoftë mbi ty!.. Shko te dikush që është më i mirë për ty se unë!.. Mos më shqetëso!.."

Pastaj u largua nga unë. Unë e shikoja nga pas. E ndoqa derisa më humbi nga sytë. Pastaj u ktheva pas duke qarë.

Miqte e Allahut Teala jetojnë duke u shqetësuar për Ahiretin. Ata flasin pak dhe saktë. Ata e dinë se çdo fjalë që del nga goja, shënohet nga engjëjt Kiramen Katibin.

Frika për dhënien e llogarisë, i ka bërë ata të heshtin. Gjëja më e dashur për ta është përkujtimi i Zotit të Madhëruar.

Për këtë arsye, ata meditojnë gjithmonë dhe përpiqen të bëjnë një jetë të heshtur.

Çdo çast përpiqen për ta përkujtuar Allahun Teala, duke supozuar se janë në audiencën e Tij. Ata nuk e harxhojnë frymën e tyre pa ndonjë synim.

Allahu (xh.xh.), na bëftë prej atyre që e përmendin Atë vazhdimisht, ashtu si robërit e dashur të Tij! Amin!



Një Ajet

*"Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija,
përndryshe do t'ju përcëllojë Zjarri.
Ju nuk do të keni mbrojtës tjetër
përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni."*

(Hud, 113)

Feja islame është fe e përbotshme, e zbritur për gjithë njerëzimin deri në Ditën e Kiametit. Nga kjo pikëpamje, Islami nuk ndryshon me kalimin e kohës, ajo që ndryshon është perceptimi i njerëzve ndaj Islamit. Por kështu, na shfaqet një Islam krejt ndryshe nga Islami autentik. Shkaqet e këtij fenomeni janë të shumtë, por më kryesori është tendenca për ta shndërruar Islamin në një fe individuale, duke e zhveshur plotësisht atë nga përmasa sociale. Sipas këtij mendimi të gabuar, feja është një lidhje shpirtërore individuale ndërmjet Allahut dhe njeriut. Kryerja e detyrimeve individuale është e mjaftueshme për t'u bërë një mysliman i mirë. Kjo pikëpamje ndikon në dobësimin e përgjegjësive sociale mes myslimanëve. Faktikisht, Islami shprehet se për shpëtimin e njeriut, përveç kryerjes së detyrimeve individuale, është e nevojshme edhe përmbushja e detyrimeve ndaj shoqërisë. Ndjenja e përgjegjësisë ndaj shoqërisë fillon nga familja, për t'u përhapur valë-valë në gjithë shoqërinë. *Ai që nuk interesohet për problemet e besimtarëve, nuk mund të jetë një besimtar i vërtetë,* shprehet Pejgamberi (a.s.). Lufta kundër padrejtësive është një nga përgjegjësitë kryesore të besimtarëve. Të gjithë profetët janë dërguar për të çrrënjësuar padrejtësitë dhe ndërtimin e një shoqërie mbi parimet e Drejtësisë Hyjnore.

Shqetësimi që buron nga padrejtësitë, është një ndjenjë e natyrshme te njeriu. Një njeri me natyrshmëri të pastër nuk mund

ta pranojë padrejtësinë si një gjë normale. Prandaj, ata që nuk reagojnë ndaj padrejtësive, janë njerëz që e kanë humbur natyrshmërinë njerëzore. Lufta ndaj padrejtësive, ngaqë është në natyrën e njeriut, qëndron mbi fenë dhe racën. Njeriut që i është bërë padrejtësi, i ofrohet ndihma pa shikuar përkatësinë fetare apo etnike. Kurani i nxit besimtarët të jenë vigjilentë ndaj padrejtësive. Nëse në një vend nuk shfaqet kush që t'u thotë ndal padrejtësive, atëherë aty, siç ka humbur ndjeshmëria fetare, ka humbur edhe ndjeshmëria humane. Qëndrimi indiferent përballë padrejtësive nuk i ka hije moralit të besimtarit. Nëse ne si besimtarë nuk shfaqim asnjë lloj reagimi ndaj padrejtësive, duhet në mënyrë emergjente të rishikojmë marrëdhëniet me fenë tonë. Kjo indiferencë vjen si pasojë e moskuptimit siç duhet të Islamit. Ne sot po përballemi me një Islam që nuk është as në Kuran, as në traditën profetike. Myslmanët, nga një umet i bashkëruar si një njësi e vetme janë shndërruar në një turmë të hallakatur, që ka humbur unitetin. Është më se normale që njeriu të kujdeset, të interesohet për familjen e vet apo për të afërmit e tij, por ai duhet të ndërjegjësohet se përtej familjes dhe të afërmeve është përgjegjës edhe përballë shoqërisë. Ajeti ndalon rreptësisht, jo vetëm rreshtimin për krahu padrejtësive, por edhe simpatinë më të vogël kundrejt padrejtësive. Animi nga padrejtësitë bëhet shkak për humbjen e mburojës hyjnore.

Transmetohet nga Umer ibn Hattabi (r.a.),
se Pejgamberi -sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem-, ka thënë:

*"Sikur të mbështeteni në mënyrë të sinqertë tek Allahu,
Ai do t'ju furnizojë siç furnizon shpendët,
të cilët dalin në mëngjes të uritur
dhe kthehen në mbrëmje të ngopur."*

Tevekuli është mbështetja, siguria e plotë tek Allahu për çdo çështje. Ky lloj besimi i jep njeriut forcë. Tevekuli është nga cilësitë e besimtarëve të sinqertë. Njeriu, në çfarëdo lloj kushtesh të ndodhet, duhet të mbështet vazhdimisht tek Allahu, duke besuar plotësisht se furnizuesi i vërtetë është Ai. Furnizuesi i vërtetë është vetëm Allahu, kurse puna dhe përpjekja janë mjete për të arritur qëllimin. Është një gabim i madh ta konsiderosh rrizkun (fitimin) vetëm si produkt të punës. Kjo është të vendosësh shkakun në pozicionin e krijuesit. Siç e shpreh qartë edhe ajeti kuranor: **"S'ka asnjë gjallesë në Tokë, që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij."** Puna dhe përpjekja për të fituar nuk bie aspak ndesh me hadithin, përkundrazi, përpjekja për të fituar siç dalin shpendët në mëngjes të uritur, por të qetë dhe të sigurt, në caktimin e Allahut vjen si pasojë e mbështetjes së plotë tek Ai.

Është shumë e rëndësishme të mos humbet siguria dhe mbështetja tek Allahu, i Cili u ka siguruar të gjithëve kushtet e jetesës.

Por tevekuli nuk është mbështetje tek Allahu duke braktisur përpjekjet dhe masat që duhen për të arritur qëllimin. Nga hadithi kuptohet qartë se tevekuli është përpjekje dhe mbas përpjekjes, mbështetje tek Allahu pa u shqetësuar për përfundimin. Sepse shpendëve nuk u vjen ushqimi në fole, por vetëm pasi dalin për të kërkuar rrizkun e Allahut, kthehen në mbrëmje të ngopur. Pra, është detyrë e njeriut të punojë për të fituar rrizkun.

Besimtarët i besojnë dhe i mbështeten vetëm Allahut, zemra e tyre i është dorëzuar plotësisht Atij. Vetëm prej tij shpresojnë ndihmë.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Rizku është caktim i Allahut. Furnizuesi i vërtetë i çdo gjallesë është Allahu.
2. Përpjekja për të siguruar fitimin nuk bie ndesh me tevekulin.
3. Çdo njeri duhet të përpiqet të sigurojë jetesën.
4. Duke u mbështetur tek Allahu, njeriu gjen qetësi.





LAKMIA, SMIRA DHE MJAFTUESHMËRIA

Njeriu është krijuar me një natyrë që anon edhe nga e mira, por edhe nga e keqja. Kjo gjendje realizohet sipas pëlqimit dhe caktimit hyjnor dhe është e lidhur fort me faktin se kjo botë është bota e sprovave. Kjo është arsyeja që njeriu vërtitet midis së mirës dhe së keqes, së bukurës dhe së shëmtuarës. Megjithatë, ata që arrijnë në nivelin më të lartë të mirësisë dhe bukurisë, janë pak a shumë të rrallë ashtu si malet e lartë dhe madhështorë. Prandaj një nga poetët më të mëdhenj të lindjes, Shejh Sadi Shirazi e ka përkufizuar njeriun me një fjali të vetme:

"Disa pika gjak dhe njëmijë e një derte!"

Një mal me derte... Mirëpo ata pak fatlumë, që kanë mundur të shpëtojnë nga shqetësimet që shkaktojnë tendencat negative, si lakmitë dhe dëshirat e shfrenuara, smirat dhe zilitë verbuese, bëjnë përjashtim nga ky përkufizim i përgjithshëm.

Allahu Teala ka dëshiruar që njerëzit të bëjnë jetë shoqërore. Për ta siguruar këtë, mirësitë e Veta i ka shpërndarë duke bërë dallime mes disa njerëzve dhe të tjerëve. Në këtë mënyrë, i ka bërë njerëzit që t'ia kenë nevojën njëri-tjetrit. Ky dallim, i cili është vërejtur në çdo periudhë të historisë njerëzore dhe që është i domosdoshëm për sprovën e njeriut, është një parim themelor, i cili mbështetet në caktimin hyjnor për natyrën njerëzore. Për këtë arsye, ky parim nuk mund të eliminohet. Nevoja për solidaritet shoqëror, është treguesi më i mirë i këtij dallimi në krijim. Mirëpo, tek disa njerëz, ky dallim mund të shfaqë disa anë negative të padëshirueshme, në krye të të cilave janë lakmia, urrejtja, smira etj.

Nëse lakmia, e cila zhvillohet si një reaksion zinxhir, nuk frenohet, ajo kthehet në një sëmundje të zemrës e cila quhet smirë. Ata që janë kapluar nga lakmia dhe

smira, herët a vonë do të bien në humnerën e humbjes dhe çrregullimit. Këto tendenca që dëmtojnë rëndë esencën njerëzore, në të njëjtën kohë shprehin pakënaqësinë ndaj programit të ndarjes dhe caktimit të Zotit, gjë e cila do të thotë "kryeneçësi". Kjo është një sëmundje e rëndë e egos (nepsit) dhe ata të cilët kanë rënë në të, nuk arrijnë të kuptojnë gjendjen e rëndë të lakmisë dhe smirës që kanë.

Lakmitë dhe smirat që e mbysin njeriun në vorbullën e dëshirave të pafundme, vijnë për shkak se robi e harron botën tjetër dhe lidhet çmendurisht pas kësaj bote. E shprehur ndryshe; duke mos i mundur dot dëshirat e nepsit, njeriu bëhet skllav i materies. Syri i lakmitarit nuk ngopet kurrë. Për këtë arsye, ai jeton në një varfëri të vazhdueshme dhe përpëlitet në një uri shpirtërore. Çdo lloj kënaqësie që përjeton, në vend që t'i sjellë ngopje, shkakton tek ai një oreks dhe një lakmi të re. Shfaqjet e smirës në egon njerëzore janë të ndryshme. Smira paralizon anët e mira të natyrës njerëzore. Dobëson logjikën. Mposht dhe mbisundon ndjenjat e natyrshme të besimit dhe mbështetjes në Allahun.

Smirziu, dëshiron që t'u merren mirësitë atyre që i ka smirë dhe t'i jepen atij. Nëse kjo nuk do të ishte e mundur, thotë: "As mua, as atij!" Ai nuk e do kurrë njeriun të cilit i janë falur shumë mirësi dhe aftësi. Prandaj dhe dëshiron që ato mirësi dhe aftësi të zhduken. Smirziu është i mbushur me ndjenjat e urrejtjes, tradhtisë, hakmarrjes, hiles, poshtërimit dhe përgojimit. Jetën e tij të shkurtër e kalon duke fantazuar dhe duke u shqetësuar.

Ndërsa robërit e mirë të Allahut, të cilët bëjnë jetë brenda kriterëve të devotshmërisë, nuk e tolerojnë as zilinë e mirë në lidhje me çështjet e kësaj bote.



Kjo, sepse ata edhe zilinë e mirë e konsiderojnë si një hije smire, që hidhet mbi ata të cilëve u janë dhënë mirësi.

Tundimet, si: "Sikur të më jepej edhe mua siç i është dhënë atij..." tregojnë një lloj mospëlqimi ndaj shpërndarjes dhe caktimit hyjnor. Njeriu nuk e di, por mbase gjendja në të cilën jeton mund të jetë më e mirë për të.

Nëse shpirti fiton ndjenjë dhe delikatesë, do të zhduken prej tij të gjitha zilitë dhe smirat që kanë të bëjnë me këtë botë. Në këtë mënyrë, sipas niveleve shpirtërore të besimtarëve, ndryshojnë edhe kriteret e vlerësimit të mirësive.

Në jurisprudencën islame (shariat): "Pasuria jote, është e jotja. Pasuria ime, është e imja."

Në tasavvuf (tarikati): "Pasuria jote është e jotja. Pasuria ime është e jotja."

Në të vërtetë (hakikat): "As e jotja, s'është e jotja dhe as e imja, s'është e imja. Gjithçka është e Allahut."

Besimi dhe teuekuli¹ i smirziut është gjithmonë i dobët, për shkak të smirës. Dhe kjo gjë ia shkatërron jetën atij. Mevlana i nderuar bën çudi me gjendjen e smirziut dhe shprehet:

"Çfarë ka njeriu që bëhet skllav i arit dhe pasurisë së kësaj bote? Çfarë janë ato që nuk shpenzohen në



Lakmitë dhe smirat që e mbysin njeriun në vorbullën e dëshirave të pafundme, vijnë për shkak se robi e harron botën tjetër dhe lidhet çmendurisht pas kësaj bote.

rrugë të Allahut? Çfarë kuptimi kanë? Poshtërimi i zvarritjes dhe përdredhjes si gjarpër në derën e pasurisë së botës si një skllav i saj, nuk është gjë tjetër veçse një shkak mjerimi, që e çon njeriun duarbosh në botën tjetër."

Shembulli i Salebes², i cili u mbyt në vorbullën e mjerimit shpirtëror, duke u bërë skllav i mallit dhe parasë, është një shembull prej të cilit duhet të mësojmë shumë:

Salebe, i cili ishte prej myslimanëve të Medinës, ishte shumë lakmitar ndaj mallit dhe pasurisë. Ai dëshironte të bëhej patjetër i pasur. Për këtë arsye, i kërkoi Rasulullahu (a.s.), të bënte dua për të. Ndërsa Rasulallahu (a.s.), iu përgjigj me këto fjalë:

"Pasuria e pakët, për të cilën mund të falënderosh, është më e mirë se pasuria e shumtë për të cilën nuk do të mund të falënderosh..."

Pas këtyre fjalëve, Salebe hoqi dorë nga dëshira e tij, por pas ca kohësh, lakmia e tij u rishfaq, prandaj shkoi përsëri tek Rasulallahu (a.s.) dhe i tha:

"O Rasulallah! Bëj dua, që të bëhem i pasur!"

Kësaj here Profeti (a.s.), tha:

"A nuk jam unë një shembull i mjaftueshëm për ty? Beto hem në Allahun se po të doja, këto male do të rridhnin pas meje si ar dhe argjend. Mirëpo, unë jam

1. Teuekul: Mbështetja në Allahun, pasi ke bërë gjithçka që është e mundur.

2. Ndërmjet sahabëve ka pasur 29 persona me emrin Salebe. Ky është njëri prej tyre, por nuk është Salebja, i cili mori pjesë në luftën e Bedrit dhe njihej për devotshmërinë e tij.

mjaftuar me kaq sa kam."

Salebe përsëri hoqi dorë nga dëshira e tij. Mirëpo furtuna e lakmisë që kishte përbrenda nuk kishte të ndalur. Ai thoshte me vete: "Nëse bëhem i pasur, do të ndihmoj të varfrit dhe do të fitoj më shumë shpërblime prej Allahut!" Me këto hamendje ra përsëri rob i nefsit të vet dhe shkoi për herë të tretë tek Rasulallahu (a.s.):

"Betohem në Atë që të ka dërguar si Profet, se nëse më bën të pasur, do të mbroj të varfrit dhe do t'i jap të drejtën e tij çdokujt",- tha ai.

Më në fund, përballë këtyre këmbënguljeve të shumta, Rasulallahu (a.s.), iu lut Allahut:

"O Allah! Jepi Salebes atë që dëshiron prej kësaj dynjaje!"

Pa kaluar shumë, Allahu Teala i fali Salebes një pasuri të madhe. Tufat iu shtuan shumë. Mirëpo Salebja, i cili deri atëherë thirrej edhe me nofkën "zogu i mesxhidit", për shkak të angazhimit të tij me pasurinë dhe mallin, dalëngadalë u largua nga xhemati. Madje, pas një kohe filloi të vinte vetëm për namazet e xhumasë. Dhe pas disa kohësh, harroi edhe namazet e xhumave.

Një ditë, Rasulallahu (a.s.), që kishte pyetur për gjendjen e tij, tha:

"Sa keq për Saleben!.."

Mirëpo arroganca dhe injoranca e Salebes nuk përfundoi me kaq. Kur i erdhën nëpunësit për të mbledhur zekatin, ai u tha:

"Kjo që po bëni ju, nuk është gjë tjetër veçse mbledhje haraçi!" Pra, jo vetëm që nuk e dha atë për të cilën kishte premtuar më parë, por shkoi deri atje sa nuk donte të jepte as të drejtën më të vogël që është caktuar me Kuran për të varfrit dhe u bë prej munafikëve (hipokritëve).

Gjendja e tij shprehet më së miri edhe në këtë ajet:

"Ka nga ata (hipokritë) që kanë bërë besëlidhjen me Allahun, duke thënë: 'Nëse Ai na jep nga dhuntitë e Tij, sigurisht që do të japim lëmoshë dhe sigurisht që do të bëhemi njerëz të mirë!' Por kur Ai u dha atyre nga dhuntitë e Veta, ata u bënë koprracë dhe kthyen shpinën, duke u larguar." (Et-Teube, 75-76.)

Salebe, për shkak të mendjelehtësisë së tij nuk i dëgjoi këshillat e Profetit (a.s.), prandaj meritoi një përfundim të hidhur dhe fatkeq. Ai u mashtrua me pasurinë kalimtare të dynjasë dhe u bë fukarai i botës tjetër. Kur ishte duke dhënë shpirt, me një pendesë të madhe në veshët e tij tingëllonin fjalët e Profetit (a.s.):

"Pasuria e pakët, për të cilën mund të falënderosh, është më e mirë se pasuria e shumtë, për të cilën nuk do të mund të falënderosh..."

Mirëpo Salebe, i cili nuk ua vuri veshin këshillave dhe paralajmërimeve të Profetit (a.s.), dha shpirt me dhim-

bje dhe vështirësi, i mbytur në vorbullën shkatërruese të pasurisë kalimtare të dynjasë. Ai me mendjelehtësinë e tij, shkatërroi



"Pasuria e pakët, për të cilën mund të falënderosh, është më e mirë se pasuria e shumtë, për të cilën nuk do të mund të falënderosh..."

lumturi-
rinë e përjetshme, në këmbim të një pasurie të vogël për një kohë shumë të shkurtër, të cilën e pandehi lumturi.

Historia e Salebes është një shembull i përsosur, i cili na bën të kuptojmë mirë fundin e hidhur të atyre që luajnë me caktimin e Allahut dhe nuk respektojnë moralin dhe vlerën e vërtetë të duasë. Profeti ynë (a.s.), -mbase- ngaqë e dinte caktimin hyjnor në lidhje me Saleben dhe me qëllim që të bëhej shembull për brezat e ardhshëm, pranoi të bënte duanë pas këmbënguljeve të njëpasnjëshme të tij. Pra edhe ne, kur të kërkojmë diçka prej Allahut, duhet të dëshirojmë pranimin e lutjes tek Allahu pa u bërë këmbëngulës, duke menduar së tepërmi në është e mirë apo e keqe për ne. Përndryshe, mund të mos i shohim fatkeqësitë e fshehura brenda mirësive dhe si pasojë, mund t'i hapim vetes telashe dhe probleme të mëdha.

Me të vërtetë që duaja, ashtu si edhe sadakaja (lëmosha), mund të mos e ndryshojë caktimin (kaderin) absolut, por ajo mund të ndryshojë caktimin (kaderin) e varur. Mirëpo, është gabim i madh që vetëm me mendjen tonë të dobët të vlerësojmë se ai ndryshim është në të mirën apo në të keqen tonë. Duaja është një mirësi e madhe prej Allahut, madje është urdhri i Tij. Megjithatë, edhe pse brendësinë e saj mund ta mbushim me



mendimet dhe ndjenjat tona personale, nuk duhet të këmbëngulim në lidhje me atë se brendësia e saj është patjetër mirësi për ne. Për-

“Nëse biri i njeriut do të kishte dy lugina me ar, do të dëshironte edhe të tretën. Syrin e tij e mbush vetëm dheu. Allahu Teala e pranon pendimin e atyre që pendohen.”

kun-
d r a z i,

duhet të lutemi e të themi: “O Allah! Ma prano lutjen time, nëse është për mirë!”

Lakmia e birit të njeriut, shprehet kështu në një hadith fisnik:

“Nëse biri i njeriut do të kishte dy lugina me ar, do të dëshironte edhe të tretën. Syrin e tij e mbush vetëm dheu. Allahu Teala e pranon pendimin e atyre që pendohen.”

Lakmitari ndahet nga kjo botë:

1. I pangopur me ato që ka mbledhur.
2. Pa realizuar ato që shpresonte.
3. I privuar nga çdo lloj ëmbëlsie shpirtërore.

Tamahqarllëku që kaplon zemrën e lakmitarit, nuk lë aty as vendin më të vogël për dashurinë dhe sinqeritetin hyjnor. Sa humbje e madhe është kjo për ata që e kalojnë jetën e tyre duke mbledhur dhe depozituar mall e pasuri! Jeta e tyre bëhet si ajo loja për fëmijë, “hapadollapa” dhe përfundon me një fund të hidhur.

Në lidhje me jetën e kësaj bote, me të cilën nuk ngopet asnjë lakmitar, në ajetin 46, të Sures En-Naziat urdhërohet:

“Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.”

Oreksi i tepruar, me anë të të cilit lakmia shkatërron shpirtin e njeriut, na kujton ajetin ku Allahu Teala na jep disa pamje prej xhehenemit:

Atë Ditë Ne do ta pyesim Xhehenemin: “A u mbushë?” e ai do të përgjigjet: “A ka edhe më?” (Kaf, 30.)

Në një ajet tjetër, Allahu Teala shprehet kështu, në lidhje me lakmitarët:

“Lëri ata të hanë e të kënaqen dhe le t’i mashtrojë shpresa; ata do ta marrin vesh!” (El-Hixhr, 3.)

Historia e smirës, është e vjetër po aq sa krijimi i njeriut. Smira e parë fillon me sjelljen e Iblisit (shejtanit) ndaj Ademit (a.s.), kur e krahason veten e tij të krijuar prej zjarrit, me Ademin (a.s.), të krijuar prej balte. Edhe pse Iblisi kishte arritur gradë të lartë në dituri dhe qëndronte së bashku me melekët e Allahut Teala, ai ishte pajisur me “nefs (ego)” ashtu si njerëzit dhe ishte nga xhindet. Për shkak të kësaj tendence që karakterizonte natyrën e tij, ai nuk arriti ta kuptonte urtësinë hyjnore dhe, duke u mashtruar prej përbërjes tokësore të Ademit (a.s.), bëri krahasime ndërmjet vetes dhe Ademit (a.s.). Iblisi, i cili ishte krijuar prej zjarrit pa tym, mendoi se ishte më i lartë se Ademi (a.s.), i cili ishte krijuar prej baltës, prandaj dhe e pati smirë atë për rëndësinë që i dha Allahu Teala, duke i urdhëruar melekët të binin në sexhde para tij.

Më vonë, edhe ndodhia e Habilit dhe Kabilit, është një shembull i mirë, që tregon se sa i vjetër është koncepti i smirës në historinë njerëzore.

Një tjetër ngjarje mësimdhënëse në lidhje me smirën, është edhe historia e Jusufit (a.s.) dhe vëllezërve të tij. Vëllezërit e Jusufit (a.s.), ishin bijtë e një profeti të madh si Jakubi (a.s.) dhe ishin edukuar prej dorës së tij. Por megjithatë, ata e patën smirë vëllain e tyre Jusufin (a.s.) dhe kryen një gjynah shumë të madh, duke e hedhur atë në pus. Kjo ngjarje është shumë e rëndësishme, për faktin se tregon qartë fuqinë dhe egërsinë e tendencës së smirës tek njeriu.

Në një hadith fisnik urdhërohet:

“Kujdes! Mos kini smirë! Sepse smira i ha sevapet dhe mirësitë, ashtu siç i ha zjarri drutë.”

Smira është ajo që e varrosi në fund të dheut edhe Karunin me thesaret e tij, çelësat e të cilëve ishin aq të rëndë, saqë nuk mbaheshin në dorë.

Allahu Teala tregon fundin e Karunit në këtë ajet fisnik:

“Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t’i gëlltiste toka dhe askush nuk arriti ta mbronte nga dënimi i Allahut, madje as ai vetë nuk mund ta mbronte veten.” (El-Kasas, 81.)

Megjithëse smira është e qortuar dhe e refuzuar në çdo aspekt të saj, është një kuptim që shprehet si “zili e mirë” dhe nënkupton dëshirën e mirë të dikujt për të pa-



su r
edhe ai
një mirësi si të
dikujt tjetër, pa
dëshiruar që atij
t'i merret ajo mi-
rësi. Kjo lloj "zilie
/ dëshire e mirë"
është e lejuar.

Në një hadith fisnik thuhet:

"Vetëm dy persona mund të kihen zili. Njëri është ai person, të cilit Allahu Teala i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon në rrugë të Tij. Ndërsa tjetri, është ai person të cilit Allahu Teala i ka dhënë dituri dhe ai, përveçse punon me të, ua mëson edhe të tjerëve." (Buhari, Muslim.)

Pra, zili mund të kihet vetëm i pasuri që dhuron pasurinë e tij në rrugë të Allahut dhe dietari që e bën diturinë e tij të dobishme për njerëzit. Kjo lloj zilie është lloji i smirës së kthyer në urtësi dhe virtyt. Zili kihet personalitetet shembullore, si profetët dhe robërit e mirë të Allahut.

Kurimi i vetëm i lakmisë dhe smirës, që janë më të rrezikshmit e moralit të keq, është përvetësimi i qetësisë shpirtërore të mjaftueshmërisë. Kjo, sepse thesaret hyjnore që i fal mjaftueshmëria zemrës, as nuk pakësohen dhe as nuk mbarojnë. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Mjaftueshmëria është një thesar që nuk pakësohet dhe nuk mbarohet."

Kjo do të thotë se kriteri i vërtetë i pasurisë, është mjaftueshmëria. Të jesh i kënaqur me caktimin hyjnor. Të mos kesh smirë të tjerët që kanë më tepër mundësi se sa ti. Ëmbëlsia e vërtetë e pasurisë mund të shijohet vetëm me anë të mjaftueshmërisë.

Mevlana Xhelaledin Rumi është shprehur:

"Vdisni për t'u ringjallur, për të arritur bukurinë dhe pasurinë e vërtetë!"

Mirëpo, duhet pasur parasysh se bukuria kërkon sy që do ta shohin dhe zemra që do ta duan. Ashtu si sytë që s'shohin, nuk vlerësojnë bukurinë edhe veshët që s'dëgjojnë nuk vlerësojnë poezinë, ashtu edhe grykësit e pangopur nuk e ndjejnë paqen dhe qetësinë që të fal mjaftueshmëria. Cila poezi është për të shurdhërit dhe cila aromë trëndafil apo misku është për hundët që nuk ndjejnë aromë?..

Myslimani i mirë nuk qahet për vështirësitë e arritjes së riskut dhe mirësive. Ai nuk shkon pas riskut (furnizimit), por pas Rrezakut (Furnizuesit). Ai nuk shikon mundësitë dhe mirësitë e të tjerëve, por gjithmonë është i kënaqur me atë që ka.

Sa kuptimplotë dhe mësimdhënës është ky dialog që zhvillohet ndërmjet Ibrahim bin Et'hemit dhe Shakik-i Belhit:

Shakik-i Belhi e pyet Ibrahim bin Et'hemin:

-Si e siguroni jetesën?

Ibrahim bin Et'hemi përgjigjet:

-Kur gjejmë falënderojmë, kur nuk gjejmë durojmë..!

Shakik-i Belhi thotë:

-Kështu bëjnë edhe qentë e Horasanit!

Pas këtyre fjalëve, Ibrahim bin Et'hemi e pyet:

-Po ju, çfarë bëni?

Shakik-i Belhi përgjigjet:

-Kur gjejmë, falënderojmë dhe dhurojmë. Kur nuk gjejmë bëjmë durim duke falënderuar.

Ja pra, ata që mund ta arrijnë këtë gradë, arrijnë lumturinë në të dyja botët. Por ata të cilët jetojnë vetëm për të kënaqur dëshirat e trupit dhe të nefsit, padyshim që do të kenë përfundim të hidhur. Për ata që i robërojnë përpjekjet dhe mundësitë për kënaqësitë e nefsit, nuk mund të mendohet asnjë lloj ëmbëlsie shpirtërore. Ndërsa ata që janë të kënaqur dhe mjaftohen me atë që kanë, janë të pasurit dhe bujarët e vërtetë të shpirtit dhe zemrës. Atyre u takon paqja dhe lumturia.

Zemra e robit të mirë të Allahut është përtej mallit dhe pasurisë. Ai nuk pasurohet me to, sepse robi i mirë, syri i të cilit është i ngopur me Allahun Teala, me ekzistencën e vet pasuron zemrat e të tjerëve.

O Allah! Na ruaj nga flakët e zjarrit të lakmisë dhe smirës që i djegin dhe i bëjnë hi punët e mira dhe na zbukuro me mjaftueshmërinë, që është një thesar, i cili nuk pakësohet e nuk mbarohet!

Amin!...


Sekreti i Lutjes

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Që në zanafillën e vet në këtë botë, njeriu ka qenë në përpjekje të vazhdueshme për të kaluar nga gjendja e frikës në gjendjen e sigurisë, nga pesimizmi në optimizëm, nga dhimbja në kënaqësi, nga trazimi dhe pështjellimi në qetësi dhe qartësi. Ndoshta edhe qëllimi i vendosjes së Ademit në parajsë ka pasur për qëllim qetësimin dhe sigurinë e tij.

Gjëja që më së shumti i shkakton shqetësim dhe trondije njeriut është frika dhe telashet, të cilave nuk ua shpjegon dot shkakun. Prandaj Kurani thekson: **"Miq të Allahut nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe dëshpëruar."** (Junus, 62), po ashtu u bën thirrje atyre që kanë qenë të vendosur në rrugën e drejtë se gjatë gjendjes së agonisë do të zbresin engjëjt për t'i qetësuar, duke u thënë: **"Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar."** (Fussilet, 30)

Sekreti dhe mënyra e vetme për të shpëtuar nga dëshpërimi, brenga dhe frika është besimi, vepra e mirë, devotshmëria dhe lutja. Nga theksimi që ajetet i bëjnë lutjes dhe ibadetit, kuptohet lehtësisht rëndësia e një shpirti të pastër dhe një zemre të qetë e të kënaqur në marrëdhëniet e



njeriut me Krijuesin. Lutja është dydimensionale: lutja për veten dhe lutja për të tjerët.

LUTJA PËR VETEN

Lutja për veten është një thirrje e çiltër, një kërkesë e sinqertë dhe përgjërimit plotë, drejtuar Allahut. Kjo thirrje e përzemërt ngjitet lart tek Krijuesi dhe Sunduesi i gjithësisë. Kjo thirrje arrin në botën e amëshuar, ku takohet me mëshirën hyjnore, për të zbritur më pas në gjendje të pastër, të kulluar dhe plot begati në zemrën e njeriut. Arritja e lutjes te Krijuesi Fuqplotë është e lidhur ngushtë me gjendjen e lutësit për të kalur përtej vetvetes, për të dëgjuar në vend të zërit të vet zërin e Allahut. Lutja e bërë në këtë mënyrë, është e destinuar të pranohet dhe plotësohet nga Krijuesi dhe Zotëruesi i gjithësisë.

Duart që i drejtohen Allahut, gjuha që kujton Atë dhe zemra që digjet nga dashuria për Të, fshin të gjithë mëkatet, djeg të gjitha papastërtitë tek njeriu, duke kultivuar në vend të tyre ndjenja të pastra. Sepse është e pamundur që gjendjet e kundërta të grumbullohen së bashku në një vend. Ashtu siç largohet errësira kur vjen agimi, largohen mëkatet nga njeriu, pastrohet zemra nga pikëllimi dhe brengat, kur aty mbërrin *dhikrullah*. Mjafton që personi të jetë i sinqertë, i çiltër dhe i përkushtuar në ibadetin, lutjen dhe përmendjen e Allahut.

Lutja është urdhëruar nga vetë Allahu, përndryshe nga do ta merrte guximin krijesa prej balte, për t'i kërkuar diçka Krijuesit! Allahu e pranon lutjen, nëse ajo plotëson kriteret e vendosura nga vetë Ai. Plotësimi i lutjes është diçka shumë e thjeshtë për Allahun, i Cili dheun e shndërron në ar dhe po nga dheu krijon njeriun e parë. Krijuesi i gjithësisë është gjithmonë në krijimin e diçkaje të re dhe në përmbushjen e mirësive dhe bujarisë së Tij ndaj krijesave. Kurse njeriu është i prirur të mëkatojë, duke harruar mirësitë dhe bujarinë e Allahut ndaj tij. Lutja drejtuar Allahut bën të mundur që hidhërimi i Allahut për gabimet dhe harresën e njeriut të shndërrohet në durim dhe butësi. Mjafton vullneti i Allahut, për ta shndërruar zjarrin në ujë dhe anasjelltas. Allahu është Ai që i ka dhënë njeriut dëshirën për t'u lutur dhe është po Ai që e pranon atë. Përderisa Allahu na ka urdhëruar për t'u lutur, njeriut i bie për detyrë të kërkojë nga mirësitë e pafundme dhe të pashtershme të Allahut.

LUTJA PËR TË TJERËT

Lutja është përpjekje e njeriut për të vënë në lëvizje Mëshirën Hyjnore. Prandaj, lutja reciproke për njëri-tjetrin është po aq e rëndësishme sa lutja për veten.

Sekreti i lutjes qëndron në një gjuhë të pastër dhe në një zemër të sinqertë e pa interesa. Inkurajimin për t'u lutur për njëri-tjetrin e gjejmë shpesh në porositë e Pejgamberit (a.s.), si:

a. *"Lutja e një personi musliman për vëllain e tij, jo të pranishëm, pranohet. Te koka e lutësit ndodhet një engjëll i posaçëm, i cili, kur lutësi bën një lutje në dobi të vëllait të tij, ai lutet: 'Pranoje o Zot! Dhuroja edhe lutësit të njëjtën gjë!'"* (Muslim, Dhikër, 87,88)

b. *Kur të gjendeni pranë një të sëmuri apo të vdekuri, lutuni për të mirën e tyre, sepse melekët thonë: 'Pranoje lutjen e tyre, o Zot!'"* (Muslim, Xhenaiz, 6)


c. *Dy lutje nuk refuzohen. Midis këtyre dhe Allahut nuk ka perde. Njëra është lutja e atij që i është bërë padrejtësi dhe tjetra lutja e fshehtë e besimtarit për vëllain besimtar."* (Taberani, Muxhemul kebir, XI, 119)

Mevlana, duke u nisur nga hadithet e mësipërme, e shpjegon kështu sekretin dhe rëndësinë e lutjes përmes gojës së tjetrit: "Ngaqë ti nuk ke bërë mëkat me gojën e tjetrit, ajo gojë është e pastër dhe pa mëkate për ty. Njeriu duhet të kultivojë sjellje të atilla, që goja e të tjerëve të lutet për të natë-ditë.

Të fitosh lutjen e të tjerëve, është një përfitim i paçmuar. Sepse lutja e të tjerëve ushqen ndjenjat e qetësisë dhe gëzimit tek njerëzit dhe bëhet shkak për zbritjen e qetësisë shpirtërore. Ashtu si zekati pastron pasurinë e njerëzve edhe lutja, veçanërisht lutja e Pejgamberëve dhe evlijave u jep njerëzve qetësi shpirtërore, siç theksohet në ajetin: **"Merr nga pasuria e tyre lëmoshë, me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ta."** (Teube, 103)

Përfitimi më i madh që sigurojnë ata që luten, është ndjenja e qetësisë dhe sigurisë shpirtërore dhe grada më e lartë e kësaj qetësie është "sekîna", e cila sipas disa thënieve të Profetit Muhamed (a.s.), të regjistruara në librat e Buhariut dhe të Muslimit, shpreh një prani shpirtërore që zbret së bashku me engjëjt, për të sjellë qetësi në shpirtrat e besimtarëve të devotshëm.

Ajeti kuranor thekson pikërisht këtë lloj qetësie: **"Ne të dhamë ty një fitore të qartë, për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë dhe që Allahu të të japë ndihmë të madhe. Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t'ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."** (El-Feth, 1-4)



Është pikërisht qetësia që jep lutja, sekreti i sigurisë që krijohet midis njeriut dhe Krijuesit për t'u përhapur më tej midis njerëzve. Ky sekret i lutjes fiton një rëndësi tepër të veçantë në rolin e tij për të kultivuar paqen e brendshme të njeriut dhe krijimin e një paqeje e sigurie sociale. Në sajë të këtij sekreti të lutjes, njerëzit që luten për njëri-tjetrin tejkalojnë frikën dhe pasigurinë, duke krijuar një shoqëri të mbështetur në dashuri dhe respekt për njëri-tjetrin.

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: ‘Paqe qoftë!’; dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë dhe ata që thonë: ‘O Zoti ynë, largoje prej nesh ndëshkimin e Xhehenemit, sepse, me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm.’” (Furkan, 63-64)

Thelbësore në lutje janë sinqeriteti, mirësia dhe strehimi tek mirësitë dhe begatitë e Allahut me një zemër të brishtë. Sepse begatia dhe mirësia e Allahut është pranë zemrave të brishta dhe të buta. Për një lutje frytdhënëse, duhen pastruar të gjitha organet nga papastërtitë materiale dhe shpirtërore. Përndryshe, fjalët e lutjes nuk shprehin ndonjë rëndësi në vetvete pa pastrimin trupor dhe shpirtëror së bashku. Në lidhje me këtë, tregimi i Mevlanës, që flet për mënyrën e lutjes së një çobani në kohën e Musait (a.s.), është shumë domethënëse.

Kur Musai (a.s.), po kalonte një ditë në shkretëtirë, pa një çoban, i cili i lutej Zotit. Në lutjet e tij ky çoban përdorte një fjalor shumë të thjeshtë dhe popullor dhe Zotit i qe drejtuar me këto fjalë: “O Zot, ma trego vendin ku ndodhesh, sepse dua të të shoh. O Zot, dua të të ndihmoj në çastet e vështira dhe të jem ngushëlluesi Yt. O Zot, gjithë pasurinë time e flijoj për Ty dhe të gjitha këngët që ua këndoj dhenve do t’i kushtoj Ty”. Kur Musai (a.s.), i dëgjoji këto fjalë, iu afrua dhe e pyeti se me kë po bisedonte në këtë mënyrë.

Çobani iu përgjigj se ishte duke folur me Krijuesin e tij. Me Krijuesin e çdo gjëje në këtë botë. Hz. Musai e qortoi çobanin në lidhje me këtë lutje dhe i tha se lutja e tij ishte blasfemi. E urdhëroi të mbyllte gojën dhe të mos lutej ashtu, sepse ato që thoshte ishin nevoja të njeriut, si ngrënia, pija, fjetja dhe Zoti ishte larg këtyre gjërave.

“Nëse ti nuk i ndalon këto lutje blasfemike,- iu drejtua ai çobanit,- atëherë Zoti do të zemërohet dhe do ta shkatërrojë këtë botë. Dhe mos harro se ti cilësitë e njeriut po ia atribuon Zotit të Madhërishtëm, në kohën kur Zoti është shumë më i lartë dhe më i mirë.”

Hz. Musai foli shumë fjalë të këtilla me çobanin dhe e poshtëroi shumë atë. Çobanit iu thye zemra dhe u pikëllua shumë, kurse po në atë moment kërkoi falje

nga Hz. Musai dhe nga pikëllimi i madh shqeu këmishën e tij. Nga brendësia nxori një rënkim të madh dhe mori rrugën. Si i çmendur dhe i dashuruar u sul në drejtim të shkretëtirës dhe, duke dënesur, humbi thellë në horizontin e saj. Në këtë moment, nga ana e Zotit të Madhërishtëm, Musait (a.s.), i zbriti shpallja:

“O Musa, pse e largove robin Tim nga adhurimi dhe e bërë atë të pashpresë nga mirësia dhe mëshira Ime. Unë nuk i marr parasysht gjërat e jashtme të robit, sepse për Mua, brendësia e tij e bazuar në sinqeritet dhe dashuri është shumë më e rëndësishme, sesa pamja e tij e jashtme. O Musa, njerëzit që më kërkojnë dhe më duan Mua janë të ndjeshëm dhe zemërbutë. Sikur brenda Qabes humb kuptimi i drejtimit nga Qabja, në cilindo drejtim, ata janë të kthyer nga Unë. Për robin e dashur dhe të devotshëm nuk ekzistojnë rregulla të caktuara. Adhurimi dhe përkujtimi i tij, në çfarëdo guhe dhe mënyre të bëhet, është i pranueshëm tek Unë.”

Kur Musai (a.s.), i dëgjoji këto fjalë të Zotit, filloi ta kërkonte çobanin e humbur dhe pasi e gjeti, ia tregoi çdo gjë që kishte ndodhur: “Zoti i ka dëgjuar lutjet dhe fjalët e tua dhe është i kënaqur nga dashuria dhe sinqeriteti yt. Prandaj falu dhe lutu si të dëshirosh. Zemra jote është e pastër dhe ka arritur të vërtetën.”

Besimi është bindje e plotë, kurse lutja është strehim tek kjo bindje. Lutja është një kërkesë e sinqertë e besimtarit, drejtuar Allahut Fuqiptotë. Lutja është mburoja e besimtarit dhe vendstrehimi i shpirtave të trazuar e të brengosur. Prandaj, njerëzit e urtë në përgjithësi janë personat që më së shumti bëjnë dua. Ata i luten vetëm Allahut për largimin e vuajtjeve, fatkeqësive, problemeve dhe shqetësimeve.

Kurse një grup tjetër i njerëzve të arrirë, duke e konsideruar çdo gjë që vjen prej Allahut si të mirë, e presin me kënaqësi caktimin e Allahut në të gjitha format e shfaqjes së tij. Këta, duke qenë të kënaqur me çdo lloj caktimi të Allahut, nuk luten për largimin e caktimit hyjnor të shfaqur në formë vuajtjesh dhe mundimesh, por e mirëpresin me kënaqësi atë. Siç shprehet poeti: “O Zot! Më bëj prej tyre që i presin fatkeqësitë me dashuri”.

Mosinteresimi i tyre për lutjen dhe përjetimi i kënaqësisë nga vuajtjet dhe shqetësimet që i servir caktimi hyjnor, rrjedh nga bindja e plotë ndaj ajetit kuranor: ***“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me pak frikë dhe uri, me pak dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit”*** (Bekare,155) Por kjo rrugë është e vështirë dhe e mundimshme dhe nuk mund ta kalojnë të gjithë. Lutja nuk është thjesht artikulimi i një sërë kërkesash, por një gjest sublim, që buron nga një zemër e sinqertë dhe sy i përplotur. Si përfundim, një jetë e qetë dhe e lumtur, si në planin individual, ashtu edhe në planin shoqëror arrihet përmes një jete të mbushur me lutje.

“Unë jam lutja e babait tim Ibrahimit dhe sihariqi i Isait!”

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

24 janar 2013. Nga Lindja në Perëndim, mbarë ymeti islam përkujton lajmin e përvitshëm, gëzimin dhe sihariqin e përbotshtëm të lindjes së “mëshirës së dhuruar”, më të mirit të krijesave njerëzore, më të dritshimit e më të dashurit, hz. Muhamedit (a.s.).

Në vetvete, kjo ditë është një mundësi kohore për të ndjerë emocionin dhe dashurinë e përjetimit të një besëlidhjeje, një dashurie të pastër e një përbetimi të përshtirshëm, ashtu si ditën kur dalim para penxheres, pas së cilës ndodhet varri i tij (a.s.), para të cilit qëndrojmë të shkëputur nga kjo botë, duke dëshmuar me zemër, para se ta përkthejë gjuha: “Es-selamu alejke ja Resulall-llah”...

Duke lexuar me vëmendje në Kuranin Famëllartë, do të gjejmë argumente të bollshme, që vërtetojnë se lajmin e mirë të lindjes dhe shfaqjes në këtë botë të hz. Muhamedit (a.s.), Zoti i gjithësisë e ka bërë si një lajm shprese, optimizmi dhe shprehjeje të dashurisë së Tij për mbarë njerëzimin.

Lajmin e gëzueshëm të ardhjes në këtë botë të “mëshirës së dhuruar”¹ e paralajmëruan edhe profetët më të mëdhenj të historisë së njerëzimit, siç dëshmojnë argumentet.

Hz. Muhamedi (a.s.), është përgjigja e Zotit ndaj lutjes së hz. Ibrahimit (a.s.), i cili i drejtohej Allahut me këto fjalë: **“Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga mesi i tyre një të dërguar që t’u lexojë atyre ajetet e Tua, t’u mësojë atyre librin dhe urtësinë e t’i pastrojë (prej ndyrësisë së idhujtarisë). S’ka dyshim se Ti je ngadhënyyesi, i dijshti”**.² Duke komentuar domethënien e thënies:

“një të dërguar” në ajetin e lartpërmendur, Imam Kurtubiu thotë: “D.m.th: Muhamedin (a.s.). Transmeton Halid ibni Ma’den se disa prej sahabëve i thanë: “Na fol për veten, o i Dërguar i Allahut.” Ai tha: “Po, unë jam lutja e babait tim Ibrahimit dhe sihariqi i Isait”³”⁴

Hz. Muhamedi (a.s.), është sihariqi që hz. Isai (a.s.), u dha beni israilëve. Këtë përgëzim e dëshmon Kurani Famëllartë: **“Dhe, kur Isai, biri i Merjemes tha: ‘O beni israilë, unë jam i dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Teuratit, që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!’ E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: ‘Kjo është magji e hapët’**”⁵

Ngjashëm me kuptimet e këtij ajeti kuranor, ndodhet edhe në Biblën e sotme: “Edhe unë do t’i lutem Atit dhe Ai do t’ju japë një Mbrojtës⁶ tjetër, që të jetë me ju përgjithmonë...”⁷

Ish-priifti katolik keldan David Benjamin Keldani (më vonë i konvertuar në mysliman, Abdul-Ehad Davud), shpjegon se në përkthimin e këtij verseti biblik ka një gabim të bërë në përkthimin e emrit “Periklitos – I meritueshëm për lavde; Ahmed”, (jo “Paraklitos”, si në versionin italisht, që është edhe ai shqip: “Mbrojtës”). Shkruan: “Për shekuj të tërë, evropianët dhe latinët e paditur e shkruan emrin “Muhamed” si: “Mahomet”,



"Ajo çfarë i frikëson më së tepërmi perëndimorët sot,
është lindja e një "Muhamedi" të ri
–jo në kuptimin praktik,
sesa lindja e atij që bashkon arabët dhe myslimanët-
Ata nuk e dinë se me lindjen e një "Muhamedi" të ri,
do t'u vijë fundi problemeve të botës,
që ata vetë krijuan,
tamam siç thonë filozofët e tyre,
se sikur të ishte Muhamedi (a.s.) i gjallë,
do t'i zgjidhte problemet e botës
duke pirë një filxhan me kafe".

Shejkh Ahmed Keftaro

ose emrin "Mushi", si: "Moses". E pse të jetë e çuditshme që një nga murgjit katolikë ta ketë ngatërruar emrin "Periqlytos" në "Paraklytos"? Sepse emri i parë (Periqlytos) do të thotë: "i mirënjohuri, i meritueshmi për lavde", (d.m.th: Ahmed, si në Kuran. – shënimi im. –M.S.-), ndërsa fjala e dytë (Paraklytos) do të thotë: "Ngushëlluesi, Mbrojtësi".⁸

Në lidhje me devijimin e emrit gjatë përkthimeve, Shejkh Ahmed Didat shkon edhe më larg se prof. A. Davud, thotë se: "Specialistët e teologjisë thonë se "Paraklytos" është devijim në lexim i fjalës "Periqlytos"... Por, edhe nëse e lexojmë "Paraklytos", ajo tregon për profetin e nderuar, që ishte mëshirues për të gjitha krijesat (Kurani, El-Enbija: 107)..."⁹, sepse: ["Mbrojtësi", ose "Ngushëlluesi" (nga përkthimi i këtij verseti biblik në arabisht –shënimi im. –M.S.-), nuk mund të jetë "Shpirti i Shenjtë", pasi verseti biblik thotë: "Edhe unë do t'i lutem Atit dhe Ai do t'ju japë një Mbrojtës tjetër që të jetë me ju përgjithmonë..."¹⁰ dhe unë dua të vërtetoj se fjala: "tjetër" në versetin e lartpërmendur, nënkupton një person të ndryshëm nga i pari. Pra, një person tjetër, nga i njëjti lloj, edhe pse i ndryshëm nga i pari. Po kush është "Mbrojtësi" i parë? Mbarë bota e krishterë është në një fjalë se ai është Jezusi (a.s.). Atëherë, "tjetri", që do ta pasojë, duhet të jetë nga e njëjta natyrë, i njëjti lloj, që ka uri, që ka etje, që lodhet, që ndjen keqardhje dhe që vdes..."]¹¹

H.z. Muhamedi (a.s.), është "Shenjt prej malit Faran"¹², për të cilin prof. Abdul-Ehad Davud duke e vërtetuar shkencërisht dhe pas një analize të gjatë teologjike, konkludon: "A mund të jetë kush tjetër i nënkuptuari i këtyre fjalëve me njeriun e Faranit (Mekkës), përveçse ai, Muhamedi?"¹³

Nuk ka asnjë dyshim se Zoti i gjithësisë i ka bërë të dukshme dhe të prekshme për këdo argumentet e dërgesës profetike të h.z. Muhamedit (a.s.), për çdo njeri besimtar në Librat e Shenjtë. Për këtë, në Kuranin Famëlartë dëshmon se: "**Mëshirën do ta caktoj për ata të cilët u ruhen (mëkateve), e japin zekatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona. Që pranojnë të dërguarin (Muhamedin), Pejgamberin që nuk shkruan as nuk lexon, të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Teurat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta**".¹⁴

Në profecitë e Danielit, të regjistruara në Bibël, përmendet "Biri i njeriut": "...po vinte dikush si Biri i njeriut! Arriti deri tek i Tejetlashti i motit dhe qe paraqitur para tij. Ai i dha pushtetin, nderin e mbretërinë. Të gjithë popujt, fiset e gjuhët u shtruan nën shërbimin e tij: pushteti i tij, pushteti i amëshuar që kurrë s'do të merret, mbretëria e tij nuk do të priset"¹⁵ (Ndërsa për llogapin "Biri i njeriut", prof. Abdul-Ehad Davud thotë: "Është e pamundur që me llogapin "Biri i njeriut" të nënkuptohet një person tjetër, pos Muhamedit"¹⁶ dhe jep shpjegime të bollshme rreth këtij fakti).

Në librin e tij: "El-hivarul-islamit-mesih", Dr. Bessam Axhik, duke shkruar për sihariqet e ardhjes së h.z. Muhamedit (a.s.), në Biblën e sotme, në sihariqin e katërt, përmend: "Ky sihariq ndodhet në Besëlidhjen e re në formë pyetjeje, që jehudët ia drejtuan Gjon Pagëzorit – H.z. Jahja (a.s.) – si më poshtë: "Dhe ja, dëshmia e Gjonit! Kur judenjtë nga Jerusalemi dërguan (tek ai) priftërinj dhe levitë për ta pyetur: "Kush je ti?" ai pranoi, nuk mohoi, por dëshmoi: "Unë nuk jam Mesia"...

Disa prej të dërguarve ishin farisej. Ata e pyetën: "Pse atëherë pagëzoni, kur s'je as Mesia, as Elia, as Profeti?" Gjoni përgjigji: "Unë pagëzoi me ujë. Në mesin tuaj është një që ju nuk e njihni. Është ai që po vjen mbas meje, por të cilit [unë] nuk jam i denjë t'ia zgjidh as rripat e sandaleve"¹⁷...¹⁸

Në librin e tij: "El-mizan fi mukarenetil-edjan", prof. Muhamed Izet Et-Tahtavi, në kapitullin: "A është "Shpirti i së Vërtetës" në Ungjillin e Gjonit, Profeti Muhamed (a.s.)?", shkruan se: "Duke iu referuar Ungjillit të Gjonit 16/13: "E kur të vijë ai – Shpirti i së Vërtetës – Ai do t'ju udhëzojë ta njihni tërë të Vërtetën. Ai s'do të flasë prej vetvetes, por do të flasë ç'ka të dëgjojë dhe do t'jua zbulojë të ardhmen"¹⁹, themi se këto janë fjalë që nuk mund të besohen vetëm se për një njeri që i vjen shpallja hyjnore nga qielli, ai nuk flet nga vetja e tij... kjo profeci vërtetohet në veten e saj dërgesën e Profetit të Islamit, Muhamedit (a.s.), pasi ai ishte njeri që i vinte shpallja nga qielli dhe ua përcillte njerëzve pasi e dëgjonte..."²⁰

Them: Ky përshkrim është i ngjashëm edhe me atë që bën Allahu (xh.sh.), në Kur'an, kur flet për të dërguarin e Tij, Muhamedin (a.s.), në suren "En-Nexhm": "**Shoku juaj (Muhamedi që ju e njihni) as nuk është njeri që ka humbur, as që ka devijuar (nga e vërteta). Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kurani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet**"²¹

Këto argumente e të tjerë të ngjashme, duhet të na afrojnë edhe më shumë me besimin në Një Zot dhe në dërgesat e Tij profetike. Është një arsye më shumë që pasuesit e besimeve monoteiste të bashkëpunojnë më shumë për forcimin e dialogut ndërfetar, me qëllim njohjen dhe afrimin e mëtejshëm me vërtetësitë shekullore. Ashtu sikurse thotë edhe prifti francez Luazon: "Zoti është Zoti, ndërsa Muhamedi, Jezusi dhe Moisiu janë të dërguarit e Tij! Kjo është formula e feve, të cilën do ta njohin bijtë e së ardhmes, meqë bijtë e së sotmes s'janë përgatitur për të!"²²

Madhërimin dhe vendin e lartë të Resulull-llahut (a.s.), Zoti e ka dëshmuar edhe nëpërmjet sures që mban emrin e Zotërisë së bijve të Ademit, *sureja Muhamed*.

Duke e lidhur besimin, begatinë, faljen e gabimeve dhe mbarësinë në jetë edhe me besimin në dërgesën

profetike të hz. Muhamedit (a.s.), në ajetin 2 të saj, Allahu (xh.sh.), urdhëron: "**Ndërsa atyre që besuan, bënë vepra të mira dhe e besuan atë që iu shpall Muhamedit, që është e vërteta prej Zotit të tyre, Ai atyre do t'ua shlyejë gjynahet dhe do t'ua përmirësojë gjendjen**".

Sot, teksa përjetojmë së bashku emocionet dhe atmosferën e begatë të ditës së Lindjes së Vulës së të Dërguarve të Zotit, duhet të angazhohemi përherë e më tepër që emri i Muhamedit tonë, Zotërisë tonë, të Madhit tonë, të nderohet, të duhet, të lartësohet, të respektohet në këtë tokë e kudo që të jemi!

Këtë, ta bëjmë me sjelljen dhe veprat tona, që të përngjasohemi përherë e më shumë me moralin e tij, që ishte, -sikurse e përshkruan nëna e jonë Aishe (r.a.)- "Kurani!"

Referencat:

1. Në hadithin e transmetuar nga Hakimi, nga Ebu Hurejra (r.a.), Resulull-llahi (a.s.), thotë: "Unë jam mëshirë e dhuruar".

2. Kur'ani: 2:129.

3. Transmetuar nga Ahmedi në Musnedin e tij 4/127-128 dhe 5/262.

4. Ebu Abdull-llah Muhammed ibn Ahmed El-Ensari El-Kurtubi, "El-xhamiu liahkamil-Kur'an", botimi II, Kajro, 1996, vëll. I, fq. 136.

5. Kur'ani: 61:6.

6. Në një botim në italisht të Biblës, thuhet: "Io pregherò il Padre ed egli vi darà un altro Paraclito..." - (La Bibbia, edizioni San Paolo, 1997, fq. 1111). Në shqip: "Unë do t'i lutem Atit dhe Ai do t'ju japë një tjetër Paraclit..." (Përkthim imi -M.S.-).

7. Bibla, Ungjilli sipas Gjonit, 14/16, Ferizaj, 1994, fq. 1532.

8. Prof. Abdul-Ehad Davud, "Muhamedi në librin e jehudëve dhe të krishterëve", Xhidde, 1414 h, fq. 174.

9. Ahmed Didat, "Muhamedi (a.s), kalifi i natyrshëm i Mesihut (a.s.)", në gjuhën arabe, Kajro, 1991, fq. 38-39.

10. Bibla, Ungjilli sipas Gjonit, 14/16, Ferizaj, 1994, fq. 1532.

11. Ahmed Didat, "Muhamedi (a.s.), kalifi i natyrshëm i Mesihut (a.s.)", në gjuhën arabe, Kajro, 1991, fq. 51-52.

12. Bibla, Profecia e Habakukut, 3/3, Ferizaj, 1994, fq. 1284.

13. Prof. Abdul-Ehad Davud, "Muhamedi në librin e jehudëve dhe të krishterëve", Xhidde, 1414 h, fq. 12.

14. Kurani: 7:156-157.

15. Bibla, Profecia e Danielit, 7/13-14, Ferizaj, 1994, fq. 1219.

16. Prof. Abdul-Ehad Davud, "Muhamedi në librin e jehudëve dhe të krishterëve", Xhidde, 1414 h, fq. 68.

17. Bibla, Ungjilli sipas Gjonit, 1/19-27, Ferizaj, 1994, fq. 1505-1506.

18. Dr. Bessam Axhik, "El-hivarul-islamit-meshih", botimi II, Damask, 2008, fq. 354-355.

19. Bibla, Ungjilli sipas Gjonit, 16/13, Ferizaj, 1994, fq. 1534.

20. Muhamed Izet Et-Tahtavi, "El-mizan fi mukarenetil-edjan", botimi I, Damask, 1993, fq. 364.

21. Kur'ani: 53: 2-4.

22. Shejkh Ahmed Keftaro, "Min hedjil-Kur'an", Damask, pa vit botimi, fq. 213. Përgatitur për botim nga Zahir Ebu Davud.



DUAJA

NË KONTEKSTIN BESIMOR

Ma. Orhan Bisllmaj

HYRJE

Për 'lutjen', si një akt shpirtëror i njeriut, në gjuhën arabe ka shumë shprehje që drejtpërdrejt apo tërthorazi e shprehin atë. Mirëpo, shprehja më adekuate për 'lutjen', është fjala 'dua', e cila në aspektin etimologjik është infinitiv i foljes së gjuhës arabe: 'deaa', jed'u da'ven, da'veten, du'aaen dhe da'vaa, që do të thotë: *kërkoj prezantimin e tij*. Ajo ka edhe shumë kuptime të tjera, varësisht prej pozitës së saj në fjali. Kur përdoret në sferën fetare me të synohet "thënia, me të cilën njeriu i lutet Allahut"! Ndërsa në aspektin terminologjik të fjalës, duaja si term kuranor dhe besimor manifeston: "kërkesën e njeriut ndaj Krijuesit të tij, që t'i largojë të dëmshmen apo t'i sjellë të dobishmen"²

LLOJET E DUASË

Duaja, për nga aspekti i adresimit të saj, është dy llojesh:

1. Duaja ndaj njeriut për një çështje të caktuar. Ky lloj i duasë është kërkesë për përmbushjen e ndonjë nevoje dhe lejohet të bëhet edhe ndaj njerëzve, por duke besuar se njeriu është një shkak për përmbushjen e kërkesës së saj, e assesi nuk është krijues që e mundëson përmbushjen e kërkesës.

2. Duaja ndaj Allahut. Kjo dua bëhet ndaj Allahut të Madhërishëm, në cilësinë e Tij si Krijues për çdo gjë që njeriu as-

piron, duke synuar shpërblimin e Tij dhe duke u frikësuar prej dënimit të Tij. Ajeti: "**Adhurojeni (luteni) Allahun me një adhurim (lutje) të sinqertë ndaj Tij...**" (Gafir, 14), argumenton qartë se ky lloj i duasë konsiderohet adhurim (ibadet) ndaj Allahut dhe bërja e saj edhe ndaj dikujt tjetër konsiderohet politeizëm i madh (shirk). Për këtë, Allahu ka kërcënuar: "**... e ata që nga mendjemadhësia i shman-gen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në xhehenem.**" (Gafir, 60).

LEGJITIMITETI I DUASË (LUTJES)

Argumentet që dëshmojnë legjitimitetin e lutjes ndaj Allahut, janë nga Kurani dhe Hadithi. Në shumë prej ajeteve, Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët për lutje. Ai thotë: "**Luteni Zotin tuaj, të përulur e në heshtje, sepse Ai nuk i do ata që e teprojnë.**" (El-Araf, 55). Po ashtu, i Lartësuari thotë: "**E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të**

qenë ata të udhëzuar drejt, le të më përgjigjen Mua dhe le të më besojnë Mua.”

Po ashtu, ekzistojnë shumë hadithe të vërteta që dëshmojnë se Pejgamberi (a.s.), i është drejtuar Allahut me dua. Transmetohet se Pejgamberi (a.s.), thoshte:

“O Allahu im, kërkoj nga Ti udhëzim në rrugën e drejtë, devotshmëri ndaj Teje, faljen e mëkateve dhe begati.” (Transmeton Muslimi). Duke parë rëndësinë që ka duaja në jetën e besimtarit, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Duaja është truri i ibadetit” (Transmeton Tirmidhiu), ndërsa në versionin tjetër, të cilin e transmeton imam Tirmidhiu nga Nu'man bin Beshir, i cili ka thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin (s.a.v.s.), duke thënë:

“Duaja është adhurim / ibadet”, pastaj e lexoi ajetin: **“Më thirrni Mua, e Unë ju përgjigjem juve...”** (Gafir, 60), (Transmeton Termidhiu). Thënia e Pejgamberit (a.s.), *“duaja është adhurim”* do të thotë se ajo është më madhështorja e ibadetit, sikurse është fjala e Pejgamberit (a.s.), *“haxhi është qëndrimi në arafat”*.

KRITERET E PRANIMIT TË DUASË

Kriteret e lutjes dhe pranimit të saj nga ana e Allahut të Lartësuar janë përcaktuar në hadithin, të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejra se i Dërguari i Allahut ka thënë:

“(Allahu) Vazhdon t'i përgjigjet lutjes së robit, derisa nuk lutet për keq, për të ndërprerë marrëdhëniet farefisnore ose nuk ngutet. Dhe u pyet Pejgamberi (a.s.): ‘O i Dërguari i Allahut, çka është ngutja?’ Pejgamberi (a.s.), tha: ‘Ajo është kur lutësi thotë: ‘Unë e kam lutur e lutur (Allahun), por nuk po shoh që më pranohet’. Ndaj lodhet nga kjo gjendje dhe e lë lutjen.” (Transmeton Muslimi).

Përveç kriterëve të përgjithshme të ibadetit në përgjithësi, sikurse janë: besimi i shëndoshë, pjekuria në moshë, qëllimi (nijeti), etj., hadithi në fjalë, përcakton edhe tre kritere adekuate të duasë:

- 1) lutja të mos bëhet për një gjë që është mëkat;
- 2) të mos kërkohet ngutja e saj, sepse kjo nënkupton obligueshmërinë ndaj Allahut, e Allahu nuk obligohet me asgjë dhe nga askush;
- 3) lutja të bëhet duke qenë plotësisht i bindur se Allahu do t'i përgjigjet asaj. Këtë e vërteton hadithi, të cilin e transmeton Ebu Hurejra (r.a.). Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Luteni Allahun, duke qenë plotësisht të bindur se do të merrni përgjigje. Djeni se Allahu nuk i përgjigjet duasë që del nga një zemër e luhatshme dhe e pavëmendshme.” (Transmeton Termidhiu).

NGRITJA E DUARVE GJATË DUASË

Ligjshmëria e ngritjes së duarve gjatë duasë, është

çështje e vërtetuar nga shumë hadithe të Pejgamberit (a.s.). Vërtet ka shumë raste kur Pejgamberi (a.s.), bënte dua, qoftë për veten e tij, qoftë për ndonjë person veçmas apo për mirësi të përgjithshme dhe i çonte duart e tij përpjetë, gjersa shpeshherë i shihej bardhësia e nënsqetullave të tij. Transmetohet nga Enes bin Maliku, i cili ka thënë: “Gjersa Pejgamberi (a.s.), ishte duke ligjësuar në hytbe, ditën e xhuma, një njeri hyri në xhami dhe duke qëndruar në këmbë, u drejtua kah Resulullahu (s.a.v.s.) dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, nga thatësia e madhe u shkatërruan pasuritë (devetë, lopët, dhentë etj.), janë ndërprerë rrugët, prandaj lute Allahun të na lëshojë shi. Me atë rast, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), i çoi duart e tij përpjetë dhe tha: ‘O Allah, na lësho shi, O Allah, na lësho shi, O Allah na lësho shi...!’” (Transmeton Buhariu).

Ngritja e duarve përpjetë gjatë duasë, është një praktikë e hershme, të cilën e kanë praktikuar edhe ymetet e tjera para Muhamedit (a.s.). Në një hadith të gjatë, të cilin e transmeton Imam Buhariu nga Seid bin Xhubejr, përmendet se, kur Ibrahim (a.s.), e la një pjesë të familjes së tij në Mekë dhe pasi u largua prej tyre aq sa nuk shiheshin:

“U kthye me fytyrë nga Qabeja, dhe, duke i ngritur duart e tij përpjetë, bëri dua me këto fjalë: ‘Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, e pranë shtëpisë tënde të shenjtë. Zoti ynë (i vendosa aty) që të falin namazin, pra bëj që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ta dhe, për të falënderuar me mirënjohje, furnizoji ata me fruta.’” (Ibrahim, 37). (Transmeton Buhariu)

FSHIRJA E FYTYRËS ME DUAR PAS DUASË

Po ashtu, fshirja e fytyrës me duar pas duasë, konsiderohet prej tipareve të duasë. Një veprim të këtillë e ka bërë edhe Pejgamberi (a.s.). Transmetohet nga Omer bin El-Hattab (r.a.), i cili ka thënë:

“Pejgamberi (a.s.), sa herë që i çonte duart e tij gjatë duasë,



nuk i lëshonte ato, gjersa më parë nuk e fshinte me to fytyrën.” (Trensmeton Termidhiu).

Le të themi se fshirja e fytyrës me duar pas duasë, nuk konsiderohet pjesë përbërëse e duasë, sepse ajo (duaja) lejohet edhe në heshtje edhe duke mos i ngritur duart përpjetë. Mirëpo, fshirja e fytyrës me duar tregon edhe mbarimin e duasë, por edhe akordimin etik të lëvizjeve të duarve menjëherë pas duasë. Ndërsa në aspektin besimor, fshirja e fytyrës konsiderohet një akt që simbolizon transmetimin e efekteve të duasë te i gjithë trupi i njeriut, nëpërmjet fshirjes së fytyrës si pike reference e individit. Ky konstatim haset në shumë hadithe të Pejgamberit (a.s.), në të cilat përmendet se Ai (a.s.), me rastin e rukjeve (këndimit të Kuranit) ndaj të sëmurit, e vendoste dorën e tij në ballin e të sëmurit apo mbi vendin e dhimbjes dhe këndonte lutje (dua) nga Kurani dhe Suneti.

EFEKTET E DUASË

Pa dyshim, lutja sjell dobi të shumta për besimtarin. Ajo është armë e fuqishme e njeriut. Më lart cituam hadithin “*duaja është ibadet*”, ndërsa ibadeti mbart mirësi në këtë botë dhe shpërblim tek Allahu në botën tjetër. Përveç kësaj, nëpërmjet duasë, njeriu kërkon dobi te Ai që ka mundësi realizimi, por edhe njëkohësisht mbrojtje nga të këqijat. Transmeton Ubadete bin Samit (r.a.), se Resulullahi (s.a.v.s.) ka thënë:

“Në tokë nuk ka asnjë mysliman që i lutet Allahut për diçka, e që Allahu nuk do t’ia japë ose në shenjë të kësaj nuk do t’ia heqë ndonjë të keqe, përveç nëse lutësi lutet për mëkat ose për ndërprerjen e farefnisës.” Një njeri nga të pranishmit tha: “Atëherë, le ta shpeshtojmë lutjen?” Pejgamberi (a.s.), tha: “Atëherë, Allahu jep edhe më shumë.” (Transmeton Tirmidhiu).

FRYMA BESIMORE E DUASË

Esenca e duasë qendron në parimin besimor të çështjes. Ai që i drejtohet Allahut me dua, e bën këtë sepse e beson Atë për Krijues të çdo gjëje që ekziston. Për dallim

nga jobesimtari, i cili nuk i lutet Allahut, sepse nuk e percepton Atë për Krijues.

Për ta kuptuar esencën e lutjes dhe nevojën për realizimin e saj, është fare e thjeshtë. Le të themi se lutja bëhet për të arritur një aspiratë. P.sh. në rrafshin e realitetit njerëzor, kur njeriu e aspiron realizimin e një pune, u drejtohet (i lutet) faktorëve relevantë, sepse shpreson që ata faktorë mund t’ia mundësojnë arritjen. Edhe kjo në një farë mënyre paraqet *besueshmëri*, porse me karakter relativ. Ndërsa, kur është fjala për drejtimin e lutjes kah Allahu, koncepti ndryshon tërësisht, sepse kjo manifeston besueshmërinë e njeriut në Allahun, si Krijues absolut i çdo gjëje edhe i atyre objektivave dhe aspiratave, për të cilat bëhet lutja. Si mund ta kuptojmë këtë?

Besimtari e di se Allahu e ka krijuar (e krijon) njeriun dhe realitetin faktik në kuadër të të cilit jeton, zhvillohet, vepron dhe i sendërton aspiratat e veta. Kjo do të thotë se Allahu e krijon mundësinë për realizimin e veprës, të cilën bën njeriu. Nëse njeriu e lëviz dorën e tij, kjo ndodh me krijimin e Allahut. Nëse ai e realizon një vepër nëpërmjet kësaj lëvizjeje, edhe kjo është me krijimin e Allahut. Pra, nuk ka diçka në këtë gjithësi, prej subjekteve dhe lëvizjeve të tyre e që ato nuk janë me krijimin e Allahut. Edhe atëherë kur njeriu beson në tjetrin (si shkaktar) se mund t’ia mundësojë realizimin e një veprë edhe atëherë e beson atë si një aktor që sillet brenda krijimit të Tij. Nga këtu, të gjitha synimet e njeriut, për të cilat shpreson t’i arrijë e për të cilat bën lutje te Allahu, realisht konceptohen si ekzistente brenda kësaj gjithësie. Po kështu, brenda realitetit të krijimit, Allahu e ka krijuar të mirën si objektiv i synimit të njeriut dhe njeriu i lutet Allahut t’ia mundësojë atë. Përsëri, Allahu e ka krijuar të keqen si apati të njeriut dhe njeriu i lutet Allahut t’ia largojë atë. Në të gjitha rastet, vendkthimi i njeriut është kah Allahu. Ndërsa ky kthim paraqet frymën e vërtetë besimore të lutjes, sepse njeriu duke themeluar besueshmëri në Allahun për arritjen e synimeve, shpall haptas plotfuqishmërinë e Krijuesit, në njërin anë dhe varësinë e tij në anën tjetër.

Nëpërmjet kësaj lutjeje, njeriu assesi nuk zhbëhet nga pozita e tij reale si qenie e krijuar dhe si individ i formësuar. Përkundrazi, ai tregon vetëdijësim për njohjen e vetvetes si qenie në nevojë dhe me qëllim të caktuar. Njohja e vetvetes në kontekstin e krijimit dhe qëllimit të tij, ndihmon në qartësimin e shumë dilemave, të cilat ndikojnë në avancimin e njeriut.

REFERENCAT:

1. Ibrahim Mustafa, Hamid Abdul Kadir, Ahmed Hasan Ez-Zijat, Muhamed Alij Nexhar, *El-Mu’xhemu’l-Vesit* - 1/2, boton Darud-da’veti, Stamboll, Turqi, 1989/1410, fq. 286-287.

2. Ebu Abdilahi Amir Abdilahi Falih, *Mu’xhemu el-fadhi’l akideti* botimi i II-të 1420 h /2000, Rijad, fq. 184



Lexim i një monografie

Gjovallin Çuni | Gëzim Puka

Para pak kohësh, profesor dr. Vehbi Hoti i solli lexuesit një tjetër libër me vlerë në fushën e didaktikës, monografinë: "Ethem Osmani. Mësues i popullit (1890-1969)".

Qëllimi i këtij libri është njohja me jetën, punën dhe vlerën e krijuar ndër vite në fushën e shkencës dhe të arsimit nga një brez i tërë mësimdhënësish me vlerë të familjes Osmani, mes të cilëve autori veçon "udhëheqësin shpirtëror", Ethem Osmanin.

Libri është një studim biografik, një risjellje dhe rivlerësim i një emri që i takon një komuniteti, i një mësuesi që i takon shkencës së didaktikës, i një identiteti intelektual, që jetën e tij ia përkushtoi shërbimit ndaj njerëzve, dijes dhe përparimit.

Të shkruash libra biografikë nuk është e lehtë, përkundrazi mjaft e vështirë. Përgjithësisht të tillë libra cilësohen si libra të "ndjesive të përjetësisë", ku vendin e trillit dhe të fantazisë letrare e zë narrativa e mbushur me informacion. Autori –rrëfimtari, përmes një pune të gjatë hulumtuese dëshmon ngjarje që e shoqërojnë jetën e një njeriu dhe e pasurojnë figurën e tij.

Libri ka në brendësinë e tij elemente kujtimi dhe vlerësimi ndaj figurës së Ethem Osmanit. Është një refleksion për një njeri, prind, mësues, qytetar dhe bashkëpunëtor i personaliteteve të kohës, që u përpoqën të hidhnin bazat e arsimit shqiptar.

Kjo monografi është simbolika e një kohe të shkuar, pa të cilën e sotmja nuk ka kuptim. Pjesë e kësaj simbolike është edhe trashëgimia e vyer, kujtesa e njerëzve të shquar, pikat e referencës, mes të cilave ishte edhe jeta e veprimtaria e Ethem Osmanit (1890-1969) dhe e familjes së tij.

Autori Vehbi Hoti, ruan karakteristikat e llojit të tematikës që trajton. Në të ngërthen njerëz, ngjarje, vende të dhëna rreth një figure të njohur në periudhën kur jetoi, por jo aq sa duhet në ditët e sotme.

Ethem Osmani në libër paraqitet si një figurë e shumanshme, gjë që krijon tek lexuesi një gjykim të saktë për rolin që ai luajti në ambientin qytetar të Shkodrës.

Pasardhës i shquar i familjes Osmanagiq, të shpërngulur e të vendosur në Shkodër në vitet '50-60 të shekullit XIX, për t'i shpëtuar shkombëtarizimit dhe sllavizimit, u lind në 5 maj të vitit 1890 në familjen e Mustafa Osmanit. Prindërit ia ngjiten emrin Ethem, duke përjetësuar kësajsoj emrin e të parit, Ethemit Plakut. Familja u kujdes që Ethem i të rritej me cilësitë më të mira të fisit, por edhe të integrohej në mjedisin përgjithësisht të kulturuar shkodran.

Në jetëshkrimin e një personi që i takon sferës intelektuale, shkollimi është elementi i parë. Ethem i kreu të gjitha

shkallët e shkollimit të kohës, duke u shquar për vullnet, mprehtësi dhe arritje rezultatesh të larta.

Duke iu referuar autobiografisë ai mbaroi qytetësen ushtarake "Ryzhdi askeri", "...si dhe shtatë klasë të gjimnazit civil turk "Idadi meleki". Në këto shkolla ai mori formimin teologjik dhe shkencor të kohës, duke arritur "të dahej në shenj" mes nxënësve të tjerë.

Formimi i mëtejshëm u plotësua jashtë shtetit. Në Damask, Ethem i regjistrua në shkollën "Sulltanije", (...gjimnazi i plotë turk 6- vjeçar), ku mori maturën në vitin shkollor 1910-1911, e më pas filloi studimet në universitetin El Ez'herit të Kajros, i cilësuar si "...universiteti i dytë më i vjetër në botë që ka shpërndarë diploma universitare".

Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore e gjen në Shqipëri. Në pamundësi për të vijuar studimet e nisura, ai ndoqi shkollimin e tij në Shkodër. Zgjodhi një nga shkollat më me emër të kohës, Kolegjen Saveriane, në të cilën për dy vite shkollore 1913-1915 plotësoi "...klasët e gjimnazit qi ka ba njeti".

Emri i Ethem Osmanit qëndron "në vargun e ish-kolegjarëve qi u danë në shej në jetë publike", krahas figurave të shquara si: Faik Konica, Hilë Mosi, Luigj Gurakuqi, Gaspër Mikeli, Qemal Stafa, Selaudin Bekteshi e sa e sa të tjerë.

Por Ethem nuk qe vetëm nxënës i Kolegjit Saverian, ai u bë edhe mësues në këtë kolegji. Jezuitët, duke parë formin kulturor dhe zotërimin nga ana e tij e disa gjuhëve si arabisht, turqisht, serbo-kroatisht, persisht dhe italisht, e ftuan të jepte për disa vite edhe lëndën e gjuhës arabe për nxënësit e besimit islam, që studionin në këtë shkollë.

UDHËVE TË JETËS -MËSUES DHE KRYEMËSUES

Me nxitjen e Luigj Gurakuqit, Ethem i zgjodhi si profesion të jetës mësuesinë. Me vendim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit që ndodhej në Shkodër, në vitet 1915-1916 u emërua mësues në Elbasan e më pas, me kërkesë të tij, u vendos në nënprefekturën e Gramshit, ku ndonëse punoi për pak kohë, la gjurmë në masivizimin e arsimit shqip duke hapur edhe shkolla në fshatra të ndryshme të nënprefekturës.

Në vitin 1917 emërohet mësues në Shkodër. Ai punoi si i tillë në Shkollën Popullore në Ajasëm, në shkollën e Parrucës, kryemësues në shkollën e Dudasit, në fshatin Repisht e më pas në shkollën e Rusit. Kudo ku punoi, u vlerësua si "shërbëtor i censhëm e i zoti për të kryer detyrën".

Në shkollat e Dudasit, "Rus Haslikaj" dhe "Hadrej" ai

punoj si mësues dhe kryemësues gjatë viteve '20 të shekullit të kaluar.

Ethemi ndihmoi në zhvillimin e arsimit mbi bazat moderne. Krahas sistemimit të godinave dhe pajisjeve për zhvillimin normal të mësimit, ai u kujdes edhe për vlerësimin e punës së nxënësve dhe mësuesve, si dhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme shkollore.

Një rëndësi të veçantë Ethemi i dha dokumentacionit bazë të shkollave, si ditarët, regjistrat e përjavshëm, në të cilat shënoheshin: "...të shtjelluemit e landëvet të mësimit"; "Dëshmitë lavdëruese" për nxënësit, si dhe krijoi arkivat e shkollave të përbëra nga dosje me dokumentet kryesore të vitit shkollor. Mes këtij dokumentacioni mund të veçojmë fotografitë e klasave, si një mjet i rëndësishëm identifikimi i pjesëmarrjes së nxënësve.

Kredoja e tij pedagogjike-mësimdhënëse ishte e përmbledhur në 7 pika, që i cilëson si "bazë pune" në veprimtarinë e çdo drejtuesi.

Ai synonte formimin shkencor, por edhe kulturor të nxënësve. Në shkollat që drejtoi, u përpoq të mos mungonin klasat e pajisura me mjete mësimore, kabinetet lëndore, baza eksperimentale (kopshti shkollor), por edhe biblioteka, muzeu, salla e argëtimit dhe këndi sportiv.

Ai ndiqte me vëmendje literaturën pedagogjike, por edhe çdo ngjarje tjetër lokale dhe kombëtare që kishte të bënte me arsimin. Ishte ndër të parët që aplikoi të rejtat në fushën e arsimit, bazuar në literaturën bashkëkohore. Të tillë ishin librat e Gaspër Beltojës në fushën pedagogjike, por edhe tekstet e reja lëndore, si: "Abetar për shkollën fillore të Shqipnis", "Knime t'para për Msoitore Filltare" (1916), "Diftime t'natyrshme për msoitore t'Shqypnis" të D. Ndoc Nikajt apo edhe "Libër për shkolla fillore të Shqipnis", të G. Beltojës (1918).

Duke qenë kërkues ndaj vetes, Ethemi synonte gjithnjë rritjen e tij profesionale si mësues dhe drejtues. Eksperienca në punë dhe përgatitja autodidakte u shoqërua me ndjekjen dhe aplikimin e të rejave në fushën e arsimit. Ndoqi me shumë vëmendje punimet e "Kongresit Arsimor Kombëtar" (12.08.1924) dhe ishte ndër të parët kryemësues, që aplikoi në shkollën që drejtonte udhëzimet e këtij kongresi. Atë çfarë kërkonte nga vetja, Ethemi e kërkonte edhe tek të tjerët. Mësuesit që drejtonte duhej të lexonin "veprat pedagogjike dhe artikujt e kësaj natyre në revistat dhe gazetat e kohës".

Përkushtimi në punë dhe përgatitja profesionale bënë që Ethemi të ngjiste shkallët e karrierës. Atij iu besua, në vitin 1933, nga ministri i arsimit Mirash Ivanaj, drejtimi i shkollës së Perashit, njërës nga më të mëdhatë e qytetit të Shkodrës.

Në vitin 1939, së bashku me 16 arsimtarë të tjerë u pushua nga puna nga italianët, si nacionalist dhe kundërshtar i regjimit fashist. Më vonë, gjatë viti 1940 e shohim si drejtor të shkollës femnore "Hodo Pasha", "Oso Kuka". Pas çlirimit do të punonte në shkollat "Filip Shiroka" dhe "Vaso Kadija".

Doli në pension në vitin 1946, por anjëherë nuk hoqi dorë nga puna e bukur e mësuesit. Dha një ndihmesë të shquar në kurset kundër analfabetizmit, në kualifikimet

e mësuesve, në botime didaktike, në mbledhjen e krijimtarisë popullore. Me pasionin që e karakterizonte, filloi përkthimin e enciklopedisë së Sami Frashërit "Kamusul-alam".

Biblioteka e shtëpisë së tij ishte këndi më i dashur i punës. Kjo bibliotekë, fillimisht e karakterit pedagogjik, erdhi duke u pasuruar nga viti në vit edhe nga pasardhësit e tij. Në ditët tona biblioteka private Osmani është një ndër më të vyerat në qytetin tonë.

VLERA TË TRASHËGUARA

Në jetën e një burri, padyshim një rol të veçantë luan edhe bashkëshortja. Nexhmija -bashkëshortja e Ethemit ishte një grua e veçantë, që u gjend gjithnjë pranë të shoqit dhe ndikoi fuqishëm në edukimin e fëmijëve.

Populli ka një shprehje të urtë: "Bëmë baba të të ngjaj". Natyrshëm eksperienca popullore u mishërua së tepërmi tek familja Osmani. Fëmijët, por më vonë edhe nipat e mbesat, u përpoqën të ecnin në gjurmët e Ethemit.

E kush nuk i njeh kontributet e sjella në shkencat pedagogjike dhe filologjike të vellezërve Shefik dhe Tomor Osmani?

Shefik, që u nda nga ne pak kohë më parë, ishte ndër personalitet më të dëgjua të pedagogjisë shqiptare. Vetëm statistikat mjaftojnë për të ndërtuar profilin e tij shkencor. Ai shkroi 231 artikuj me karakter studimor në organe të ndryshme shkencore, mbajti 92 ligjërata në sesione shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe ishte autor i 13 monografive, bashkautor i disa teksteve të leximit për tërë hapësirat shqiptare dhe ata të diasporës.

Krahas tij qëndron edhe Tomori, pedagogu i gjuhës shqip në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Aktiviteti shkencor e ka rreshtuar atë përkrah figurave më të shquara të gjuhësisë shqipe. Studimet e prof.dr. Tomor Osmanit në fushën e gjuhës, mbeten pika referimi për probleme të ndryshme të gjuhësisë shqipe. Ai është një nga personalitetet më të rëndësishëm të mbarë hapësirës shqiptare, përsa u takon trajtesave që lidhen me historinë e alfabetit të shqipes. Botimet monografike kushtuar alfabetit të shqipes nga ky studiues, kanë filluar që në vitin 1987 dhe vijojnë akoma. Vepra e prof. dr. Tomor Osmanit konsiderohet shumë e vyer për trajtesën shkencore.

Në listën bibliografike të prof. dr. Tomor Osmanit janë 10 monografi, 2 bashkautorësi, 350 artikuj studimorë në revista filologjike brenda dhe jashtë vendit. Ai është pjesëmarrës në 150 tubime shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Është një pedagog dhe studiues mjaft aktiv edhe në ditët e sotme. Tomor Osmani ka merita edhe për krijimin e Instituti të Albanologjisë pranë Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Mbase duke shfletuar këtë monografi mund t'ju ndërmendet se për të bërë breza nxënësish dhe studentësh të zellshëm dhe entuziastë, është e nevojshme diçka më shumë se sa një metodë moderne dhe e zgjuar. Nxënës dhe studentë të vërtetë mund të edukojnë vetëm ata mësimdhënës, që e dinë se çfarë do të thotë të duash profesionin tënd. Kësaj kategorie i përket kjo "dinasti" mësuesish.

Qfarë e pengon pranimin e lutjes

Ibrahim Koç

Ka shumë gjëra që bëhen pengesë për pranimin e lutjes. Ato mund t'i përmbledhim në këtë mënyrë:

Shirku ndaj Allahut

Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit.”** (Ez-Zumer, 65)

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Tij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shirk Allahut (në adhurim), ai me të vërtetë, ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë.” (En-Nisa, 116.)

Të qenët i pasinqertë

Sinqeriteti është kusht për pranimin e lutjeve dhe adhurimeve. Vepra pa sinqeritet, është vepër e pashpirt.

Të mos lutesh për prindërit

Nuk i pranohen lutjet atij që nuk lutet për prindërit e tij.

Të bësh padrejtësi

Për shembull, të kalosh njerëzit që janë në radhë para teje, është një padrejtësi. Kjo bëhet shkak që të mos

pranohet lutja.

Mëkatet janë ato që e pengojnë pranimin e lutjeve dhe që sjellin fatkeqësi.

Transmetohet nga Hz. Enesi, radjallahu anhu. I thashë të Dërguarit të Allahut:

“O i Dërguari i Allahut! Dua që të më pranohen lutjet!”

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, më tha:

“O Enes, fito hallall, vishu me hallall dhe ha nga hallalli, sepse atij që e ka rrobën prej haramit dhe atij që ka ushqim haram në stomak, nuk i pranohet adhurimi dyzet ditë!”

Përsëri Enesi, radjallahu anhu, transmeton: I thashë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Lutju Zotit që të më pranojë lutjet!”

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, më tha:

“O Enes! Fitoje ushqimin nga hallalli! Nëse mjaftohesh me ushqim hallall, do të të pranohen lutjet.” (Taberani)



-Atij që ha haram, nuk i pranohen lutjet dhe adhurimet. (Ibrahim Xhanan, Enciklopedia e Hadithit, 14/306.)

-Trupi që ushqehet me ushqim haram, bëhet lëndë djegëse e xhehenemit.

-Allahu nuk e pranon adhurimin e atij që ka ushqim haram në stomakun e tij." (Imam Gazaliu, Ihja, 2/239)

-Hallalli ka shpërblim, ndërsa harami ka ndëshkim.

Ushqimi haram e prish brezin dhe e shkatërron shoqërinë. Anarkia, vjedhja, rrëmbimi, dhunimi dhe agresiviteti që shkatërrojnë shoqërinë, ndodhin për shkak të ushqimit haram dhe mëkateve. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, thotë:

"...Njeriu ngre duart drejt qiellit dhe lutet: 'O Zot, o Zot! Por gjërat që ka ngrënë, pirë dhe veshur janë haram. Si t'i pranohet lutja një njeriu të tillë?'" (Muslim, Zekat, 19; Tirmidhi, 661; Bejhaki, Sunen, 6187.)

Këtu vihet në pah fakti se ushqimi, pirja dhe veshmbathja haram, janë disa prej pengesave më të mëdha për mospranimin e lutjeve.

-Gënjeshttrat dhe mëkatet, e pakësojnë riskun e njeriut.

"Më të vërtetë, Allahu Teala nuk e pranon lutjen që del nga një zemër e pavetëdijshe dhe neglizhente." (Tirmidhi, Deavat, 11, 66-374; Hakim, Mustedrek, 1/493.)

Musai, alejhis-selam, i tha Zotit:

"O Zot! Filan rob Yti ka shumë kohë që të lutet, por nuk i pranohet lutja. Cila është urtësia e kësaj?" Allahu Teala i tha:

"O Musa! Unë nuk e pranoj lutjen e atij robi, sepse rrobën që ka veshur, e ka marrë me para haram."

Edhe për një tjetër, Allahu (xh.xh.), i tha:

"O Musa! Unë kam më shumë mëshirë se ti për robërit e mi, por ky rob lutet me gjuhën e tij, ndërsa me zemër, mendon për qethjen e deleve dhe për shitjen e leshit të tyre. Unë nuk e pranoj lutjen e dikujt që e ka zemrën te delet."

"O Musa! Edhe nëse robi i ngre duart lart aq sa mund t'i thyhen brinjët, Unë nuk ia pranoj lutjet, përderisa të mos zbatojë obligimet e tij." (el-Mu'xhemu'l-Kebir 12/212 - Xhamiu'l-Ulum, fq. 108.)

Nëse njeriu e neglizhon predikimin e fesë dhe nuk e bën atë synim të jetës së tij, kjo ia pakëson riskun atij.

"Mos u anko për vonimin e pranimit të lutjeve, kur i ke mbyllur me mëkate rrugët e pranimit." (Hilje, 10/53.)

"Gjumi në mëngjes, është një pusi për riskun. Risku shpërndahet në kohën e agimit."

Nëna e Hazreti Sulejmanit i thoshte shpesh atij:

"O bir! Mos fli shumë natën, sepse gjumi i tepërt gjatë natës, e lë njeriun të varfër Ditën e Kiametit."

-Të mos jesh mesatar në lutje dhe kalimi i kufijve në të.

-Të mos nxitosh në çështjen e pranimit të lutjes.

-Mosbindja ndaj Allahut Teala. Moszbatimi i farzeve.

-Së fundi, dobësimi në fe, lënia e namazit, zhytja në epshe, bindja ndaj shejtanit, kamata, prostitucioni, përhapja e zinasë në shoqëri dhe insistimi në mëkate, janë gjëra që e pengojnë pranimin e lutjes.

Sepse mëkatet dhe mosbindja, janë pengesë për pranimin e lutjes.

Njëra prej gjërave që e pengon pranimin e lutjes është "shkëputja e marrëdhënieve me të afërmit".

Mëshira e Tij kaplon gjithçka

Prof. dr. M. Jashar Kandemir



Një besimtar duhet të jetojë gjithmonë me shpresë duke thënë: "Zoti im është burim mëshire. Ai i fal edhe të metat e mia". Kjo, sepse Allahu Teala në qindra ajete na e prezanton Vetën e Tij si "**Gafurun Rrahim**", pra Shumëfalësi e Mëshiruesi.

"Kërkoni falje nga Zoti juaj dhe kthehuni tek Ai të penduar...", urdhëron Allahu Teala në ajetin e tretë të sures el-Hud.

Ai i fal të gjitha gjynahet

Në këtë ajet fisnik, mëshira e Allahut të Madhëruar valëzon si dallgët e detit dhe e mbush njeriun plot me shpresë:

Thuaj: "O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti." (Ez-Zumer, 53.)

Domethënë që, **"...Shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb askush tjetër, përveç jobesimtarëve."** (Jusuf, 87.) Atëherë, sado gabime e të meta të ketë, sado të jetë i zhytur në batakun e gjynaheve, njeriu nuk duhet ta humbasë kurrë shpresën prej mëshirës dhe faljes së Allahut Teala.

Nuk duhet të harrojmë se në një hadith kudsî, Allahu Teala ka thënë: **"Robërit e Mi! Ju bëni gjynahe ditë e natë. Por Unë jam Ai, që ua fal të gjitha gjynahet. Kërkoni falje prej Meje që t'ju fal."** (Rijadu's-Salihin)

Gjithashtu duhet të dimë se gjatë natës Allahu Teala e mban hapur derën e mëshirës për ata që kanë bërë gjynahe ditën dhe gjatë ditës e mban hapur për ata që kanë bërë gjynahe natën. Dhe kjo do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit.

MËSHIRA E TIJ ËSHTË E PAFUNDME

Nuk ka asnjë arsye për të prerë shpresat prej mëshirës së Allahut, sepse:

- Mëshira e Tij ka kapluar çdo gjë.
- Mëshira e Tij ia kalon Zemërimit të Tij.
- Ai dënon vetëm mosmirënjohësit.
- Dënimi i Tij është vetëm për ata që përgënjeshtrojnë profetët dhe i kthejnë shpinën Atij dhe së vërtetës.

Atëherë, ata që i besojnë Allahut, nuk duhet ta presin shpresën nga falja e Tij. Ashtu siç shprehet edhe Profeti (a.s.): **"Allahu e ka ndarë mëshirën e Tij në njëqind pjesë. Nëntëdhjetë e nëntë pjesë i ka mbajtur për Vete dhe një pjesë e ka zbritur në tokë. Për shkak të kësaj mëshire, kafshët ecin me kujdes që të mos vrasin të vegjlit e tyre"**. (Buhariu, Muslimi).

Që prej ditës kur u realizua krijesa e parë, e deri në ditën kur do t'i vijë fundi dynjasë, të gjitha krijesat do ta duan dhe mëshirojnë njëra-tjetrën, në sajë të kësaj pjese të mëshirës që Allahu Teala ka zbritur në tokë.

Në sajë të kësaj mëshire, nënat tregojnë dhembshuri ndaj të vegjëlve të tyre. Po ashtu, falë kësaj mëshire, edhe kafshët, edhe zogjtë tregojnë mëshirë për njëri-tjetrin. Atëherë, po nëntëdhjetë e nëntë pjesët e tjera të mëshirës, ku janë?

Ato pjesë, Allahu Teala i ka mbajtur pranë Vetes, me qëllim që t'i mëshirojë robërit e Tij në Ditën e Kiametit. Mëshira e Tij do t'i përfshijë të mirët, ndërsa Zemërimi i Tij do të dënojë mizorët.

DUHET JETUAR MIDIS FRIKËS DHE SHPRESËS

Mëshira e Allahut është më e madhe se zemërimi i Tij. Megjithatë, siç shprehet edhe Profeti ynë (a.s.): **"Nëse besimtari do ta dinte dënimin e Allahut, nuk do të shpresonte xhenetin. Por edhe jobesimtari, nëse do ta dinte se sa e gjerë është mëshira e Allahut, nuk do ta humbiste shpresën për të hyrë në xhenet."** (Muslim, Teube: 23; Tirmidhi, Deauat: 99; Musned, 2:334,397,484.)

Ja pra, të sigurosh ekuilibrin midis frikës dhe shpresës, shprehur ndryshe, të jetosh midis frikës dhe shpresës, është diçka shumë e rëndësishme. Ne duhet t'i lutemi Allahut edhe duke shpresuar tek Ai, edhe duke pasur frikë prej Tij, ashtu siç bëjnë edhe robërit e devotshëm. Duhet ta dimë se mëshira e Allahut është afër atyre që bëjnë vepra të mira dhe të bukura.

Ashtu siç mundohet një akrobat të mbajë ekuilibrin mbi një litar me një shkop të gjatë në duar, ashtu duhet të mundohet edhe njeriu që me ndjenjat e frikës dhe të shpresës të ruajë ekuilibrin midis kësaj bote dhe botës tjetër, xhenetit dhe xhehenemit.

Askush, qoftë edhe profetët, nuk do të hyjë në xhenet pa ndihmën dhe mëshirën e Allahut, vetëm me punët e tyre të mira. Gjithmonë duhet të kemi parasysh këtë hadith fisnik, i cili na tregon se nuk duhet të jemi shumë të sigurt për veten tonë.

Profeti (a.s.), ka thënë: *“Dikush, për një kohë të gjatë bën punë të xhenetlinjve, e më vonë, puna e tij përfundon me një vepër të xhehenemlinjve. Ndërsa një tjetër, për një kohë të gjatë bën punë të xhehenemlinjve, më vonë, puna e tij përfundon me një vepër të xhenetlinjve.”* (Muslim, Kader, 11.)

Ky fakt nuk duhet harruar asnjëherë dhe, sipas kësaj, duhet të mundohemi të bëjmë një jetë të ekuilibruar midis frikës dhe shpresës.

AI VJEN ME VRAP TEK AI QË I AFROHET DUKE E CUR

Ka shumë argumente që tregojnë gjerësinë e Mëshirës së Allahut dhe kjo na bën të kuptojmë se ka shumë arsye për të pasur shpresa tek Allahu:

Transmetohet nga Ebu Dherri (r.a.), se Profeti (a.s.), ka thënë: *“Allahu i Madhëruar thotë: ‘Kush vjen me një vepër të mirë, do të ketë shpërblim për të dhjetëfish e më tepër, ndërsa kush vjen me një vepër të keqe, do të ketë dënim vetëm sa ajo vepër, ose do ta fal. Kush më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem një kut; kush më afrohet një kut, Unë i afrohem atij një pash. Kurse, kush më vjen duke ecur, Unë i shkoj atij duke vrapuar. Kush vjen tek Unë me mëkatë sa madhësia e Tokës, por pa më shoqëruar asgjë (në adhurim), Unë do ta pres atë me po aq falje (magfīret).”* (Muslimi, Dhikr 22. (2687)

Gjithashtu, Profeti (a.s.), ka thënë: *“Nuk ka asnjë rob, i cili dëshmon se s’ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguar i Tij, e që Allahu t’ia lejojë zjarrin ta djegë atë.”*

Allahu Teala kënaqet, nëse robi i Tij i lutet me pendim që t’ia falë gjynahet, pasi ai i ka bërë ato:

“Robi im bëri një gjynah, por e diti se ka një Zot, i cili do t’ia falë gjynahun ose do t’i kërkojë llogari. Unë e fala robin Tim. Tani le të bëjë ç’të dojë.” (Buhari, Teuhid 35; Muslim, Teube 29.)

Po, Ai kënaqet shumë prej robit që e njeh Krijuesin e tij, që i drejtohet Atij, që pendohet për gjynahet dhe siç shprehet Profeti (a.s.) një kënaqësi e ngjashme me atë: *“Që e humb devenë e tij në shkretëtirë dhe e gjen përsëri.”*

Nëse nuk do të bënim asnjë gjynah, Allahu do të na zhdukte dhe në vendin tonë do të krijonte një bashkësi tjetër, e cila do të bënte gjynahe, por do të pendohej e do të kërkonte falje për to. Kjo tregon shumë qartë rëndësinë që ka kthimi i robit nga Allahu dhe kërkimi i faljes.

PËRGËZIME QË SJELLIN FLLADE SHPRESE

Këto përgëzime të Profetit (a.s.), na mjaftojnë për të pasur shpresë në Mëshirën e Allahut:

- Profeti (a.s.), i drejtohet Muadh bin Xhebelit (r.a.), duke i thënë:

“O Muadh! A e di se cilat janë të drejtat e Allahut mbi robërit e Tij dhe të drejtat e robërve mbi Allahun?”

“Allahu dhe i Dërguari i Tijë dinë më mirë”, - tha Muadhi (r.a.).

Pastaj Profeti (a.s.), vazhdoi duke thënë:

“E drejta e Allahut mbi robërit është që ata ta adhurojnë Atë pa i shoqëruar askënd në adhurim. Ndërsa e drejta e robërve ndaj Allahut, është që Allahu Teala të mos dënojë asnjë prej atyre që nuk i bëjnë ortak në adhurim.”

Muadhi (r.a.), tha: *“O i Dërguar i Allahut a t’i përgëzoj njerëzit me këtë që më the?”*

Profeti (a.s.), u përgjigj duke thënë:

“Mos i përgëzo, sepse ata mbështeten tek kjo dhe bëhen dembelë.” (Buhari, Xhihad 46; Muslim Iman 48, 49.)

- *“...Allahu Teala e shpërblen besimtarin për veprat e mira që bën, edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Kurse jobesimtarin (mohuesin), për të mirat që bën e shpërblen vetëm në këtë botë, në mënyrë që të mos i ngelet asnjë shpërblim për në botën tjetër.”* (Muslim, K. el- Munfekîn. 56, 2808. ; Ahmed b. Hanbel, Musned, V. 3 fq. 123.)

- Profeti (a.s.), ka thënë: *“Çfarë mendoni, nëse dikush nga ju e ka para shtëpisë një lum dhe pastrohesh në të pesë herë në ditë, a mbetet në trupin e tij ndonjë papastërti?”*

Të pranishmit thanë:

“Jo, nuk mbetet.”

Pastaj Profeti (a.s.), tha: *“Ashtu edhe me pesë namazet Allahu i fshin mëkatet (e vogla).”*

- Profeti (a.s.), ka thënë: *“Betohem në Allahun e Madhërishëm që ka në dorë shpirtin e Muhamedit, se ju do të jeni gjysma e atyre që do të hyjnë në xhenet. Kjo, sepse në xhenet nuk mund të hyjë asnjë jobesimtar. Në krahasim me mushrikët (idhujtarët), ju jeni si njolla e zezë në lëkurën e kaut të bardhë apo të kuq.”* (Buhari, Ritak 45, 46, Enbiya 7, Ejman 3.)

- Transmetohet nga Ibën Omeri (r.a.), se Profeti (a.s.), ka thënë: *“Në Ditën e Kiametit, besimtari do të jetë aq afër Allahut, sa që Ai e fsheh nga pjesa tjetër e njerëzve (e merr më vete) dhe i kërkon llogari për gjynahet:*

- A e di këtë gjynah? Po këtë gjynahun tjetër?- i thotë Allahu.

- E di o Zot,- thotë besimtari.

Pastaj Allahu Teala urdhëron:

“Unë t’i kisha mbuluar këto gjynahe në dynja, ndërsa sot po t’i fal ato.”

Pas kësaj, atij i jepet libri i punëve të mira.” (Buhari, Mezalim 3, Tefsiri i sures (11), 4, Edeb 60, Teuhid 36; Muslim Teube 52.)

Ja pra, para të gjitha këtyre fakteve, njeriu duhet ta kuptojë se edhe xheneti, edhe xhehenemi, janë më afër tij se sa lidhësja e këpucës së vet...

PUNA MË E MIRË: TË MËSOSH KURANIN DHE T'UA MËSOSH ATË TË TJERËVE

Ngjarja më e lartë për njeriun është të bëhet mysliman duke iu bindur thirrjes së Allahut dhe të Dërguarit të Tij. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i tha Muadh bin Xhebelit, radijallahu anhu:

“A të të tregoj për çështjen më kryesore?”

“Çështja më kryesore është Islami.”

E pyetën të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem:

“O i Dërguari i Allahut! A duhet së pari të luftoj dhe pastaj të bëhem mysliman?” I Dashuri i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, iu përgjigj:

“Së pari, bëhu mysliman, pastaj lufto!” Në këtë mënyrë, Hz Pejgamberi, alejhis-salatu ves-selam, na ka treguar se Islami vjen në krye të çdo gjëje.

Po, Islami është koka dhe fillimi i çdo gjëje. Nisur nga kjo, ai njeri që nderohet me Islamin, do të thotë se ka nisur rrugën e mirësisë. Pas kësaj nisjeje, besimtari duhet të fillojë garën e mirësisë ashtu siç shprehet edhe në ajetin fisnik. “**Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira. Kudo që të gjendeni, Allahu do t’ju mbledhë të gjithëve; Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.**” (El-Bekare, 148). Kjo garë do ta shpjerë personin e nderuar me Islam në rrugëtimin për t’u bërë “më i miri” mes myslimanëve. “Më i mirë” do të thotë të jesh një hap para të tjerëve në kënaqësinë e Allahut Teala dhe të Dërguarit të Tij.

Në një hadith i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve

1. Ibn Maxhe, Fiten, 12.

sellem, ka thënë:

“Më i miri prej jush është ai që mëson Kuran, dhe ua mëson atë të tjerëve.”²

Ngaqë është fjala e Allahut Teala, Kurani Fisnik është libri më fisnik. Pra edhe njeriu më i mirë është ai që e mëson dhe ua mëson të tjerëve fjalën e Allahut. Dijetarët e Parë nuk e kanë gjykuar si të barabartë me asgjë mësimin e leximit të Kuranit vetes dhe të tjerëve.³

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Mësojeni Kuranin! Sa ndërmjetësues i mirë do të jetë ai në Ditën e Kiametit!”⁴

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, na përgëzon duke thënë:

“Kush mëson një ajet nga libri i Allahut, Ditën e Kiametit ky ajet do t’i dalë përpara duke i buzëqeshur.”⁵

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, na tregon në këtë mënyrë se sa punë me vlerë është mësimi i Kuranit fisnik:

“Lexojeni Kuranin! Duke e lexuar atë, ju do të shpërbleheni me dhjetë sevape për çdo shkronjë të tij.”⁶

Nëse marrim me mend se sa shkronja ka në një faqe, krejt qartësisht del në pah sesa emadhe është puna e bërë.

2. Buhari, VI, 108.

3. En-Neshr, I, 3.

4. Ed-Darimi, Fedailu'l-Kuran, I / er-Riaje, fq. 7.

5. El-Itkan, IV, 105.

6. Darimi, Sunen, II, 429.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i ka thënë kështu Hazreti Aliut, radijallahu anhu:

“O Ali! Mësoje Kuranin dhe mësojua atë njerëzve! Për çdo shkronjë të tij, do të kesh dhjetë sevape. Nëse vdes, vdes si dëshmor.”

“O Ali! Mësoje Kuranin dhe mësojua atë njerëzve! Kur të vdesësh, njerëzit do ta vizitojnë varrin tënd siç vizitojnë shtëpinë e Allahut.”⁷

Ukbe bin Amri, radijallahu anhu, tregon:

“Kur ishim në *suffe*, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, doli jashtë dhe pyeti:

“Kush prej jush dëshiron të shkojë çdo ditë deri në But’han, ose deri në Akik pa bërë ndonjë mëkat, pa i shkëputur lidhjet farefisnore dhe të sjellë nga aty dy deve me gunga të mëdha?” Ne i thamë:

“Duam ne, o i Dashuri i Allahut!” Pastaj, Profeti, sallallahu alejhi ve sellem, tha:

“Atëherë, nëse dikush prej jush shkon në ndonjë xhami dhe mëson apo i lexon dy ajete nga libri i Allahut të Madhëruar, kjo është më e mirë për të se dy deve. Tre ajete janë më mirë për të se tri deve. Katër ajete që mund t’i mësojë, janë më të mira për të se katër deve. Sado që të rritet numri i këtyre ajeteve, është më mirë për të se numri i deve që i takon për çdo ajet.”⁸

PRINDËRIT QË U MËSOJNË KURANIN FËMIJËVE...

Nëse fëmijët tanë rriten dhe edukohen në mënyrë të mirë, ata janë kapitali i kësaj bote dhe i botës tjetër. Ndërsa fëmijët, të cilëve u neglizhohet sqarimi i ahiretit për hir të dynjasë, bëhen pikëllim dhe turp, si për prindërit ashtu edhe për shoqërinë. Për këtë arsye, prindërit duhet të jenë të përpiktë në mësimin e Kuranit fëmijëve të tyre. Madje, nëse është e nevojshme, së pari Kuranin duhet t’ua mësojnë atyre personalisht, sepse i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Atij që ua mëson Kuranin fëmijëve të vet, Ditën e Kiametit do t’i vihet një kurorë në xhenet.”⁹

Ndërsa, në një tjetër hadith fisnik, thuhet:

“Prindërve që ua mësojnë Kuranin fëmijëve të tyre, në xhenet u vihet një kurorë, nga e cila të gjithë do ta kuptojnë se ata ua kanë mësuar Kuranin fëmijëve.”¹⁰

Enes bin Maliku transmeton se i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Atij që ua mëson Kuranin fëmijëve të vet, duke parë shkronjat dhe rreshtat, i falen mëkatet e kaluara dhe

7. Nihajetu'l-Kavli'l-Mufid, fq. 255.

8. Muslim, Sherhu'n-Nevevi, VI, 87.

9. El-Itkan, IV, 104.

10. Zevaid, 7/165-166.

të ardhshme. Kurse ai që ua mëson Kuranin përmendsh atyre, do të ringjallet i shndritshëm si hëna katërbëdhjetëshe. Fëmijës së tij do t’i thuhet: Lexo!

Kur fëmija të lexojë një ajet, prindërit do të lartësohen një gradë. Kjo gjë do të përsëritet deri në ajetin e fundit që fëmija ka mësuar nga Kurani.”¹¹

MEHRI MË I BUKUR...

Një ditë, një robëreshë erdhi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe i tha:

“Unë ta kam falur veten time Ty!”

Pastaj qëndroi ashtu për një kohë të gjatë në këmbë.

Një burrë i varfër prej myslimanëve që gjendej aty, tha:

“O i Dërguari i Allahut! A mund ta martosh atë me mua, nëse nuk martoheni ju me të?”

Pejgamberi, alejhis-salatu ves-selam, e pyeti:

“A ke ndonjë gjë që mund t’ia japësh për mehër?”

Burri i varfër tha:

“Nuk kam asgjë përveç kësaj pelerine!”

Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, i tha:

“Si mund të rrish ti pa pelerinë, nëse ia jep asaj tënden? A ke ndonjë gjë tjetër?”

Burri i varfër tha:

“Nuk kam asgjë tjetër që mund t’ia jap.”

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e pyeti:

“A nuk mund të bësh, qoftë edhe një unazë prej hekuri?”

Burri i tha se nuk mund ta bënte as këtë. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e pyeti:

“A di diçka përmendsh nga Kurani?”

Burri i tha:

“Po, di disa sure.”

Dhe tha emrat e sureve që i dinte përmendsh.

Pastaj, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i tha:

“Unë po e martoj atë me ty, me kusht që t’ia mësosh edhe asaj këto sure!”¹²

Sa mehër i bukur për nusen dhe për dhëndrrin..!

Së fundi, të mësosh Kuranin dhe t’ua mësosh atë të tjerëve, është kapitali më i mirë për dynjanë dhe ahiretin. Kurani nuk e lë besimtarin vetëm, as në dynja e as në ahiret. Allahu i Lartmadhëruar, me mirësinë e Tij, na bëftë prej atyre që lexojnë Kuran, e kuptojnë dhe jetojnë atë!

Amin..!

11. Zevaid, 7/165-166.

12. Tirmidhi, vëll. 3, fq. 422.

SPJEGIME MBI TREGIMIN E QIELLËS E TË TOKËS NË PIK-PAMJE FETARE

Eudhu bi'l-lahi mine'sh-shejtani'r-rraxhim.

Bismillahi'r-Rrahmani'r-Rrahim.

**"El-ledhi xheale lekumu'l-arda firashe ve's-
semae binae ve enzele mine's-semai mae
feehraxhe bihi mine'th-themerati rizkan le-
kum, fela texh'alu lillahi endada ve entum
ta'lemun."**

Kuptimi i këtij ajeti është ky:

Zoti i juej token e krijoj në formë të një shtrese për juve, e qiellën në trajtë të tavaniprej ku Aj zdrypë shinë qi, nepërmes të ti perftohen frytet të cilat përbajnë ushqimin; kundrejt këtyne mirësinave mos i shoqnoni as mâ të voglen kreatyrë ase gjâ të mjeshtueme.

Ky ajeti i madhnueshëm më gjitha cilsinat hyjnore qi ka, është dhe një argument për të tregue të qenmen e Zotit të vertetë. Ajeti në fjalë me një gjuhë madhshtore përmendë dhe kujton vetëm një Zot të math qi, gjithë njerzve – pa dallue të pafetë e kundërshtarët – i u a plotson drejt për drejt nevojat ushqimore dhe i bân të përfitojnë nga shijet e jetës. Mbas gjitha këtyne sendeve me mohue Krijuesin e me mbyllë sytë kundrejt arsyetimeve për të dishmue të qenmen e Përendis është fare e pamundur.

Me këtë ajeti na rrëfen se, një nga të mirat e mdhaja qi Zoti jua dhuroi njerzve është toka; një shtresë e rrafshueme dhe e stolisun me male të nguluna, e krijueme më një mëndyrë qi banunsit e sajë të mund t'ecin lirisht, të pregatisin ushqimin e tyne tue mbjellë, tue korrë, dhe mâ në fund të përfitojnë nga visaret e pasunisë për të krye nevojat e veta.

Shumë prej myfesisrve këtë ajeti qerime e kanë marrë si argument për me forcue mendimin e tyne qi kishin mbi rrafshinen e tokës.

Fahri Raziu, mbas një të rahun mendimesh qi bân për këtë çashtje e refuzoj kategorikisht qi ajeti nuk mund të merret si argument për të tilla pretendime. Pse thotë aj, toka tue rritë vllimin e sajë, ç'se u krijue, arriti më një gradë qi mbi ç'do pikë të caktueme të sajën mund të shetit pa e dallue se është e rrumbullakët. Përveç kësaj ajeti cekë dhe dobinat e panumerta të tokës qi se e cila nga ato me gjithë se është e lidhum me disa shkaqe, rezultojnë të qenmen e Zotit të vertetë Krijuesit t'amshushem.

Të vimë në fjalën (**ve's-semae binae**); dihet se Fuqija Hyjnore mbasi krijoj token, e pshtet nën fuqinë e atracionit, një ligjë e natyrshme me të cilën ekuilibrohen trupat qiellorë. Prandej dhe toka me anën kësaj fuqije lidhet me disa hyej ngulsa e ca tjerë të luejshëm. Pra, toka me hapsinen e pa mbarim qindron e pezullueme tue mos qenë e pshtetun mbi gjâna të landta; vetëm mbahet prej fuqis terheqse bashkë me trupat tjerë qiellorë. Këta trupa me pershtypjen reciproke qi kanë, sigurojnë ekuilibrin në mes të tynepa shkaktue ndo një dam. Një kësaj soj ligje vetem një fuqi e hyjnueshme mundet t'a çpikin.

(Innallahe jemsiku's-semavate ve'l-arda en tezula...)

Ky ajeti qerime pershinë dhe perkon me gjitha teorinat qi dijetarët e shkencës i kan pranue. Sikuer është toka, sod po vertetohet se edhe trupat e tjerë qiellorë janë të formueme prej lanjeve e prej mineraleve, përveç kësaj nepër

ta gjinden dhe ujna të rrjedhshme. Me gjith ktë sikundër është e rethume toka e jonë prej valve t'ajr t'është janë të mbshtjellun dhe trupat tjerë qillorë, me ajr qi ajeti (**ve's-semæ binae**) këtë ka për qellim. Fjala qillë qi është n'ajetin-qerimen nuk ka qellim të tregoj një gjâ të caktueme; prandej trupat qiellorë qi kemi mbi krye permblidhen mbrenda në kuptimin e kësaj fjalë.¹

Arabët fjalën sema, e kanë përdorue në shumë kuptime; qe një vjershtar si thotë: (.....
....) Kjo fjalë vjen edhe në kuptimin re (sehab).

Mbas fjalëve (**ve's-semæ binae**), të cilat jemi tue i komentue, ajeti (**ve enzele mine's-semæ mae**) është n'atë kuptim.²

Ragin Isfahani thotë se çdo qiell në proporcjon të poshtmes është qiell, e në pshtetje (izafet) eprorë është tokë; vetem qiella e naltë është pa tokë. Mandej ajetin (Allahu'l-ledhi haleka's-semavate ve men...) e mendon në ket mënyrë.³

Themelisht fjala sema qi rjedh nga fjala Semuv = naltësi i pshtetet ç'do gjâje qi është e naltë. Arabët edhe shpindën e kalit e quajnë sema kështu qi Tufejli Ganeviu: (.....)⁴ Disa nga dijetarët tue folë mbi formimin e qiellës kanë mendue njena mbi tjetrën pors i çadër, e për me vertetue ketë dhe kujtue se palët e saja janë të vendueme thezë ata kanë marrë për argument dispozitat e Kuranit; sa qi kanë mrritë me caktue dhe llojet e qiellnave tue u mbështetë mbi ca israilizma e në disa hadithe qi nuk janë të pranueshme nga të gjithë ulematë. Pra, ata thonë se e para palë e qiellës është e formueme prej valve të futna njena më tjetrën; e dyta prej shkambijve e treta nga hekuri, e katërta prej bakri, e pesta prej sermi, e gjashta prej ari, e shtata prej prej perlantave të kuqe.

Vertetë Kurani fjalët (semavatë) i ka perdorue në shumë kuptime. B. f. Æsht një ajeti qi difton qiellen sikundër është toka e ndertueme prej

1. Nji nga vendet qi fjala qiell perdoret në formen e shumsit është; (Thumme's-teve ila's-sema...)

2. Po të bien shi mbi token e nji komi, neve aty t'i kullosim kaf - hët sado qi ata te njerzit të mraapshtë.

3. Taxhul-uzeze. F. 183.

4. Shpinda e kalit qi është e kuqe dhe e shndritshme pors i dibaja, është i kandshme kuerse aj të ketë dhe kambët e mbushuna.

gjânave të lândta, ashtu janë edhe qiellnat të formuem. Nji ajeti tjetër na difton se kta janë të perbame prej trupave ajrore; sikuerse ajeti: (thumme-steve ila's-semæ ve hije duhan). Nji tjetër prap, sikundër është ajeti: (ve lekad halekna fevkakum sebea taraik) rëfen se qillnat janë vende ku formohet lëvizja e hyjve shetitsa. Përveç këtyne fjala sema, qi është n'ajetin (ve enzele mine's-semæ mae) ka kuptimin e rësë. Këta ajete herë kanë qellim hyjt shetitsa, herë diftojnë udhët e lëvizjeve qi bânjë treupat qiellorë; megjithkëtë kanë për qellim dhe kupen e hapsinës, por kurr nuk mund të mirren si argument për me dishmue palët e qillve, sikuer i kanë marrë disa dijetarë.

Po të vimë në kaptinen mutabekatit (mbivue-men) qi permendet në Kuran, as kjo nuk do me thanë ashtu sikurse e kanë rëfye ca vaiza, dhe kanë pretendue disa filosof të kohës së vjetër! Po, sa për të vumt e hyjve njenin mâ nalt se tjetrin, na mjafton me dijtë shtat hyjt qi janë të njoftun çë me kohnat e vjetra e aq mâ fort na skjarojnë të verteten e Kuranit, hyjt e diktuem rishtas bashk me ata qi perditë vinë tue u ndikue. Disa prej dijetarve thonës e per me dhanë një gjykim të plotë mbi formimin e qiellnave lypset m'u mbështet nder teorinat qi ka pranue shkenca e astronomis. Kjo vertetë është e pranueshme; pse, teorinat astronomike dhe në rasë qi ato mos të jenë të verteta e kurse shumicës i'a pranon mendja me qenë se janë mâ afër realitetit se argumentat shëkimore (istidlalati vehmije) të cilët nuk i forcojnë as tradisjonet e verteta (nakli sahih).

Me gjith se disa hadithe mbi ketë çashtje janë në nji pjesë të librave të drejta por nuk janë vertetue prej gjith teologve mysliman. Përsa i përket këtij problemi nuk është ndigjue ndonji fjalë e vetun prej Ymmul-Myminin Hazreti Aishes, Zoti qoftë razi prej sajë.

(Vijon)

H. Ismet Dibra

Marrë nga revista Zani i Nalte, nr: 7, Fruer 1927, fq. 220.



Lutbe të zgjedhura

Naim Drija

Lutja

ËSHTË OPTIMIZËM

Në shumë raste të jetës së tij, njeriu, qenia më e përsosur që krijoi Allahu (xh.sh.), mund të jetë në gjendje të pikëlluar apo të gëzuar. Të dyja këto ndjenja, pra, pikëllimi dhe gëzimi në anën tjetër, janë pjesët e pandashme të natyrshmërisë së njeriut. Besimtari i drejtë dhe i devotshëm, në të dyja rastet, pra, edhe kur është i pikëlluar, edhe kur është i gëzuar, nuk e harron Allahun (xh.sh.), por i lutet Atij, Allahu (xh.sh.), thotë: **“E kur ro-bët e Mi të pyesin për Mua, (thujtu se) Unë jam afër tyre dhe i përgjigjem lutjes së atyre që më luten...”** (Bekare, 186)

Kur besimtari i lutet Allahut (xh.sh.), ndjen se Ai është afër, i dëgjon lutjet dhe rënkimet e tij. Madje vetë Allahu (xh.sh.), e urdhëroi Pejgamberin (a.s.), që t’i nxiste besimtarët në dua, duke u treguar se Allahu është afër, dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve të tyre.

Lutja dhe duaja nuk është vetëm adhurim dhe ritual, por edhe formë edukimi. Teksa njeriu lutet dhe i përsërit lutjet herë pas here, ai edukohet me përmbajtjen e tyre, duke çliruar energji të fshehta, aftësi të paditura etj. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: **“Lutja është vetë adhurimi.”** Kjo pasi, teksa i lutesh Zotit, ti ndjen nevojën që ke për Të. Teksa i lutesh Zotit, ti i je përlulur dhe nënshtruar vetëm Atij.

Në Kuran, Zoti i Lartësuar ka cekur lutje profetësh, të cilat janë pranuar. Ato u referohen ngjarjeve dhe situatave nga më të ndryshmet, me qëllim që ti o besimtar, ta kuptosh se lutjet e tua do të pranohen prej Zotit.

Junusi (a.s.), edhe pse gjendej në barkun e balenës, në mes të oqeanit dhe në errësirën e natës, iu lut Zotit:

“(Kujtoje) Dhun-Nunin (Junusin) kur iku i zemëruar e mendoj se Ne nuk do ta dënojmë, ndaj thirri nga errësira: ‘S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!’ Ne iu përgjigjem atij dhe e shpëtuam nga brengosja. Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët.” (Enbija, 87-88)

Zekerija (a.s.), iu lut Zotit për një fëmijë, edhe pse ishte i shtyrë në moshë dhe gruaja e tij ishte sterile. **“(Kujtoje) Zekerijan, kur iu lut Zotit të vet: ‘O Zoti im, mos më lër vetëm (pa fëmijë), e Ti je trashëgimtari më i mirë.’ Ne iu përgjigjem atij dhe i dhuruam Jahjain, duke ia bërë gruan të aftë (për lindje).”** (Enbija, 89)

Duaja- lutja është shpresa e myslimanit për çdo gjë dhe në çdo kohë. Le t’i nënshtrojmë vetet tona dhe të lutemi, të lutemi...





vazhdimisht të lutemi. Ai është i Vetmi që mund të na çlirojë nga ankthet dhe të na shpëtojë nga vuajtjet. Enesi (r.a.), transmeton, se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Duaja (lutja) është esenca e adhurimit." (Tirmidhiu).

Transmeton imam Muslimi se Ebu Umame ka thënë: "Ndodhesha në xhami në një moment kur nuk ishte kohë namazi. Profeti (a.s.), hyri në xhami dhe, kur konstatoi prezencën time, më pyeti me habi:

"O Ebu Umame! Ç'të ka sjellë në xhami në këtë kohë?"

Unë iu përgjigja:

"O i Dërguari i Allahut! Kam halle e shqetësime dhe jam i mbytur në borxhe."

Profeti (a.s.), më tha:

"O Ebu Umame! A të të mësoj disa fjalë. Nëse i citon ato, Zoti ta largon shqetësimin, t'i heq hallet dhe t'i shlyen borxhet?"

Me këtë, sikur Profeti (a.s.), kërkon të testojë vullnetin e Ebu Umames. Ebu Umame iu përgjigj:

"Po, o i Dërguari i Allahut!"

Atëherë, Profeti (a.s.), i tha:

"O Ebu Umame! Sa herë të gdihesh thuaj: 'O Allah! Unë kërkoj të më mbrosh nga hallet dhe shqetësimet, nga plogështia dhe dembelizmi, nga frika dhe koprracia, nga zhytja në borxhe dhe nëpërkëmbja e njerëzve.'"

Në këtë lutje, Pejgamberi (a.s.), na mëson të kërkojmë ndihmën e Zotit për hallet e së kaluarës dhe shqetësimet për të ardhmen. Plogështia dhe dembelizmi janë pengesa që thyejnë vullnetin. Frika dhe koprracia simbolizojnë pasivitetin dhe të qenët negativ në jetë. Ndërkohë që borxhet dhe zgjedha e njerëzve, përbëjnë pengesat e jashtme.

Një ndër emrat e Zotit



është edhe emri El-Muxhib

(Lutjepranuesi). Rreth këtij emri, Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: "**Me të vërtetë që Allahu është pranë dhe është Lutjepranues.**" (Hud, 61). Allahu (xh.sh.), është Ai që lutjeve dhe kërkesave të njerëzve u përgjigjet duke ia plotësuar secilit kërkesën dhe dëshirën e vet. Allahu i Madhërishëm pëlqen t'u përgjigjet lutjeve të tua, prandaj Ai të udhëzon që ta lutësh. Nëse nuk do të dëshironte t'u përgjigjej lutjeve të tua, do ta bënte zemrën të harronte dhe gjuhën të mos shqiptonte. Kështu, shohim se El-Muxhibi është Ai që lutjen dhe duanë e bën të dashur për zemrat e besimtarëve.

Duaja është një proces komunikimi direkt me Allahun. Ajo është të treguarit e dobësisë, nevojës dhe përlulesisë nga ana e robit, i cili nuk mund të ndihmojë veten. Është të kërkuarit ndihmë nga Allahu i Madhëruar dhe Fuqplotë, i Cili është në gjendje t'i ofrojë gjithçka që është e dobishme, dhe t'i largojë gjithçka që është e dëmshme.

O Zot, na i prano pendimet tona, sepse Ti je i Mëshirshëm dhe Pranues.

O Zot, na e bëj të dashur Imanin (besimin), o Zot na e bëj të dashur Islamin dhe bamirësinë. Bëj që ta urrejmë kufrin, punët e këqija që shkaktojnë zemërimin tënd. Pash mëshirën Tënde, o më Mëshiruesi i mëshiruesi.

O Zot, na jep të mirat e kësaj bote dhe botës tjetër dhe na ruaj dënimet e Xhehneimit.

O Zoti ynë, na i fal gabimet ne dhe prindërve tanë, fali edhe të gjithë besimtarët ditën kur do të japin llogari.

Amin!

PROBLEMET ME SIGURINË E INTERNETIT DHE ZGJIDHJA

Shumica e njerëzve mendojnë se lidhja e tyre me internetin është e sigurt, por duhet thënë se të dhënat që kalojnë përmes rrjetit janë më tepër transparente se sa mund të mendoni.

Sot, është mjaft e thjeshtë që hakerat të ndërhyjnë në sistemin tuaj. Prandaj, ne kemi identifikuar katër problemet më të mëdha me sigurinë dhe zgjidhjet e tyre:

1. Posta elektronike është e hakueshme

Ju mund të vendosni fjalëkalime, por nëse ky i fundit përfundon në duart e një hakeri, nuk do të jetë aspak problem që ai të lexojë mesazhet tuaja. Ka disa mënyra se si mund ta vjedhin postën tuaj, si për shembull përmes "packet sniffers" dhe aplikacione të tjera që ndërhyjnë në transmetimin e të dhënave.

Zgjidhja: enkriptoni e-mailin. Nëse hakerit i bien në dorë e-maillet tuaja, ato do të jenë të palexueshme.

2. Fjalëkalimet nuk janë të sigurta

Fjalëkalimet janë çelësat tanë në internet. Por një çelës edhe mund të vidhet dhe shumë më lehtë nga sa mund të mendoni. Teknikat e forcës brutale po përmirësohen, duke u bërë më efikase në procesin e të provuarit të miliona fjalëkalimeve derisa të gjejnë të saktin. Për më tepër, ka edhe mënyra më të thjeshta. Njësoj siç bëni ju kur keni harruar fjalëkalimin, mund të bëjë edhe një haker. Nëse si fjali sigurie në këtë rast keni vendosur emrin e qenit tuaj të parë, apo emrin e nënës apo rrugën ku jeni rritur, dijeni që nuk janë informacione të sigurta për t'u përdorur



në raste të tilla.

Zgjidhja: përdorni pyetjet e sigurisë si "fjalëkalime dytësor", duke i modifikuar ato në mënyrë të tillë që edhe një person që e di përgjigjen të mos arrijë ta gjejë në mënyrë të saktë. Për shembull, nëse emri i qenit tuaj të parë ishte "Zeke", shkruani në përgjigje "Zeke the Dog".

3. Mediat sociale janë gjithmonë publike

Ditët e sotme mediat sociale ofrojnë shumë mundësi për privatësinë tuaj. Mund të menaxhoni kush e sheh presencën tuaj në to, të ndryshoni privatësinë lidhur me përditësimet etj. Por, nëse postoni diçka në një faqe publike, të gjithë mund ta shohin. Për shembull, në faqet publike në Facebook, nëse bëni një koment, nuk keni mundësi ta kontrolloni se kush e sheh.

Zgjidhja: mos thoni në mediat sociale gjëra që nuk do t'i thonit në publik, veçanërisht në vende që mund të shihen nga të gjithë.

4. Uebkamerat nuk janë të sigurta

Kjo në fakt është pak e frikshme: sot, hakerat, jo vetëm që mund të ndërhyjnë në kompjuterin tuaj, por mund edhe të aktivizojnë uebkamerën pa dijeninë tuaj. Kështu mund t'ju vëzhgojnë gjatë gjithë kohës. Nuk është aspak e vështirë: mjafton të gjeni skripte të gatshme në internet.

Zgjidhja: mos harroni asnjëherë të keni të aktivizuar firewall-et, antiviruset dhe mbrojtjen kundër programeve keqbërëse. Mbajini ato të përditësuar gjithmonë! Nuk bëni keq edhe t'i mbuloni lentet e kamerës kur nuk jeni duke e përdorur.

WINDOWS LIVE MESSENGER DO TË SHKRIHET NË SKYPE

Më 15 mars, Windows Live Messenger do të mbyllet zyrtarisht, ndërsa përdoruesit do të kalojnë në Skype, programin të cilin kompania e bleu për 8.5 miliardë dollarë.

"Do të mbyllet Messenger-i ekzistues dhe karakteristikat e programit të tij do të kalojnë në Skype",- deklaruan zëdhënësit e kompanisë, duke theksuar se i vetmi vend që do të vazhdojë të përdoret Windows Live Messenger do të jetë Kina.

Për këtë arsye kompania po njofton përdoruesit të kalojnë në Skype, duke përdorur adresën e tyre Microsoft (të njohur më parë si "Windows Live ID"), e cila përfshin adresën e e-mailit dhe fjalëkalimin. Të gjitha kontaktet e Messenger do të përfshihen në momentin që bëni "sign in" në Skype. Asgjë nuk do t'ju humbasë nga kontaktet tuaja.

Ndërkohë, kompania ka integruar karakteristikat VoIP



të Skype-it në shumë prej produkteve të saj. Njëkohësisht, numri i përdoruesve në Skype vazhdon të rritet. Sot, si pjesë e raporteve financiare të Microsoft-it, kompania njoftoi se përdorimi i Skype-it u rrit me 58%, krahasuar me të njëjtën periudhë me një vit më parë. Microsoft-i tha se Skype ka 280 milionë përdorues, të cilët kanë gjeneruar 120 miliardë minuta me telefonata gjatë tremujorit të fundit.

Microsoft-i synon ta integrojë Skype-in në pjesën më të madhe të platformave të saj, përfshirë Windows 8 dhe Windows Phone 8. Gjithashtu Microsoft-i ka lajmëruar se planifikon të integrojë Skype-in në paketën Office 2013 për hedhjen në treg në 2013.

Blerja e Skype-it ishte një lëvizje inteligjente e kompanisë amerikane dhe s'ka asnjë tregues se shërbimi online do të ngadalësohet.

NOBELISTI MUHAMAD YUNUS TAKOHET ME ARTIZANËT E SHKODRËS

Artizanet e njohura shkodrane të fshatit Zogaj, në breg të Liqenit të Shkodrës, muajin e kaluar kanë pritur një mysafir të veçantë, profesor Muhamad Yunus, promotor i biznesit social në botë, fitues i çmimit Nobel për Paqen në vitin 2006.

Në këtë vizitë në fshatin turistik Zogaj, që shquhet për mjeshtërinë artizanale të prodhimit të qilimave, Muhamad Yunus, shoqërohej nga përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe të zyrës Yunus Social Business Albania.

Gjatë vizitës së tij, prof. Yunus u njoh nga afër me mënyrën e të punuarit në punishten shumë të njohur, jo vetëm në Shkodër, por edhe në shkallë vendi, në të cilën janë të punësuar vajzat dhe gratë zoganjore të bregut të liqenit.

Gjatë prononcimit për mediat e pranishme, Prof. Yunus u ndal tek biznesi social, duke theksuar ai ka mundësi kudo për t'u zhvilluar. Yunus tha se "prodhuesit e vërtetë në shumicën e vendeve, shfrytëzohen, ato punojnë shumë, kanë aftësi tradicionale, por marrin shumë pak para". Sipas tij, "këto biznese

përqendrohen në zgjidhjen e problemeve të njerëzve, kështu që prodhuesit e vërtetë duhet të marrin çmimin më të mirë". "Ky është një problem global, nuk është vetëm i Shqipërisë, por ne mendojmë që shembulli i Shqipërisë të bëhet edhe një model për vendet e tjera", nënvizoi Yunus.

I pyetur për çmimin e marrë prej tij, Prof. Muhamad Yunus sqaroi se çmimi është dhënë për punën me gratë për dhënien e kredive të vogla në favor të grave. Dhe kjo ide, vijoi ai, është bërë tashmë popullore në të gjithë botën, dhe përmes këtij mekanizmi gratë mund të bëjnë biznesin dhe aktivitetet e tyre të qëndrueshme. Duke folur diçka për aktivitetin e tij personal, ai bëri të ditur se është profesor i ekonomisë, duke ushtruar aktivitetin e tij në SHBA dhe në Universitetin e Chit-tangong në Bangladesh, ndërkohë që spikat në ngritjen dhe zhvillimin e një prej bankave më të mëdha të mikrokredisë dhe mikrofinancës për të varfrit të cilët nuk kanë akses në banka për shkak të gjendjes së tyre ekonomike sociale.

PARLAMENTI EVROPIAN DISKUTON ISLAMOFOBINË DHE KSENOFOBINË

Evropa e ndikuar thellë nga problemet ekonomike ndodhet edhe përpara problemeve shoqërore që sa vjen dhe shtohen edhe më shumë, ksenofobia dhe islamofobia.

Në mbledhjen e organizuar në Parlamentin Evropian u trajtuan problemet shoqërore dhe u tha se për kërkesat demokratike të myslimanëve po tregohet indiferencë.

Në seancën e organizuar nga Iniciativa Myslimane Evropiane u sollën në rend problemet e myslimanëve dhe rrugët për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Në mbledhje u tërhoq vëmendja se në demokracinë evropiane ku po përjetohen kriza të mëdha socio-ekonomike dhe politike, ksenofobia dhe islamofobia sa vijnë dhe po përhapen edhe më shumë.

Deputeti anglez Saxhad Qerim, duke vënë në dukje se situata e krijuar është shqetësuese tha: "Është e qartë se me përkeqësimin ekonomik dhe ekstremizmit ka një lidhje të dukshme. Në veçanti, vëmë re se në agjendën e atyre që

mbledhen përreth të djathtës ekstreme është vendosur anti-islamizmi. Bashkimi Evropian duhet të krijojë urgjentisht një politikë për këtë".

Sipas deputetit anglez në Evropë nën mbrojtjen e lirisë së fjalës, po lejohen hapat e hedhur për nxitjen e krimeve të urrejtjes. Duke nënvizuar se kur flitet për lirinë e fjalës në shumë vende të Evropës, koncepti ka kuptime të ndryshme, parlamentari anglez Qerim tha se do të ishte një hap i madh nëse toleranca për shumëllojshmërinë të mësohej që në vitet shkollore.



EGJIPTI KUNDËR NDËRHYRJES NË MALI



Presidenti egjiptian, Mohamed Mursi deklaroi se kundërshtoi intervenimin ushtarak në Mali, sepse, sipas tij, ajo krijon vatër të re të konfliktit, me ç'rast mund ta shkëpusë veriun arab nga fqinjët jugorë.

Gjatë fjalimit të tij në Samitin e Ligës Arabe në Arabinë Saudite, Mursi ka shprehur përkrahje ndaj Algerisë dhe luftës së saj për ruajtjen e paqes,

e cila ishte referencë ndaj okupimit të një fushe të gazit nga ekstremistët islamikë, ku javën e shkuar u vranë 38 pengje dhe 29 ekstremistë islamikë.

Një grup i maskuar kishte marrë përgjegjësinë për këtë sulm, duke njoftuar se do të kryejë ende sulme të tilla kundër secilit shtet që përkrah intervenimin e Francës në Mali. Në anën tjetër, shefi i Ligës Arabe, ka thënë se misioni i të dërguarit special për Sirinë, Lakhdar Ibrahim, nuk sollti aspak shpresë. Liga Arabe kërkoi edhe një mbledhje urgjente të KS të OKB-së për këtë temë, duke këmbëngulur që në rend dite të silltet një rezolutë, e cila do të bënte thirrje për ndërprerjen e dhunës në Siri dhe formimin e një organi mbikëqyrës për zbatimin e paqes.